



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.2.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë me pyetjet e dëshmitarëve:

Ariola Kodra - Administratore e Inceneratorit Integrated Energy BV SPV.

Faraudin Arapi - Administrator e Inceneratorit “Albtek Energy”.

Loren Duzha - Administrator i Inceneratorit “Integrated Technology Waste Treatment Fier”.

Arenc Myrtezani - Ish-Administrator i ITWTF.

Elvi Fundo – Gazetar CNA

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi, Besion Ajazi, Etjen Xhafaj, Edmond Spaho, Dhurata Tyli (Çupi), Belind Këlliçi, Luçiano Boçi, Helidon Bushati, Ina Zhupa dhe Denis Deliu.

Mungojnë:

Ermonela Valikaj (Felaj) dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Ariola Kodra - Administratore e Inceneratorit Integrated Energy BV SPV.

Arenc Myrtezani - Ish-Administrator i IT

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Mirëdita të gjithëve!

Faleminderit për prezencën!

Fillojmë sot mbledhjet e komisionit hetimor me thirrjen e dëshmitarëve.

Dëshmitarja e parë e thirrur për sot është zonja Ariola Kodra, nëse nuk gabo, do të prezantoheni edhe më vonë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si administratore e kompanisë që sot ka në pronësi inceneratorin e Tiranës “Integrated Energy BV SPV” (special purpose vehicle), siç e njeh legjislacioni shqiptar.

Përpara se të filloj mbledhjen dua t’i njoftoj të pranishmit që sot për të dëshmuar në këtë komision, përveç zonjës, ishte i ftuar edhe zoti Faraudin Arapi, i cili ka komunikuar sot me sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, të cilit i ka thënë se njoftimin e ka marrë sot në mëngjes, ka biseduar edhe me mua, por e ka të pamundur të vijë sot. Pra, për përfaqësuesin e kësaj kompanie, zotin Faraudin Arapi dhe zotin Arjan Baçi, janë dy përfaqësues kompanie, sepse janë dy kompani në Elbasan, ne do të skedulojmë një orar tjetër në bashkëpunim me përfaqësuesit e maxhorancës se kur do të vijnë.

Shkresa për zotin Loren Duzha, i cili është administrator i inceneratorit të Fierit, është kthyer pas ditën e premte, ndërkohë që sot në mëngjes administratori i Fierit ka nisur një shkresë me anë të së cilës shprehet se është i gatshëm të dëshmojë. Ne jemi duke pritur përgjigjen nga ana e zotit Loren Duzha nëse mund të vijë sot në orën 15:00 ose nëse mund ta lëmë për nesër, por ka konfirmuar se është i gatshëm të dëshmojë.

Pra, dy administratorët, si ai i inceneratorit të Tiranës dhe ai i Fierit janë shprehur se janë të gatshëm për të dëshmuar. Kemi nisur njoftimin për zotin Arenc Myrtezani, i cili do të dëshmojë sot në orën 16:00. E ka marrë njoftimin dhe nuk kemi asnjë konfirmim ose moskonfirmim nga ana e tij. I pesti për sot në rendin e ditës është zoti Elvi Fundo. Pas përpjekjeve që unë realizova një nga anëtarët e komisionit më informoi që zoti Fundo është jashtë Shqipërisë, kështu që e ka të pamundur të vij sot në komision. Pra, dëshmitë për ditën e sotme janë këto.

Para se të fillojmë, a ka ndonjë koment nga ana e maxhorancës?

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, jemi dakord dhe nuk kemi komente. E rëndësishme është që dëshmitarët, të cilët ju i konsideroni të nevojshëm për të dëshmuar, të paraqiten përpara

këtij komisioni dhe të shprehin mendimin e tyre. Përderisa vullneti i tyre është shprehur, është vetëm çështje skedulimi për të cilin biem dakord ta riformulojmë.

Jorida Tabaku – Zoti Boçi e ka kërkuar fjalën.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Nga mediet ka dalë që nënkryetarja e komisionit ka konflikt interesi. Pra, duke qenë nënkryetare e nënkomsionit, pyetja që unë kam është: a mund të thërritet si dëshmitare, sepse për të njëjtat arsye ne kemi thirrur dëshmitarë edhe ish-ministra të tjerë? Mendoj se për ta thirrur si dëshmitare duhet parë Rregullorja.

Nga nënkryetare do të kaloni te pozicioni i dëshmitares?

Jorida Tabaku – Zoti Boçi, ju nuk ishit ditën e premtë, kështu që dosjen e plotë e nxora unë dhe jo mediet, por e morën nga komisioni.

Zonja Felaj ka qenë pjesë e procedurës miratuese të këtij koncesioni. Fillimisht është shprehur kundër dhe ka thënë se kompania nuk gjendej as në *Google* si e regjistruar në QKB. Unë e kam lexuar të gjithë shkresën e saj këtu. Më pas shefja e saj e kabinetit, zonja Rovena Voda kishte nisur një *e-mail* ku të gjitha këto shqetësime ishin harruar dhe e kishte miratuar koncesionin. Unë gjykoj se ne mund ta shtojmë.

I kërkoja zonjës Felaj, meqenëse ka konflikt interesi, të mos merrte pjesë edhe në prezantim, por ajo gjykoi që nuk tërhiqej dot, sepse konflikti i interesit nuk ekzistonte.

Fjalën e ka zoti Nasufi dhe më pas zoti Pëllumbi.

Fadil Nasufi – Njoftimi i dëshmitarëve për të ardhur në dëgjese, sipas një kalendari që keni bërë ju, në çfarë adrese është nisur në adresën e kompanive apo në adresë familjare?

Jorida Tabaku – Njoftimi për të gjithë dëshmitarët është bërë në adresën e kompanive. Edhe zotit Loren Duzha njoftimi i është bërë në adresën zyrtare të kompanisë. Në shkresën që ai kishte kthyer përgjigje sot në mëngjes shprehte angazhimin dhe vullnetin e tij për të ardhur, ishte po e njëjta adresë që ne i kishim nisur. Do ta rinisim edhe një herë, ndërkohë që kemi nisur edhe komunikimin me *e-mail*. Në rastet kur dëshmitarëve nuk u është gjendur adresa e saktë, është komunikuar me zyrën e Gjendjes Civile, e cila na ka dhënë adresën e saktë të banimit. Sot kemi nisur disa shkresa për t'u shkuar edhe në adresat e tyre të banimit. Kjo ka qenë procedura që kanë ndjekur komisionet hetimore parlamentare edhe në të shkuarën.

Nëse nuk keni gjë tjetër për procedurë do të doja të vazhdoja...

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt ne e sqaruam, zonja Felaj e sqaroi edhe vetë në mbledhjen e kaluar sesi e konceptojmë ne konfliktin e interesit. Pra, konflikti i interesit ka të bëjë me interesa private në raport me vendimmarrjen. Zonja Felaj nuk ka ndonjë interes privat të vetin të shprehur në raport me atë vendimmarrje, kështu që nuk më duket që ne ndodhemi në momentet e konfliktit të interesit në këtë rast. Nëse dëshironi ta thërrisni për dëshmitare keni gjithë të drejtën ta bëni këtë gjë.

Helidon Bushati – Kam diçka të vogël për procedurë. Pa paragjykuar administratoren, pra kërkesa ime vlen për të gjithë administratorët. Këtu argumentimi që do të japin administratorët dhe ato që kanë dhënë edhe kolegët e maxhorancës bazohet në faktin që janë vonuar dhe është shtyrë zbatimi apo përfundimi i punimeve pasi nuk janë marrë të gjitha lejet apo licencat përkatëse, sepse ka pasur vonesa nga institucioni. Unë kërkoj nga çdo administrator që për çdo vonesë të supozuar apo reale t’i referohet nenit të kontratës dhe institucionit me numër shkresë dhe me datë kur ju keni kërkuar diçka, sa ju është vonuar, sa kohë ka zgjatur dhe për cilin institucion bëhet fjalë, pasi pas jush do të jenë të pranishëm edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe ne duhet të jemi shumë të saktë sa u takon vonesave reale apo të supozuara të krijuara nga secili prej institucioneve.

Ndaj po jua kërkoj juve, meqenëse jeni e para, që kur t’u referoheni vonesave apo mungesave të dokumentacionit, t’i referoheni pikës kontraktuale, cilit institucion, kur e keni kërkuar atë që është dashur, si ka qenë përgjigjja, pra çdo gjë të jetë specifike, ju lutem!

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fillojmë me procedurën, mendoj se zoti Bushati i parapriu pak, por nuk ka ndonjë gjë të keqe, për thirrjen e dëshmitarëve.

Dëshmia, dua t’ju informoj që sipas nenit 18 të Rregullores së brendshme të komisionit, merret pas kryerjes së betimit.

Dua t’i kërkoj zonjës Ariola Kodra që të përsëris pas meje, fjalën “Beto hem”.

“Beto hem se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë”.

Ariola Kodra – Beto hem!

Jorida Tabaku – Zonja Ariola Kodra, dua t’ju kujtoj që sipas nenit 306 të Kodit Penal dëshmia e rreme dënohet deri në 6 vjet heqje lirie. Ky komision hetimor nuk është organ akuze, kjo është e vërtetë, por ka të gjitha përgjegjësitë, tagrin dhe kompetencat për t’ju çuar përpara

organit të akuzës ju, sigurisht edhe aksionarët e kompanisë, të cilët ne i kemi marrë në shqyrtim dhe i kemi si objekt të punës së këtij komisioni hetimor.

Po filloj unë me disa pyetje dhe më pas fjalën po jua kaloj kolegëve.

Ju lutem, në mënyrë që të mos kem ngarkesën që kisha ditën e premte, kërkojeni fjalën sipas radhës!

Po filloj me pyetjet e gjeneraliteteve dhe më pas do të fillojmë me pyetjet.

A mund të na prezantoheni për komisionin?

Ariola Kodra – Unë quhem Ariola Kodra, lindur më 30.4. 1979, në Tiranë, banuese në Tiranë, me profesion juriste. Jam administratore e shoqërisë “Integrated Energy BV SPV”, e cila ka nënshkruar kontratën koncesionare me autoritet kontraktues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtim landfill inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë, pra në kompleks zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë ose Sharrë, siç njihet.

Jorida Tabaku – Kush ju ka emëruar në detyrën e administratores?

Ariola Kodra – Ky pozicion është propozuar nga administratori i mëparshëm dhe administratori aktual teknik zoti Xhuzepe Çapalione.

Jorida Tabaku – Kush janë pronarët e kompanisë?

Ariola Kodra – Pronarët e kompanisë janë shoqëri dhe individë, të cilët janë të regjistruar në ekstraktin e pronarëve përfitues, pra ky është një informacion të cilin ju lehtësisht mund ta aksesoni pranë QKB-së.

Jorida Tabaku – Ne e kemi aksesuar për qëllimet e këtij komisioni, por jam duke ju pyetur ju. Cilët janë pronarët e kompanisë në të cilën ju jeni administratore?

Ariola Kodra – Edhe unë sapo iu përgjigja pyetjes që ju më bëtë. Ky është një informacion që e aksesoni në QKB.

Jorida Tabaku – Ju nuk e dini se për cilët pronarë jeni duke punuar?

Ariola Kodra – Patjetër që e di.

Jorida Tabaku – Cilët janë pronarët e kompanisë që zbaton koncesionin?

Ariola Kodra – E nderuar zonja kryetare,

Të gjitha informacionet që shoqëria “Integrated Energy BV SPV”, e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar, ka për detyrë t’ua paraqesë institucioneve shtetërore aksesohen lehtësisht.

Jorida Tabaku – A i njihni shtetasit Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja?

Ariola Kodra – Shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri i njoh në marrëdhënie pune. Shtetasi Klodian Zoto është administrator i shoqërisë “Integrated Tecnology Services”, e cila është një nga shoqëritë nënkontraktore që kryen punimet civile pranë zonës së trajtimit të mbetjeve në Tiranë.

Jorida Tabaku – Po zonjën Stela Gugallja?

Ariola Kodra – Po, edhe zonjën Stela Gugallja e njoh në marrëdhënie pune.

Jorida Tabaku – Në cilat rrethana i keni njohur?

Ariola Kodra – Zonja Stela Gugallja është administratore e një zyre kontabiliteti, të cilën e kemi nënkontraktuar për marrëdhëniet e kontabilitetit.

Jorida Tabaku – Si quhet kompania?

Ariola Kodra – Kompania quhet “Consulting SE”.

Jorida Tabaku – Bilancet e cilit vit ka miratuar kompania?

Ariola Kodra – Ky është një informacion që nuk e disponoj për momentin, por, nëse do t’ju duhet i detajuar, mund ta mbaj shënim si pyetje dhe përgjigjen mund t’jua jap në një ...

Jorida Tabaku – Do ta vlerësoja në qoftë se mund t’ia jepnit këtij komisioni.

Afrojeni pak mikrofonin që të dëgjoheni nga të gjithë kolegët.

Faleminderit!

Arjola Kodra- Sot jam informuar në mënyrë të përgjithshme për çfarë do të isha këtu, por jo në mënyrë specifike që të mund të isha e përgatitur dhe të kisha deri në detaje informacione që t’jua vija në dispozicion.

Jorida Tabaku- Kur ka qenë komunikimi juaj i fundit me tre personat që përmendëm Stela Gugallja, Mirel Zoto dhe Klodian Mërtiri?

Arjola Kodra- Komunikimet nuk kanë qenë të drejtpërdrejta, sepse i mbajmë nëpërmjet punonjësve të shoqërisë të cilën unë administroj. Do të thotë se unë nuk jam e detyruar të komunikoj me çdo nënkontraktor, pasi kam një staf që më suporton për këtë pjesë.

Jorida Tabaku – Kur ka qenë komunikimi juaj i fundit që ju ose stafi juaj ju kanë sjellë informacione që kanë pasur me tre personat që unë përmenda që janë të tre nënkontraktorë të shoqërisë ju që ju administroni.

Arjola Kodra- Sa për pjesën e komunikimit tim sapo jua dhashë përgjigjen, sa për pjesën e komunikimit të stafit më lejoni të marr informacion dhe të përgjigjem zyrtarisht.

Jorida Tabaku- I kërkoj stafit të komisionit që të mbajë shënim pyetjet për të cilat zonja do të na kthejë përgjigje, për bilancet e cilit vit ka audituar kompania që zotërohet nga zonja Stela Gugallja, por njëkohësisht edhe komunikimin e fundit që ka pasur zonja ose stafi.

Ku ka qenë takimi juaj i fundit me këto shtetas dhe kur?

Arjola Kodra- Sapo iu përgjigja pyetjes suaj.

Jorida Tabaku- Unë nuk e mora përgjigjen.

Arjola Kodra- Unë kontaktet nuk i kam të drejtpërdrejta me personat ose me nënkontraktorët e shoqërisë. Komunikoj nëpërmjet stafit tim.

Jorida Tabaku- Ju sapo më pranuat që i njihni këto persona dhe jeni në marrëdhënie pune me to.

Arjola Kodra- Po kam nënshkruar kontratat e nënkontraktimit.

Jorida Tabaku- Atëherë, kur ka qenë kontakti juaj i fundit me këto persona? Mund të ketë qenë edhe para 5 vjetësh kur ndoshta ju kanë marrë në punë. Unë thjesht po pyes kur ka qenë kontakti juaj.

Arjola Kodra- Kjo është një pjesë që nuk e kam memorizuar.

Jorida Tabaku- A ka qenë vitin e fundit, dy vitet e fundit, gjashtë muajt e fundit? A keni pasur kontakte të shpeshta apo jo?

Arjola Kodra- Më vjen keq sapo ju përgjigja që kjo është një pyetje të cilën nuk e kam memoprizuar. Pra, afatet takimit nuk i kam të memorizuara.

Jorida Tabaku- Unë dua t'ju kujtoj përveç faktit që jeni nën betim, zonja Arjola Kodra, dua t'ju kujtoj njëkohësisht faktin që dëshmia e rreme ka penalitete për ju.

Arjola Kodra- Edhe unë jam në dijeni të këtij fakti.

Jorida Tabaku- Ju jeni juriste, prezantuat veten si juriste dhe besoj se e ndieni përgjegjësinë që ka ligji kur vini të raportoni këtu para një komisioni hetimor.

Arjola Kodra- Jam në dijeni të faktit dhe do t'ju kthej përgjigjet në detaje në mënyrë zyrtare të të gjitha pyetjeve që po më drejtoni.

Jorida Tabaku-A keni pasur një eksperiencë të mëparshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve?

Arjola Kodra – Jo, nuk kam pasur.

Jorida Tabaku- Pra, keni zero eksperiencë pune në këtë fushë? Falemndienrit!

Si është siguruar financimi i impiantit të inceneratorit të Tiranës?

Arjola Kodra- Zona e trajtimit të mbetjeve në Tiranë nuk është thjeshtë një incenerator , por një zonë komplekse që përfshin një tërësi veprash është pra shoqëria Integratet Energy BV SPV kryen një financim tërësisht privat.

Është financimi i shoqërisë 100% privat.

Jorida Tabaku- A keni marrë ndonjë kredi bankare për këtë financim?

Arjola Kodra- Po kemi marrë kredi nga bankat e nivelit të dytë.

Jorida Tabaku- Në cilën vlerë?

Arjola Kodra- Vlerat e sakta nuk më kujtohen.

Jorida Tabaku- Atëherë, a mund t'i siguron këtij komisioni vlerën e saktë të kredive që keni përdorur deri sot për punët në të gjithë projektin e trajtimit të mbetjeve?

Faleminderit!

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi- Ne në mënyrë të padiskutuar ne mund të drejtojmë të gjitha pyetjet që i shikojmë të arsyeshme, por pjesa ku ka të bëjë marrëdhëniet privat me privat nuk më duket se është tagër i hetimit të këtij komisioni.

Marrëdhënia e marrjes së një kredie në një bankë të nivelit të dytë private nga një kompani private nuk më duket që është pjesë e hetimit që ne kemi si objekt të punës sonë.

Jorida Tabaku- Zoti Pëllumbi ne këtu po diskutojmë përdorimin e fondeve publike. Ashtu, siç unë do ta provoj për inceneratorin e Elbasanit dhe të Fierit, kompania ka pasur një kapital prej 100 mijë lekësh dhe ka marrë një kredi bankare që e ka përdorur të gjithën për investimin. Nuk ka pasur asnjë kapital të vetin. Unë kam marrëveshjet e kredisë dhe barrës siguroese është vendosur kontrata koncensionare. Ne këtu duam të provojmë që kompanitë me zero eksperiencë, pa kapital, pa investime në këtë fushë kanë marrë një kontratë koncesionare duke mos pasur as fonde për të investuar. Kështu që unë besoj se ky është objekti i punës i këtij komisioni. Për këtë arsye ne po presim përgjigjen.

Po, zoti Shalsi.

Eduard Shalsi –Zonja kryetare, po ndiqja pak mënyrën se si i drejtoheshit, nuk e kam me thelbin por do t'ju sugjeroja, ju dhe cilitdo prej nesh, që ato që kemi kërkuar, apo që keni kërkuar ju, një pjesë i kemi kërkuar ne, t'i drejtohem i do thosha unë në mënyrë pak më etike. Hera herës m'u la përshtypja dhe qofsha i gabuar, sikur iu hakërryhet kur pyetët për eksperiencën dhe ju tha që nuk ka eksperiencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qartë pra qartë, por e gjykoj të rëndësishme të vendos në dukje përpara të gjithë anëtarëve që është e rëndësishme se çfarë pyesim, por është shumë e rëndësishme edhe se si pyesim. Këtë doja të sillja në vëmendjen.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Shalsi! Zoti Këlliçi keni fjalën.

Belind Këlliçi – Në vijim të asaj që përmendi zoti Pëllumbi, në bazë të informacionit, që ne kemi administruar, në planin e biznesit, që është dorëzuar apo depozituar është përcaktuar se kosto e projektit do të përballohet me vlerë të plotë nga kapitali i shoqërisë dhe nga burimet e brendshme të saj pa pasur nevojë të merret një kredi bankare. Ndërkohë që koncensionari Integrated Energy BVSPV ka kërkuar financim nëpërmjet dy kontratave kredi afatgjatë dhe afatmesme për vijimin e projektit. Kjo është e dokumentuar edhe në raportin e fundit të KLSH-së, kështu që unë mendoj se ky është një detaj që përbën shumë interes edhe për këtë proces për këtë komision, nuk është aq detaj teknik siç ju e përmendët.

Arben Pëllumbi – Zoti Këlliçi, edhe njëherë duhet të jemi të qartë, ne këtu jemi komision hetimor parlamentar, ajo është një marrëdhënie mes privatësh se si ndërron plani i biznesit i një kompanie është çështje e saj në raport me kontratën që ka firmosur. Unë nuk shikoj se çfarë interesi kemi ne se si e ka financuar kompania ndërtimin e asaj veprë kur ne na intereson si është zbatuar kontrata në raport me detyrimet e institucioneve.

Jorida Tabaku – E ka kërkuar dhe zonja Zhupa fjalën, për pyetje.

Ashtu siç dhe zoti Këlliçi, edhe unë e kam nxjerrë nga raporti i KLSH që kompania deklaroi se nuk do të ketë nevojë për kredi dhe do ta kryejë të gjithë investimin me kapitalin e saj, ndërkohë që zonja sapo na konfirmoi që janë marrë dy kredi në dy banka të nivelit të dytë. Do t'ia lëmë kompanisë për të na e gjykuar nëse do të na e sjellë këtë apo jo.

A rezulton i punësuar pranë kompanisë tuaj shtetasi Edmond Arçile Bllako? Nëse po, në çfarë periudhe ka qenë ai punësuar? Çfarë pagesash ka marrë?

Arjola Kodra – Zotëria që ju përmendët ka qenë punonjës i shoqërisë Integrated Energy BVSPV, aktualisht nuk është më punonjës i saj.

Ky punonjës është punësuar përpara periudhës së administrimit tim.

Jorida Tabaku – Në cilin vit keni filluar administrimin?

Arjola Kodra – Unë jam emëruar si administratore në 15.03.2019.

Jorida Tabaku – Përpara kësaj periudhe ka qenë i punësuar zotëria ?

Arjola Kodra– Po, përpara ka qenë i punësuar zotëria.

Jorida Tabaku – Ju nëse e mbani mend më vonë mund të na e siguronit se sa ka qenë paga e zotërisë dhe për cilën periudhë është punësuar atje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi– Kryetare, unë vazhdoj të ngul këmbë që ne nuk kemi tagër të hetojmë marrëdhënie mes privatësh, se kush është punësuar dhe, si është punësuar nuk është tagër i këtij komisioni.

Ju mund të shkruani çfarë të doni në raportin tuaj, por nuk është tagër se çfarë marrëdhëniesh private ka kompania me të punësuarit e vet, sa i paguan apo si i paguan, nuk është tagër i këtij komisioni.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, ne këtu po diskutojmë për konflikt interesi në vendimmarrje. Unë zonzjen e pyeta, nëse familjari i një deputeti i Partisë Socialiste, ish- sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit që ka marrë vendim për këtë kontratë a ka qenë i punësuar në këtë biznes. Nuk po interesohem për punësimin e askujt tjetër, po interesohem për një individ konkret që ka konflikt interesi. Unë i kërkoj zonzjes që nëse ka mundësi të na sigurojë informacionin, sigurisht në marrëdhënie të palëve të treta për neve nuk ka rëndësi se çfarë ndodh.

A njiheni ju me shtetasit Edi Rama, Lefter Koka, Damian Gjijknuri, Engjëll Agashi apo familjarë të tyre ?

Arjola Kodra – Zotërinjtë që sapo përmendët i njoh sigurisht si politikanë të Republikës së Shqipërisë.

Jorida Tabaku – Nuk keni asnjë kontakt personal me to apo me familjarë?

Arjola Kodra – Jo, jo.

Jorida Tabaku– Faleminderit!

Ky ishte grupi im i parë i pyetje do t’ia jap fjalën kolegëve. Ka kërkuar fjalën zonja Çupi, zoti Këlliçi, zonja Zhupa, zoti Pëllumbi, sipas kësaj radhe.

Dhurata Çupi – Pyetja që do të bëj, në fakt, është edhe objekt i komisionit, ju keni një kontratë koncensionare me institucionet publike, kur është nënshkruar ju lutem dhe sa ka qenë afati i punimeve?

Faleminderit!

Arjola Kodra – Shoqëria Integrated Energy BVSPV, ka lidhur kontratën e koncensionit me autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë më parë Ministrinë e Mjedisit

kaluar më pas në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, më 31.08.2017 për një afat 30 vjeçar.

Dhurata Çupi – Kontrata ka qenë me afat koncesionare 30-vjeçar. Përfundimi i punimeve të objektit të koncesionit sa afat ka pasur?

Ariola Kodra – Punimet kanë një fazë të përcaktuar prej 6 vjetësh nga momenti i zbardhjes së lejes së ndërtimit. Leja e ndërtimit është zbardhur në nëntor të vitit 2020. Nga momenti i zbardhjes për 6 vjet përfundon edhe ndërtimi i tërësisë së veprave.

Dhurata Tyli – Nga viti 2017 deri në vitin 2020 ju nuk keni pasur asnjë marrëdhënie lidhur me këtë kontratë koncesionare me autoritetet publike?

Ariola Kodra – Nuk e kuptova pyetjen tuaj! Në qoftë se është e mundur ta shprehni...

Dhurata Tyli – Keni nënshkruar kontratën me Ministrinë e Energjetikës në vitin 2017, të transferuar nga Ministria e Mjedisit. Me afatin e ekzekutimit të kontratës, pra të kryerjes së punimeve totale dhe të vënies në dispozicion në punë të objektit të koncesionet prej 6 vjetësh. Këto vite llogariten duke filluar nga marrja e lejes së ndërtimit. Ju thatë që lejen e ndërtimit e keni marrë në vitin 2020. Nga viti 2017 deri në vitin 2020, çfarë marrëdhëniesh keni pasur me këto institucione publike, Ministrinë e Energjetikës apo Ministrinë e Mjedisit, me të cilat është nënshkruar kontrata?

Ariola Kodra – Marrëdhënien kontraktuale, për atë çfarë është parashikuar në kontratën e koncesionet.

Dhurata Tyli - Pra, ju nuk keni i filluar punimet deri në vitin 2020?

Ariola Kodra – Ne i kemi filluar punimet të pajisur me një deklaratë paraprake punimesh, të vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, të gjendur në kushtet e emergjencës mjedisore dhe në kushtet katastrofike në të cilat u mor në dorëzim venddepozitimi i vjetër i Sharrës. Nga momenti i marrjes në dorëzim, nëpërmjet procesverbalit të bashkisë, kemi filluar menjëherë rehabilitimin e zonës, vënien në siguri të venddepozitimit dhe të gjitha...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në vitin 2020 është zbardhur leja e ndërtimit. Është dhënë një vendim për miratim në maj të vitit 2019, para kësaj periudhe kemi pasur në dispozicion një deklaratë paraprake për fillimin e punimeve të vendosur nga bashkia.

Dhurata Tyli - Deklaratën paraprake kur e keni marrë?

Ariola Kodra – Deklarata paraprake është marrë në vitin 2017, diku nga dhjetori. Në qoftë se doni, mund t'jua vendosim në dispozicion...

Dhurata Tyli - Nga kush është nënshkruar deklarata paraprahe?

Ariola Kodra – Kjo deklaratë është nxjerrë nga Bashkia e Tiranës.

Dhurata Tyli - Nga kryetari i Bashkisë së Tiranës është nxjerrë kjo deklaratë paraprahe për punimet në një koncesion me këtë vlerë kaq të madhe?

Ariola Kodra – Para fillimit të punimeve, po.

Dhurata Tyli – A ka mundësi të më thoni, në zbatim të kësaj kontrate, sa është fondi që keni marrë nga buxheti i shtetit nga viti 2017 deri në vitin 2020 dhe më pas, pas vitit 2020, kur jeni trajtuar me leje ndërtimi?

Ariola Kodra – Shoqëria koncesionare nuk merr fonde nga buxheti i shtetit për investimin, por merr tarifën e depozitimit për shërbimin që ofron.

Dhurata Tyli – Pra, objekti i koncesionit ka qenë ndërtimi edhe i një inceneratori dhe ju vazhdoni të mos e keni në punë inceneratorin për shkak se ju marrëdhënien me buxhetit e keni vetëm për tarifën e depozitimit?

Ariola Kodra – Zona e trajtimit të mbetjeve të Tiranës, sikurse e shpreha edhe më herët, është një zonë komplekse, që përfshin ndërtimin e në tërësi veprash dhe jo vetëm e inceneratorit, që, në fakt, quhet “Impianti i trajtimit të mbetjeve me prodhimin e energjisë”. Ndërtimi i këtyre objekteve ka një fazë të përcaktuar punimesh, dhe faza e fundit e ndërtimit është ndërtimi i impiantit të prodhimit të energjisë, që është aktualisht në fazë ndërtimore dhe është brenda afateve të grafikut të punimeve, i cili është edhe aneksi i kontratës së koncesionit.

Dhurata Tyli – Pra deri më sot e thoni me përgjegjësi të plotë që nuk keni marrë asnjë fond nga buxheti i shtetit?

Ariola Kodra – Shoqëria nuk ka marrë asnjë fond nga buxheti i shtetit për investimet e të gjithë objektit të kontratës së koncesionit.

Dhurata Tyli – Çfarë marrëdhënie ka shoqëria juaj me pasurinë ku është zbatuar kontrata, me truallin të themi?

Ariola Kodra – Zona ku zhvillohet projekti i shoqërisë koncesionare është vendosur në dispozicion nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, nëpërmjet procedurës së shpronësimit.

Dhurata Tyli – Pra, investimi po kryhet totalisht në pasuri publike?

Ariola Kodra – Është pasuri private dhe pasuri publike.

Edmond Spaho – Doja të sqaroja diçka.

Ju thatë që keni filluar punimet në vitin 2017 me një leje apo deklaratë paraprake, të lëshuar nga Bashkia e Tiranës, të firmosur nga kryetari apo nga punonjës të tjerë të Bashkisë së Tiranës.

Ariola Kodra – Sapo i ktheva përgjigje zonjës së nderuar, unë nuk e kam të memorizuar se nga kush është firmosur, sepse ka qenë një periudhë para administrimit tim, megjithatë mund t'juaj vëmë në dispozicion të gjitha dokumentet që kërkoni.

Edmond Spaho – Në këtë rast a e parashikon ligji i koncesioneve për të kryer punime të tilla, që mund të fillojë me deklaratë paraprake?

Ariola Kodra – Deklarata paraprake nuk përfshin ndërtime të mirëfillta të objekteve, por përfshin rehabilitim të zonës dhe mirëmbajtje të saj.

Edmond Spaho – Unë insistoj, a e parashikon ligji që të fillojnë punimet me deklaratë paraprake? Çfarë thotë ligji, fillojnë punimet pas marrjes së lejes së ndërtimit, apo thotë që mund të fillojnë me deklaratë paraprake për të bërë mobilizimin e zonës?

Ariola Kodra – Edhe unë sapo iu përgjigja pyetjes suaj, i nderuar, që deklarata paraprake e punimeve përfshin rehabilitimin e zonës dhe mirëmbajtjen e saj.

Edmond Spaho – Të jemi të saktë dhe të ndershëm me njëri-tjetrin, unë nuk po pyes se çfarë ju ka autorizuar bashkia të kryeni, por po ju pyes: a e parashikon ligji deklaratën paraprake?

Ariola Kodra – E parashikon që mund të fillohen punime të mirëmbajtjes dhe të rehabilitimit.

Edmond Spaho – Tarifa që ju merrni nga Bashkia e Tiranës për periudhën 2017-2020 a parashikon depozitim dhe djegie, apo vetëm depozitim?

Ariola Kodra – Tarifa prej 29 eurosh, që merr shoqëria për shërbimin që ofron, parashikon të gjitha procedurat, që nga momenti i parë deri në procesin e fundit. Pra, që në momentin e parë, që futen kamionët me mbetje në zonën e trajtimit të mbetjeve Tiranë e deri në procesin e fundit. Pra, kryhet një trajtim në tërësi i mbetjeve.

Edmond Spaho – Unë po ju pyes saktësisht parashikon depozitim dhe djegie, apo vetëm depozitim?

Ariola Kodra – Parashikon tërësinë e proceseve që zhvillohen.

Edmond Spaho – Cila është tërësia e proceseve? Me se fillon dhe me se mbaron?

Ariola Kodra – Që nga momenti i hyrjes në momentin e peshimit të kamionëve të mbetjeve, regjistrimi, procedurat e rakordimeve, depozitimi në kantonin e selektimit, ku bëhet seleksionimi i mbetjeve, ku kalojnë materialet për riciklim dhe pjesa tjetër e mbetur kalon në

landfillin e ri, tashmë të ndërtuar nga shoqëria, të cilat kompostohen, dhe pastaj faza e fundit do të jetë incenerimi.

Edmond Spaho – Duhet të jetë apo ka qenë?

Ariola Kodra – Faza e fundit do të jetë incenerimi...

Edmond Spaho –Pra, do të jetë, nuk ka ndodhur për periudhën 2017-2020?

Ariola Kodra – Ndërtimi i impianteve të përpunimit të mbetjeve me prodhim energjie është në fazë ndërtimore brenda afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve.

Edmond Spaho – Ju lutem, unë po ju pyes me shumë qetësi dhe sapo kuptova që tarifa prej 29 eurosh për ton, në mos gaboj, përfshin nga hyrja e kamionit te gardhi i venddepozitimit, te dera kryesore, deri tek incenerimi, apo jo?

Ariola Kodra – Po, është një tërësi procedurash.

Edmond Spaho – Është kryer incenerimi gjatë kësaj periudhe 2017-2020?

Ariola Kodra – Sapo ua ktheva përgjigjen.

Edmond Spaho – Ne nuk po luajmë. Ju lutem! Unë kam të drejtën time, si deputet i Kuvendit, që, në kuadër të objektit për të cilin është ngritur ky komision, të pyes për këtë çështje dhe ju duhet të më thoni saktë. Nuk ka nevojë të bëjmë lojëra fjalësh që kuptojnë ose nënkuptojnë. Unë dua të di, me po ose jo, a është kryer incenerimi për këtë periudhë apo jo?

Ariola Kodra– Impiantet e përpunimit të mbetjeve me prodhim energjie janë në fazë ndërtimore, brenda afateve të grafikut të punimeve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

Edmond Spaho- Pra, a e kam gabim, nëse unë e kuptoj që ju, ndërkohë që keni marrë tarifën e djegies aq sa është, brenda 29 eurove, nuk është kryer djegie mbeturinash? A e kam gabim këtë?

Ariola Kodra– Kjo tarifë merret për të gjithë procesin që zhvillohet aktualisht në venddepozitimin në zonën e trajtimit të mbetjeve në Sharrë.

Edmond Spaho- Pra, ajo që unë kuptoj deri tani nga përgjigjet tuaja është që për periudhën 2017-2020 ju jeni paguar edhe për incenerimin, megjithëse incenerimi nuk është kryer, apo jo?

Ariola Kodra Kjo është një tarifë, që është mesatare përgjatë gjithë periudhës 30-vjecare të koncesionit.

Edmond Spaho- Faleminderit, e kuptova!

Jorida Tabaku- Faleminderit, zoti Spaho!

Unë kisha nevojë vetëm për një specifikim që e bëri zonja Çupi te pyetjet, por nuk arrita dot ta dëgjoja. Kur është data e fillimit të punimeve?

Ariola Kodra- Data e fillimit të punimeve është menjëherë pas zbardhjes së lejes së ndërtimit.

Jorida Tabaku- Pak më parë thatë që keni marrë një leje paraprake dhe keni nisur punimet në kushte të jashtëzakonshme të mjedisit.

Ariola Kodra Po, janë kryer punime të tipit: rehabilitim i zonës, vënie sigurie e ish-venddepozitimit, infrastrukturë e brendshme, gjelbërim, pra, punimet që përfshihen në këtë deklaratë paraprake punimesh.

Jorida Tabaku- Unë këtu kam kontratën tuaj koncesionare, por, njëkohësisht, kam edhe grafikun e punimeve, ku thuhet se grafiku i punimeve i detajuar fillon në datën e fillimit të punimeve. Kështu që ju na konfirmuat që keni marrë një leje paraprake dhe me këtë leje paraprake keni filluar punimet. Kjo do të thotë që ka filluar llogaritja e grafikut të punës dhe pagesa e tarifës, 29 euro për ton, të cilën e përmendi edhe zoti Spaho. Sipas kësaj kontrate, ju keni filluar marrjen e pagesës së parë 30 ditë pas firmosej së kësaj kontrate dhe jo ashtu siç na gënjyen kur ishim në incenerator, në janar të vitit 2018, por kjo kontratë është firmosur në gusht dhe, një muaj pas firmosej së kësaj ka lindur e drejta për fillimin e pagesave.

Edmond Spaho- Ju thatë që keni filluar punën me një deklaratë paraprake, bazuar në emergjencën. Kush e ka shpallur emergjencën, çfarë dokumenti dispononi ju që jemi në gjendjen e emergjencës mjedisore?

Ariola Kodra- Këtë dokument nuk e kam tani me vete, por jam e gatshme për bashkëpunim, sepse për këtë qëllim kam ardhur këtu.

Edmond Spaho- Pra, ju thoni që ka dokument, i cili ka shpallur gjendjen e emergjencës mjedisore. Pra, ka dokument, por nuk dini...

Ariola Kodra- Gjendja e emergjencës mjedisore është shpallur nga shteti, nga qeveria në atë kohë...

Edmond Spaho- Nga cili institucion?

Ariola Kodra- Konkretisht, nuk e kam të memorizuar tani se nga cili institucion.

Edmond Spaho- Por ju jeni në dijeni që ka dokument të tillë, apo jo?

Ariola Kodra- Zotëri, sapo ju përgjigja. Për çdo lloj dokumentacioni që kërkoni t'ju vihet në dispozicion, jemi të gatshëm t'ju a vëmë në dispozicion.

Arben Pëllumbi- Zonja kodra, unë do të doja të dija...

Jorida Tabaku- Zonja Kodra, unë e kuptoj që është shumë e rëndësishme që ju të komunikoni me njerëzit që jeni duke komunikuar me mesazhe, ku di unë, Mirel Mërtiri, Klodian Zoto, Stela Gugalli, por pak respekt për këtë komision, të lutem!

Të flasim, na dëgjoni!

Arben Pëllumbi- U bë e dyta herë që jeni në shkelje të procedurës. Në seancën e pyetjeve ne vetëm drejtojmë pyetje dhe marrim përgjigje, nuk bëjmë komente për këtë gjë.

Jorida Tabaku- Zoti Pëllumbi, unë i dëgjova komentet tuaja.

Arben Pëllumbi- Jo, nuk bëjmë asnjë koment, por bëjmë vetëm pyetje.

Jorida Tabaku- Këtu vijnë deputetët dhe pyesin, zonja rri në celular.

Arben Pëllumbi- Neve nuk lejohet të bëjmë komente të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Jorida Tabaku- Nuk është normale, pret përgjigjet nga celulari.

Arben Pëllumbi- Në qoftë se ju shqetëson celulari, i mbyllim celularët të gjithë.

Zonja Kodra, dua të di, në lejen e ndërtimit që ju keni marrë, a ka faza se çfarë punimesh do të kryeni dhe sesi do t'i kryeni ato punime?

Ariola Kodra- Po, leja e ndërtimit është e zhvilluar me disa faza, pra, objektet, që janë objekt i kontratës së koncesionit, kryhen në faza të ndryshme punimesh.

Arben Pëllumbi- E bëra këtë pyetje, sepse më intereson pyetja që do të bëj tani. Ju sot a bëni integrim të menaxhuar të mbetjeve?

Ariola Kodra- Po, patjetër që bëjmë!

Arben Pëllumbi- Pra, sot në landfillin e Sharrës apo në Sharrë ka akoma tymra që digjen dhe ndotin ambientin?

Ariola Kodra- Sot, në zonën e trajtimit të mbetjeve të Tiranës, ka ndryshuar tërësisht faqja, nuk është më në situatën ku ka qenë, ku kullosnin bagëtitë dhe njerëzit jetonin mbi grumbujt e plehrave, por është në fazën, ku ka përfunduar kapsulimi i venddepozitimit ekzistues dhe është kryer gjelbërimi i zonës dhe janë vendosur pusët e biogazit për të mbledhur të gjitha gazrat e këqij. Pra, çdo gjë është ndërtuar dhe rehabilituar në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare.

Arben Pëllumbi- Ju falënderoj!

Sot, në Sharrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku- Zoti Boçi, dua t'ju tërheq vëmendjen!

Ne shkuam tek inceneratori i Tiranës dhe unë nuk jam si zonja Dhima të them që ikët si njerëz me bisht, por ne shkuam atje dhe kolegët socialistë u zhdukën. Tani, ta dëgjojmë zotin Pëllumbi dhe të vazhdojë me pyetjet e përgjigjet.

Arben Pëllumbi –Si është situata e ujërave të ndotura sot në landfilldin e Sharrës?

Ariola Kodra- Sot, në zonën e trajtimit të mbetjeve të Tiranës është ndërtuar një impiant trajtimi për ujërat e ndotura të një teknologjie moderne, ku kanë përfunduar të gjitha ndërtimet civile. Këto janë vaskat e impiantit të trajtimit të ujërave, nga një pellg ujërash që ka qenë para marrjes në dorëzim të shoqërisë koncesionare. Pra, sot ujërat e ndotur nuk derdhen më pranë lumit Erzen.

Arben Pëllumbi- Një minutë se jam duke pyetur unë. Ajo është përgjigjja që unë dëshiroja. Pra, pyetja është: a ka sot ujëra të ndotura në Sharrë?

Jorida Tabaku- Të nderuar, kolegë, ju lutem, ta përfundojë pyetjen zoti Pëllumbi, sepse zoti Pëllumbi pyet, ndërsa zonja ka figura për çdo pyetje! Prandaj, le ta lëmë të përfundojnë pjesën e koordinimit dhe pastaj vazhdojmë ne.

Arben Pëllumbi- Sa për koordinimin, ju keni qenë shumë herë më të koordinuar, ju përgëzojmë për këtë gjë dhe shumë mirë që jeni të koordinuar!

Unë nuk e dija që zonja kishte fotografi, por shumë mirë që i paska. Ne nuk kishim nevojë për ato fotografi, sepse ne kemi qenë në terren dhe e kemi parë këtë gjë, siç e patë edhe ju, dhe ato janë pamje që i pamë javën e kaluar. Gjithsesi, duke qenë se Sharra ishte ajo që ishte, që ndotte ashtu siç ndotte, jo vetëm në ajër, por edhe në nëntokë, ajo që na intereson sot të dimë është kjo: meqenëse tarifa në Tiranë është ngritur, ne duam të dimë për paratë që paguajnë më shumë qytetarët e Tiranës, a e marrin sot shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin që ju keni marrë në koncesion? Qytetarëve u intereson pak se çfarë bëni ju aty brenda, nëse inceneroni apo nëse prodhoni energji elektrike, ose jo, për ata është e rëndësishme të kenë ajër të pastër dhe nëntokë të pastër. Në çfarë faze jemi sot?

Jorida Tabaku- Një sekondë. Kam një koment për pyetjen e zotit Pëllumbi. Zoti Pëllumbi, dua t'ju rikujtoj objektin e këtij komisioni hetimor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëri zoti Pëllumbi për të miat dhe unë po ia rikujtoj. Zoti Xhafaj, nuk kam nevojë për sufler. Dua t'ju rikujtoj se objekti i këtij komisioni hetimor janë procedurat e dhënies me

koncesion. Ju lutem, të fokusohemi të procedurat e dhënies me koncesion të impiantit të trajtimit të mbetjeve të integruar të Sharrës!

Arben Pëllumbi- Më vjen shumë mirë, zonja kryetare, që ndërhytë, sepse kjo tregon që pyetja ime ishte e duhura dhe ju dogji, sepse, në fakt, ai është qëllimi kryesor për ne. A kemi ne sot menaxhim të integruar të mbetjeve në zonë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që në momentin kur e keni filluar këtë diskutim nuk e kuptoni se çfarë është menaxhimi i integruar i mbetjeve. Menaxhimi i integruar i mbetjeve do të thotë të mos kesh transmetim në ajër dhe të mos kesh ndotje nëntokësore. Nëse këtë e bën me landfilld, me incenerator, apo me forma të tjera, këto janë terma të kontratës, por mënyra sesi janë zbatuar është diçka tjetër. Qytetarëve u intereson nëse ajri është pastër, nëse në zonën e Kombinatit kemi ende atë ndotje, nëse ndoten përsëri ujërat nëntokësore, siç pamë në Elbasan, nëse kemi rrjedhje në të...

Jorida Tabaku - A ka vjedhur apo jo këtu me këtë kontratë? Këtu jemi ne.

Arben Pëllumbi – Për pjesën tjetër, janë terma të kontratës. Për fat të mirë, institucionet ligjzbatuese janë duke u marrë me këto gjëra. Kështu që ne të përqendrohemi në atë që është detyra jonë dhe detyra jonë është politike, nuk është penale.

Jorida Tabaku – A keni përgjigje për pyetjen e zotit Pëllumbi?

Ariola Kodra – Sot qytetaret e Tiranës kanë një zonë trajtimi mbetjesh me një teknologji moderne. Sot nuk ka më një hotspot si dikur, kur ishin grumbuj të mëdhenj mbetjesh, ku njerëzit jetonin mbi to, ku bagëtitë kullosnin mbi to, ku cilësia e ajrit ishte katastrofike. Sot janë të gjithë parametra mjedisorë të standardeve të kërkuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë mund t'jua provojmë edhe nëpërmjet analizave periodike që bëhen.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Pyetja e fundit: a jeni ju në afatet e termave të kontratës për ndërtimin e inceneratorit?

Ariola Kodra – Po, jemi brenda afateve të ndërtimit të impianteve të përpunimit të mbetjeve me prodhim energjie.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Kodra, unë ju bëra një pyetje dhe nuk mora një përgjigje. Më thatë: “Data e fillimit të punimeve është me datën e marrjes së lejes paraprake”; nuk mora ende përgjigje për këtë. Ndërkohë që zotëria në kantier, zoti Elton, drejtuesi teknik, nuk ia di mbiemrin,

na tha se data e fillimit të grafikut të punimeve është data e zbardhjes së lejeve të ndërtimit, për këtë arsye ne jemi me vonesë. Unë po lexoj kontratën këtu e thotë ndryshe. Cila është e vërteta?

Ariola Kodra – Po, data e fillimit të punimeve është data pas zbardhjes së lejeve të ndërtimit. Ajo që thashë për deklaratën paraprake, janë punime të tipit rehabilitim, infrastrukturë e brendshme dhe gjelbërim.

Jorida Tabaku – Sapo i pranuat zonjës Çupi që keni filluar punimet në vitin 2018.

Ariola Kodra – Këtë i pranova edhe zonjës Çupi që deklarata paraprake përfshin punime të tipit rehabilitim, infrastrukturë e brendshme, gjelbërime, sistemime të zonës.

Dhurata Çupi – Që të jemi të qartë: nga viti 2017 deri në vitin 2020 ju nuk e keni marrë tarifën 29 euro? Kaq e thjeshtë është, sepse me deklaratë paraprake nuk konsiderohet fillim punimesh dhe me rehabilitimin e zonës, nuk konsiderohet që ju e kryeni të gjithë procesin e kontratës. Pyetja është e thjeshtë: nga viti 2017, që nuk keni pasur leje ndërtimi, deri në vitin 2020, që jeni pajisur me leje ndërtimi, a i ka marrë shoqëria 29 euro për të gjithë procesin që ka kontrata?

Ariola Kodra – Shoqëria ofron një shërbim të caktuar dhe për këtë shërbim, që ofron, merr një tarifë depozitimi që është përcaktuar në kontratën e koncesionit.

Dhurata Çupi – Pra, ju merrni 29 euro nga viti 2017, ndërkohë që punimet kanë filluar në vitin 2020 dhe objekti i procesit të fundit, pra i djegies së këtyre mbetjeve, ende nuk ka filluar? Kaq e thjeshtë është.

A ka mundësi të ma sqaroni?

Jorida Tabaku – Në fakt, këtë pyetje po bëjmë të gjithë.

Ariola Kodra – Punimet kanë nisur me deklaratën paraprake, dhe unë sapo jua thashë, në vitin 2017 të tipit rehabilitim, sistemim dhe infrastrukturë.

Dhurata Çupi – Dhe ndërkohë keni marrë 29 euro?

Ariola Kodra – Sigurisht që është marrë, sepse ofrohet një shërbim i caktuar.

Jorida Tabaku – Shërbimi i caktuar ofrohet i plotë, siç na i parashikuarat ju dhe na i prezantuat ju, me trajtimin e mbetjeve. Ju konsideroni se fillimi i punimeve është gjelbërimi. Domethënë, keni marrë tarifën e plotë për incenerim 29 euro për ton/mbetje dhe keni gjelbëruar zonën këtë, po pyesim që të gjithë?

Ariola Kodra – Tarifa nuk është marrë për gjelbërimin e zonës, por është marrë për vënien në siguri dhe për rehabilitimin e zonës që në momentin kur është marrë në dorëzim dhe gjatë gjithë periudhës 30-vjeçare që do të jetë koncesioni.

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi e ka kërkuar fjalën për procedurë.

Arben Pëllumbi – A mund të bëj një shtesë të pyetjeve, siç u bëri zonja Çupi pyetjeve të saj?

Zonja Kodra, dua t’ju pyes, edhe në vazhdim të pyetjeve të kolegëve të opozitës: a keni ju një shkop magjik që ditën e parë, kur morët 29 euro, ju ta përfundoni komplet impiantin dhe ne të ishim të qetë që ju atë ditë, kur morët 29 eurot e parë për ton, ta kishit përfunduar këtë proces? A e keni një shkop magjik të tillë?

Jorida Tabaku – Ose një fotografi që të na e tregoni shkopin magjik?

Ariola Kodra – Fatkeqësisht, shkopin magjik nuk e kemi, do të ishte shumë mirë sikur ta kishim.

Arben Pëllumbi – Në fazat tuaja të ndërtimit dhe të funksionimit të impiantit të mbetjeve të integruara në sh.a., a është edhe faza e parapërgatitjes së këtij terreni për fazat e tjera të mëvonshme, të cilat më pas janë nëpërmjet lejeve të ndërtimit, që ju morët në nëntor të vitit 2020, apo duhet të prisni derisa të merrej leja në nëntor të vitit 2020 dhe ne të vazhdonim me emergjencën mjedisore, me ndotjet dhe me tymrat bashkë?

Ariola Kodra – Pikërisht kjo ishte ajo që doja të thosha, dhe u përpoqa të thosha edhe më parë. Pra, nëpërmjet asaj deklarate paraprake u përgatit i gjithë terreni, u rehabilitua zona dhe deri në ditën ku jemi sot që vazhdojnë procedurat e mëtejshme.

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, për procedurë.

Eduard Shalsi – Dy çështje kam. Përsëri iu hakërryhet për telefonin, ndërkohë që po shkruani tani mesazhe në celular.

Dua t’ju kujtoj juve, të nderuarës zonjës Çupi dhe deputetëve të tjerë, që bashkërisht kemi firmosur dhe kemi miratuar një ligj, Kodi Etik, i cili ndalon përdorimin e telefonove dhe celularëve për deputetët gjatë punimeve të komisionit. Shembulli, minimalisht më i mirë që mund të jepnim, ishte që, teksa e pyesim, flasim, vetë të respektojmë, gjë që nuk po e bëjmë. Fakti që edhe mua mund të më bëj përshtypje, por, duke mbajtur celularin në dorë, nuk ma jep këtë të drejtë, e solla thjesht në vëmendjen tuaj. Kjo ishte e para.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e bëra për argument, por e kam shumë të rëndësishme etikën. E thashë që edhe përmbajtjen e vlerësoj, por vlerësoj shumë edhe formën. Ndaj, e bëra këtë ndërhyrje; kaq! Nuk synonte gjë tjetër.

Së dyti, shumë e drejtë pyetja që i drejtuat, por e drejtuar pyetja 4 herë apo 5 herë mendoj modestisht që nuk do të ishte efikase për kohën, të cilën të gjithë e kemi shumë të çmuar, sepse përgjigjja ishte e njëjtë, pra...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Çupi, të lutem, kam marrë mikrofonin, nuk ju ndërpreva, ju dëgjoj me shumë durim, edhe kur nuk bie dakord. Pra, ka një deklaratë paraprake për fillim punimesh me ato fusha të parashikuara, ka një leje ndërtimi, pyetjet tuaja ishin shumë të qarta dhe përgjigjet ishin po aq të qarta dhe nuk ndryshoi gjë se pyetja u përsërit 5 herë. Po të njëjtën gjë, që tha herën e parë, e tha edhe herën e dytë dhe herën e tretë. Nuk dua të vë kurrsesi në dyshim, jo të drejtën tuaj për pyetje, por nga pyetjet tuaja edhe unë dua të mësoj më tepër për këtë gjë. Thjesht sugjerimi im i dytë kishte të bënte me përdorimin në mënyrë pak më efikase të kohës; kaq.

Jorida Tabaku – Edhe unë e falënderoj zotin Shalsi! Kërkoj ndjesë përdorimin e celularit, por, ndërkohë që zonja është këtu, dashamirës të shumtë më kanë nisur listën e pagesave të zotit Edmond Arqile Bllako edhe pas periudhës që zonja ka qenë administratore e inceneratorit të Tiranës. Në fakt, kjo ishte arsyeja që po konsultoja pagesat. Që t’i rikthehem edhe një herë çështjes sime për zotin Edmond Arqile Bllako. Zotëria është punësuar nga kompania që ju jeni në administrim ose kompani të tjera? Si justifikohet pagesa që ai ka vazhduar dhe ka marrë deri në fund të vitit 2019?

Ariola Kodra – Aktualisht që flasim zotëria nuk është punonjës i shoqërisë “*Integrated Energy BV SPV*”.

Jorida Tabaku – As në periudhën kur ju keni qenë administratore, nuk ka marrë asnjë pagesë?

Ariola Kodra – Unë nuk mund t’i mbaj mend të gjitha pagat e punonjësve përmendësh.

Jorida Tabaku – Sapo deklaruar që nga periudha 19.03.2019 zotëria nuk ka marrë asnjë pagesë.

Ariola Kodra – Jo, jo, nuk thashë nuk ka marrë asnjë pagesë. Thashë që zotëria është punësuar në kohën para administrimit tim. Këtë thashë. Nuk thashë nuk ka marrë asnjë pagesë.

Jorida Tabaku – Nuk është marrë në punë nga ju, e kam keqkuptuar unë atëherë.

Ariola Kodra – Po, zotëria është punësuar nga një administrator, paraardhës imi.

Jorida Tabaku – E kuptova.

Aktualisht a është i punësuar zotëria?

Ariola Kodra – Aktualisht jo, nuk punon pranë shoqërisë.

Jorida Tabaku – Në cilin vit është larguar nga shoqëria?

Ariola Kodra – Në mos gaboj, është larguar në vitin 2019-2020; nuk jam shumë e qartë për këtë; duhet ta verifikoj.

Jorida Tabaku – Unë dhe zoti Këlliçi kemi pagesa, të paktën deri në fillim të janarit 2020, që...

Ariola Kodra – Këtë duhet ta verifikoj, sepse nuk më kujtohet.

Jorida Tabaku – Ju kujtoj që të na e sillni, krahas dokumenteve të tjera, edhe këtë informacion për punësimin e zotërisë.

Pyetjeve që referon zonja Çupi lidhen me grafikun e punimeve që ne e kemi analizuar këtu në detaje. Unë do të kisha dëshirë që ju të na i siguronit të gjitha stacionet që ia keni dorëzuar njësisë së zbatimit të projektit. Sipas grafikut të punimeve që kam këtu, kontrata koncensionare nuk është zbatuar saktë. Sot ne duhej ta kishim përfunduar procesin e incenerimit, duke llogaritur datën e fillimit të punimeve që në momentin kur keni marrë lejen paraprake dhe keni filluar punimet, sepse për të gjitha efekte e buxhetit të shtetit ju e keni marrë pagesën 29 euro për ton/mbetje për ta kryer të gjithë procedurën, pra nuk do të kishit një shkop magjik për ta filluar sot procedurën, por për ta zbatuar këtë grafik punimesh është në dorën tuaj, apo jo?!

Ariola Kodra – Në momentin e zbardhjes së lejes së ndërtimit nga ana e shoqërisë është propozuar një grafik i ri, i rishikuar dhe i riorganizuar, i cili është miratuar nga supervizori i punimeve dhe është depozituar pranë autoritetit kontraktor. Grafiku i ri edhe i rishikuar ka të përcaktuara të gjitha afatet e periudhës së ndërtimit.

Pas zbardhjes së lejes së ndërtimit, është riorganizuar dhe është rishikuar edhe një herë grafiku nga ana e shoqërisë.

Jorida Tabaku – Është amenduar kontrata koncesionare dhe është bërë pjesë, sepse kjo është kontrata koncesionare zyrtare?

Ariola Kodra – Është depozituar pranë autoritetit kontraktues, i miratuar nga supervizori dhe nga NJZP-ja.

Jorida Tabaku – Ne u kemi kërkuar institucioneve shtetërore të na dorëzojnë kontratën përfundimtare zyrtare të koncesionit dhe na kanë dorëzuar këtë. Nuk kemi asnjë informacion tjetër.

Zotëria që takuam atë ditë në impiant, na siguroi se ky është grafiku i punimeve, por nuk ka filluar në atë datë që thoni ju, tha, po ka filluar pak më vonë. Pra, ky është informacion i ri që po e dëgjoj për herë të parë.

Ariola Kodra – Bashkëlidhur asaj kontrate koncesioni, aneks, pjesë përbërëse është edhe grafiku i ndërtimit. Grafiku i ri ndërtimit është rishikuar dhe riorganizuar nga ana e shoqërisë dhe është depozituar pranë autoritetit kontraktues.

Jorida Tabaku – Atëherë, që ta përfundoj edhe unë këtë dhe t’ia jap fjalën zotit Këlliçi, po pati mundësi, kërkoj të më depozitoni pranë këtij komisioni kontratën me zotin Edmond Bllako dhe pagesat e tij, njëkohësisht, edhe grafikun e ri të punimeve që, normalisht, duhej të ishte, por nuk është.

Cili është supervizori i punimeve të inceneratorit të Tiranës?

Ariola Kodra – Supervizori i punimeve është shoqëria “AVE Consulting sh.p.k”.

Jorida Tabaku – Në pronësi të kujt është kjo shoqëri? Kush është administratori, nëse keni dijeni?

Ariola Kodra – Zoti Arben Dervishi.

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Në vijim të informacioneve të dhëna nga ana e institucionit për nevoja të hetimit, kërkoj të administrohen pranë sekretarisë së komisionit të gjitha fotot e pasqyruara nga zonja Kodra.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Këlliçi!

Belind Këlliçi – Faleminderit!

Unë do të kërkoja të ezauroj tri pyetje e një konstatim që kam dhe nuk flas më, se e kuptoj që ka shumë interes për t’i drejtuar pyetjet.

Zonja Kodra, ju deklaruat se me shtetasin Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto nuk keni pasur kontakte të drejtpërdrejta, apo jo?

Ariola Kodra – Po, marrëdhënia e punës është mbajtur nëpërmjet punonjësve të shoqërisë.

Belind Këlliçi – Pra, ju, personalisht, nuk keni kontakt me këta dy shtetas?

Ariola Kodra – Kontakt aktualisht nuk kam; në këto momente që po flasim nuk kam.

Belind Këlliçi – Atëherë, a mund t’i përgjigjeni këtij komisioni se kur ka qenë hera e fundit që ju jeni takuar me këto dy shtetas, që sot janë të shpallur në kërkim ndërkombëtar?

Ariola Kodra – Unë iu përgjigja kësaj pyetjeje një herë dhe nuk është e nevojshme t'i rikthehemi dhe ta ripërsërisim. Unë sapo e dhashë përgjigjen pak më parë që nuk e kam të memorizuar kohën kur jam takuar apo kur kam folur për herë të fundit me këta shtetas, ose më saktë me këta zotërinjtë,5 me të cilët kemi një marrëdhënie kontraktuale.

Belind Këlliçi – A e kuptoni që, nëse këtu në këtë komision administrohen prova të pakontestueshme, audio dhe video të takimeve tuaja me këta dy shtetas, ju mbani përgjegjësi penale?

Ariola Kodra – Unë nuk thashë se nuk jam takuar ndonjëherë, por thashë se nuk mbaj mend kohën dhe periudhën.

Belind Këlliçi – Unë kam tri pyetje:

1. Nga studimi i fizibilitetit për projektin e inceneratorit të Tiranës të hartuar nga Ministria e Mjedisit rezulton se në analizën financiare të këtij projekti janë të parashikuara të gjitha kostot e realizimit të projektit, duke përfshirë shpenzimet fillestare, kostot kapitale, kostot operative dhe ato të mirëmbajtjes. Nga verifikimi i pagesave që shoqëria “*Integrated Energy BV SPV*” ka kryer, rezulton se, ndër të tjera, i është paguar shuma rreth 65,8 milionë lekë të rinj, pra 658 milionë lekë të vjetër kompanisë “*Zoto Consulting sh.p.k.*”, krijuar në 14.09.2017 me ortëk 90% Klodian Zoton dhe “*Consulting SE Partners*”, Stela Gugallen.

Klodian Zoto ka përfituar 24 milionë lekë dhe Stela Gugallja 41,8 milionë lekë.

Ju lutem, a mund të na tregoni se për cilat shërbimet janë paguar Klodian Zoto dhe Stela Gugallja nga kompania “*Integratet Energy BV SPV*”, pra nga vetvetja?

Ariola Kodra – Kompania “*Integrated Energy BV SPV*” ka marrëdhënie kontraktuale dhe jo nga vetvetja, siç ju e përmendët, me shoqërinë “*Zoto Consulting*”, e cila ofron konsulencë ligjore, dhe nga shoqëria “*Consulting SE*”, e cila ofron konsulencë financiare.

Belind Këlliçi – E përmend nga vetvetja, për shkak se zoti Klodian Zoto figuron që të jetë aksioner në këtë shoqëri dhe, sigurisht, paguan një kompani tjetër, në të cilën është po aksioner, pra paguan vetën në këtë rast.

Ariola Kodra – Zoti Klodian Zoto nuk është aksioner i shoqërisë “*Integrated Energy BV SPV*”. Aksionerët e shoqërisë i keni të listuar në ekstraktin e përfituesve fundorë, që e aksesoni në QKB.

Belind Këlliçi – Dakord. Kontratat me këto dy kompani, “*Zoto Consulting sh.p.k*” dhe “*Consulting SE Partners*” a mund të na i vini në dispozicion pranë këtij komisioni?

Ariola Kodra – Po, mund t’jua vendosim në dispozicion.

Belind Këlliçi – Dakord.

Pyetja 2: referuar studimit të fizibilitetit, rezulton se janë parashikuar në mënyrë të detajuar plani i shpenzimeve për realizimin e inceneratorit të qarkut të Tiranës, nga ky plan i shpenzimeve, zëri “udhëtime” nuk rezulton në asnjë resht. Nga verifikimi i shpenzimeve të “*Integrated Energy BV SPV*”, rezulton se janë shpenzuar për blerje biletash udhëtimi një shumë prej 80,4 milionë lekësh të rinj, pra 804 milionë lekësh të vjetër. A mund të na shpjegoni se cila është arsyeja që kompania e inceneratorit të qarkut të Tiranës ka shpenzuar këtë shumë, në raport me nevojën e realizimit të inceneratorit të Tiranës dhe përfundimit të punimeve etj., etj?

Ariola Kodra – Shumën e saktë nuk e kam parasysh aktualisht dhe nuk di t’i referohem asaj shume që ju përmendni, por punonjës të ndryshëm të shoqërisë kanë bërë udhëtime pa dyshim nëpër shtete të ndryshme për t’u takuar me kontraktorë të mundshëm, të cilët do të marrin pjesë në realizimin e veprave të zonës së trajtimit të mbetjeve në Sharrë.

Belind Këlliçi – Atëherë, këta persona të kompanisë, që kanë udhëtuar për të takuar këta kontraktorë, që unë ua garantoj se shuma që unë ju them është e saktë, 804 milionë lekë për udhëtime, a mos do të duhej të ishin përfshirë në studimin e fizibilitetit fillimisht, në zërat e shpenzimeve për udhëtime, sepse nuk figuro askund? Kjo është një shumë e konsiderueshme, jo e vogël.

Ariola Kodra – Sa për pjesën e studimit të fizibilitetit, nuk mund të flas dot me kompetencë tani, sepse është një dokumentacion i hartuar shumë kohë përpara dhe nuk kam qenë pjesëmarrëse në këtë...

Belind Këlliçi – Pyetja 3: nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave të kryera për llogari të inceneratorit të qarkut të Tiranës rezulton se kompania “*Integrated Energy BV SPV*” ka pasur marrëdhënie financiare me kompaninë “*Pivo 04 dhe AS Group*”, të cilat kanë vetëm dy punonjës, zero mjete dhe kompani të proceduara penalisht për evazion fiskal dhe mashtrim financiar. Këto dy kompani janë subjekt hetimi nga SPAK-u për veprat penale në fushën e krimeve financiare të përfshira në hetimet që po zhvillohen ndaj ish-ministrit, Lefter Koka. A mund të na sqaroni se çfarë marrëdhëniesh juridike kontraktuale apo financiare keni pasur me këto dy kompani?

Ariola Kodra – Shoqëria ka marrëdhënie kontraktuale me shumë shoqëri, të cilat unë nuk i mbaj mend të gjitha përmendësh. Mund të jenë 30-40 shoqëri nënkontraktore që kryejnë punime.

Belind Këlliçi – Meqë këto dy kompani janë të proceduara penalisht për evazion fiskal dhe mashtrim financiar nga SPAK-u, a mundet që kontratat, që keni me këto dy kompani, t'i vini në dispozicion të këtij komisioni?

Ariola Kodra – Dua të bëj me dije për të gjithë ju që të gjithë dokumentacionin teknik, ligjor dhe kontraktual apo financiar e ka marrë në dorëzim SPAK-u. Për këtë disponojmë procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe urdhrat e sekuestrimit nga SPAK-u për të gjithë dokumentacionin e shoqërisë.

Jorida Tabaku – Edhe unë dua t'ju kujtoj, zonja Ariola Kodra, që ky komision është ngritur me një vendim të Kuvendit dhe ka të gjithë autoritetin, tagrin dhe përgjegjësinë që të marrë çdolloj informacioni në kuadrin e tij të hetimit.

Zoti Këlliçi ju kërkoi që të na i vendosni në dispozicion këto dy kontrata. Se çfarë marrëdhënies keni ju me SPAK-un, nuk i takojnë këtij komisioni. Ne nuk do të mbivendosim punën e SPAK-ut. Ne kërkojmë informacionin për këto kontrata.

Belind Këlliçi – Atëherë, për t'u rikthyer te pika 2, te shpenzimet për udhëtime, a i qëndroni deklaratës që kjo shumë, që ju nuk e kujtoni, por që unë po e përmend se është 804 milionë lekë të shpenzuara për zërin “udhëtime” është bërë për të takuar kontraktorë jashtë Shqipërisë gjatë viteve të fundit?

Ariola Kodra – Po, i qëndroj kësaj fjale. Drejtues të shoqërisë kanë udhëtuar jashtë Shqipërisë për të takuar kontraktorë të ndryshëm, të cilët do të marrin pjesë në ndërtimin e impianteve objekt të kontratës së koncesionit. Të gjitha pajisjet e impianteve të trajtimit të mbetjeve me prodhim energjie apo impiante të nevojshme për zonën e trajtimit prodhohen jashtë Shqipërisë.

Belind Këlliçi – Dakord.

A jeni në dijeni që në 16 muajt e fundit e gjithë bota ka qenë në një situatë pandemie globale?

Ariola Kodra – Po, sigurisht që jam në dijeni.

Belind Këlliçi – A e kuptoni që gjatë pandemisë të gjitha udhëtimet kanë qenë të kufizuara, pra nuk ka pasur udhëtime zyrtare?

Ariola Kodra – Unë nuk përcaktova afate udhëtimesh. Nuk përcaktova afate udhëtimesh.

Belind Këlliçi – Ja, ta mbaroj, se jam në mes të fjalës.

Pyetja e fundit: a i qëndroni faktit që ju emëruar administratore më 15. 3. 2019? Gjatë periudhës që jeni emëruar administratore, zoti Edmond Arqile Bllako nuk ka qenë punonjës i kësaj kompanie.

Ariola Kodra – Unë thashë se zoti Edmond Bllako ka qenë punonjës i kësaj shoqërie dhe është pushuar para periudhës së administrimit tim.

Belind Këlliçi – Në rregull! Nëse mund t'ju bëj një pyetje, me siguri që ju do të thoni se nuk e mbani mend, por unë kam disa informacione dhe tabela, të cilat detajojnë faktin se zotëria në fjalë është paguar për një periudhë nga viti 2018 deri në janar të vitit 2020, me shumën rreth 150 milionë lekë të vjetra. Kjo përkon edhe me periudhën gjatë së cilës ju keni qenë administratore. Ky fakt ju kujtohet? Ju kujtohet kjo shumë prej 150 milionë lekësh, që ju i keni paguar këtij zotërie?

Ariola Kodra – Sikurse jua përmenda edhe më herët, unë nuk i mbaj mend të gjitha pagat e punonjësve të shoqërisë. Janë rreth 140 e ca punonjës në shoqëri.

Belind Këlliçi – Dakord! Unë këto pyetje kisha.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Atëherë, e ka kërkuar fjalën zoti Pëllumbi. Pastaj do ta kem unë fjalën për procedurë, ndërsa më pas do ta marrë fjalën zonja Zhupa për pyetje.

Arben Pëllumbi – Të nderuar kolegë,

Edhe një herë tjetër, ajo që unë kam kërkuar në vazhdimësi në këtë komision, që ka të bëjë edhe me objektin tonë, u rikonfirmua nga fakti që një pjesë e dokumentacionit sot disponohet nga SPAK-u, i cili ka një hetim në proces. Kësisoj, ne nuk duhet t'i mbivendosemi atij kërkimi të të njëjtave dokumente, të cilat janë në proces hetimi. Kjo është mbivendosje. Unë nuk di një fjalë tjetër. Për sa kohë ato janë dokumente që lidhin marrëdhënie private midis privatëve, vetëm gjykata dhe prokuroria kanë të drejtë t'i hetojnë. Ne nuk kemi tagër, që të mund të kërkojmë marrëdhënie midis privatësh.

Etjen Xhafaj – Po, për procedurë.

Komisioni hetimor ka një objekt, i cili është i shkruar në Rregulloren e parlamentit, që ne nuk mund t'i pyesim gjithë njerëzit për çfarë na vjen. Unë do të doja shumë që t'i përmbaheshim atij që është objekti. Pra, në fund të ditës, të gjithë këtu janë për të bërë pyetje, dhe janë tërësisht të justifikuar në lidhje me pyetjet që bëjnë, për sa kohë pyetjet përbëjnë faktorë në lidhje me atë që është objekti i Komisionit Hetimor. Pra, ne mund të pyesim në lidhje me një pafundësi gjërash,

po për sa kohë lidhen me këtë që është çështja jonë. Jo të rrimë e të gjykojmë se çfarë ka bërë një kompani private për këtë gjë apo për atë tjetrën, në bazë të gjykimit të logjikës së gjithësecilit.

Unë thjesht po them që t'i qëndrojmë atij që është objekti i këtij Komisioni hetimor si dhe gjërave, të cilat kanë lidhje me hetimin që ne po kryejmë.

Falemnderit!

Jorida Tabaku – Po e marr fjalën edhe unë për të sqaruar dy gjëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj, pyetja ishte shumë e qartë. Unë kam këtu bilancet e kompanisë, të cilat i kam parë me shumë kujdes, i kam analizuar dhe i kam lexuar një nga një. Shqetësimi që ngriti zoti Këlliçi është: 400 mijë euro për bileta në vitin 2019, kur ishte bllokuar i gjithë udhëtimi. 720 mijë euro gjithsej. Ky është shqetësimi. Mos kemi këtu çështje të pastrimit të parave? Sepse po diskutojmë për fonde publike. Ky është shqetësimi kryesor, që më ka dalë edhe mua nga analiza e bilanceve.

Pyetja e dytë që kam unë, po nga analiza e bilanceve: kompania e inceneratorëve ka përdorur në total një fond prej 450 mijë dollarësh për sa i përket shpenzimeve të publicitetit. Për çfarë keni bërë publicitet ju?

Së dyti, keni një fond prej 1, 3 milionë eurosh për sponsorizime për shkolla dhe marrëveshje me shkollat. Për çfarë është përdorur ky fond?

Ariola Kodra – Shifrat të cilave ju i referoheni nuk i mbaj mend saktësisht. Sa u takon kontratave të sponsorizimit, si çdo shoqëri private, ka të drejtë të lidhë kontrata reklamash apo spotesh publicitare. Gjithashtu, edhe sponsorizimi për shkolla të ndryshme apo marrëveshjet që kemi lidhur me universitete të ndryshme.

Jorida Tabaku – Atëherë, unë ju pyeta qartësisht: jeni administratore e kompanisë. Për çfarë bën reklamë një kompani inceneratorësh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fondet publike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një mesazh i përbashkët nxiti në kor të gjithë deputetët socialistë.

Jorida Tabaku – Zonjë, këtu kam pagesat që ka bërë kompania juaj për mediat. Për çfarë keni bërë pagesa për mediat dhe çfarë keni bërë sponsorizime për shkollat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, shqetësimi im është: zonja Ermonela Felaj na lexoi ca artikuj të disa profesorëve të nderuar të Universitetit Bujqësor. Zonja sapo e pranoi se kemi kontrata sponsorizimi me shkollat e me universitetet. Tani, a janë blerë këta artikuj apo jo? Me fondet publike, a është blerë kjo lloj reklame? Kjo është çështja.

Ariola Kodra – Sa u përket reklamave, ju thashë se çdo subjekt privat ka të drejtën për të bërë reklama në medie të ndryshme apo portale të ndryshme. Sa u përket marrëveshjeve të sponsorizimit apo bashkëpunimit, po kemi marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme të Tiranës, në kuadrin e integritetit e të ardhjes në ndihmë për pjesën e studentëve, të cilët studiojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Zona e trajtimit të mbetjeve është kthyer edhe në një auditor studimi, po themi, ku studentë të ndryshëm kryejnë praktikën mësimore. Nuk besoj se këtu ka diçka të keqe, për t'u diskutuar.

Jorida Tabaku – Jo, absolutisht! Me Universitetin Bujqësor të Tiranës, me profesor Seitin, që lexoi zonja Felaj, a keni një marrëveshje konsulence?

Ariola Kodra – Me Universitetin Bujqësor kemi një marrëveshje bashkëpunimi.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Atëherë, unë do t'ju kërkoja që t'i vendosni këtij komisioni hetimor listën e sponsorizimeve prej 1 milion e 300 mijë eurosh për universitetet dhe shkollat, por njëkohësisht edhe listën e pagesës së medieve. Unë kam këtu 450 mijë euro, të cilat më dalin nga bilanci juaj. Të them të drejtën, duke lexuar bilancin tuaj, them se është më profesional se ai i Elbasanit dhe i Fierit, por e kuptova se paska edhe Stela Gugallja një kompani auditimi, që ndoshta ju ndihmon për këtë çështje. Besoj se është e nevojshme për transparencën.

Pyetja e fundit që kam, në lidhje me bilancin: kam këtu pagat e kompanisë së inceneratorit, të cilat janë paga tri herë më të larta se mesatarja e tregut. Janë paga, të cilat paguhen me fondet publike.

Arben Pëllumbi – Çfarë statusi ka kompania juaj, që ta marrim vesh? Çfarë statusi është? Sh. p. k, sh. a, çfarë është?

Jorida Tabaku – Pse ka marrë 35 milionë euro kompania e inceneratorëve? Pse pagat e koncesionarit janë tri herë më të larta se pagat mesatare të tregut?

Po, zonja Kodra.

Ariola Kodra – Shoqëria është shoqëri private dhe ka të drejtë t'i vendosë standardet e pagave në varësi të politikave të saj.

Arben Pëllumbi – A i paguani ju sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, në varësi të këtyre pagave?

Ariola Kodra – Po, patjetër që i paguajmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Pagat, të cilat janë në nivelin e 7 mijë eurove, pagat e inceneratorit, që në inceneratorin e Tiranës variojnë nga 7 mijë euro janë më të larta se tregu dhe çdo lloj page tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj, nuk dëgjoj! Ju lutem, nuk dëgjoj!

Janë më të larta se tregu dhe çdo gjë tjetër. 7 mijë euro. E të mos harrojmë: janë 35 milionë euro, të cilat janë paguar me fondet publike për këtë kontratë inceneratori. Ky është shqetësim, se ne fondet publike po shohim këtu. Si përdoren e shpërdorohen fondet publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ariola Kodra – Shoqëria nuk operon me fonde publike, por me fondet e saj private.

Jorida Tabaku – Shoqëria operon me fonde, dhe më vonë do t'ju tregoj unë se si operon me fondet publike, nga raportet të Ministrisë së Financave.

Fjalën e ka zonja Ina Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Kodra, fillimisht, para se të parashtrij pyetjet në lidhje me kompaninë, desha t'ju pyesja: si jeni njohur me hapjen e pozicionit si administratore në këtë kompani? Pra, keni bërë një konkurs? Keni bërë një intervistë? Si e keni marrë informacionin, që jeni bërë administratore e kësaj kompanie?

Ariola Kodra – Ky pozicion më është propozuar, sikurse e përmenda edhe më herët, nga ana e administratorit të kësaj shoqërie, aktualisht administratori teknik, zoti Giuseppe Ciafaglione.

Ina Zhupa – Ju keni pasur kontakte vetëm me këtë person? Nuk i njihni ortakët e tjerë të kompanisë, holandezë, shqiptarë? Apo i njihni?

Ariola Kodra – Me ortakët e tjerë të shoqërisë i mban komunikimet zoti Ciafaglione.

Ina Zhupa – Në rregull!

Bazuar në përmbajtjen e kontratës koncesionare, të lidhur me Ministrinë së Mjedisit dhe kompanisë që ju administroni, më datë 31. 8. 2017, konkretisht pika 2/1 e kontratës, a mund të na thoni sa nga fazat e projektit janë ndërtuar deri tani, pra deri në shkurt, dhe a mund të më listoni konkretisht veprat e ndërtuara nga viti 2017 deri më sot?

Ariola Kodra – Ju ishit edhe vetë në terren, para disa ditësh, dhe mendoj se u njohët me fazat e ndërtimit dhe të objekteve që kanë përfunduar pranë zonës së trajtimit.

Ina Zhupa – Një fushë pamë aty dhe një kapanon.

Ariola Kodra – Është bërë kapsulimi i vend-depozitimit ekzistues, është ndërtuar kapanoni i seleksionimit të mbetjeve, ku bëhet diferencimi i mbetjeve që kalojnë për riciklim, është ndërtuar landfilli i mbetjeve të ngurta urbane, landfilli i hireve dhe landfilli i inerteve, është ndërtuar impianti i përpunimit dhe i trajtimit të ujërave të ndotura dhe është në fazë ndërtimi impianti i përpunimit të mbetjeve me prodhim energjie.

Ina Zhupa – Do t'ju pyes edhe një herë në lidhje me pyetjen tjetër. Ju e keni marrë lejen e ndërtimit në vitin 2019, apo jo? Thatë se është zbardhur në nëntor të vitit 2020, jam e saktë?

Ariola Kodra – Vendimi për miratimin e dhënies së lejes së ndërtimit është nxjerrë në maj të vitit 2019 dhe zbardhja e saj është bërë në nëntor të vitit 2020.

Ina Zhupa – Ne, kur ishim në incenerator, në vendin ku duhej të ishte inceneratori i Tiranës, pamë një fushë, ku nuk kishin filluar ende punimet për ndërtimin e inceneratorit. Personi përgjegjës, zoti Bualli, në mos gabofsha për mbiemrin, na tha: “Kemi marrë lejen në nëntor të vitit 2020, por kemi afat 6 vjet (siç e thatë dhe ju) për ta ndërtuar dhe nuk kemi ndërtuar asgjë”. Jam korrekte deri tani, se kam një pyetje?

Ariola Kodra – Punimet për ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve me prodhim energjie kanë nisur. Janë në fazat e para të punimeve civile.

Ina Zhupa – Ku kanë nisur? Atje ishte një fushë me bar, pra nuk kishte as themele, si ka nisur? Po flas për procesin e inceneratorit, jo për...

Ariola Kodra – Për pjesën e inceneratorëve po flas edhe unë që kanë nisur themelet. Nëse e kujtoni, është direkt pas kapanonit të seleksionimit të mbetjeve. Vendndodhja e tyre është pas kapanonit që besoj e keni parë.

Ina Zhupa – Po kapanonin e kam parë, por pas kapanonit nuk ishte inceneratori, përballë kapanonit, që na e treguat ju, ishte një fushë, apo ka dy?

Ariola Kodra – Inceneratori nuk mund të ndërtohet brenda ditës, ka një periudhë...

Ina Zhupa – A ka nisur?

Ariola Kodra – Po, faza e punimeve ka nisur dhe ishte më se e dukshme.

Ina Zupa – Nuk ishte e dukshme.

Arben Pëllumbi – Të lutem, t'i lëmë komentet!

Ju e bëtë pyetjen tuaj, e morët përgjigjen. Mos e intimidoni dëshmitaren dhe mos e vini në pozita.

Ina Zhupa – Nuk po e intimidoj.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, ju lutem!

Unë nuk ia heq fjalën askujt, por mos u ndërhyjni deputetëve kur janë duke bërë pyetje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë të falënderoj se për 3 muaj fole për herë të parë. Ta jap unë fjalën. Lëreni të përfundojë!

Ina Zhupa – Ju lutem, që të përfundoj pyetjet!

Zonja Kodra, sa është volumi i situacionit të punimeve të kryera në vepra të certifikuar deri në shkurt të vitit 2022?

Ariola Kodra – Këto janë detaje teknike që nuk mund t’u përgjigjem tani në këto momente, por mund t’u përgjigjem në një moment të dytë.

Ina Zhupa – Mund t’i sillni pranë komisionit? Dakord.

Më vjen mirë që ju keni marrë me vete të gjitha ato foto dhe nuk keni marrë asnjë dokument.

Ariola Kodra – Sepse nuk e dija se për çfarë do të pyetesh konkrëtisht që ta merrja të gjithë dokumentacionin e mundshëm. Nuk mund të merrja të gjithë arkivin e shoqërisë me vete.

Ina Zhupa – Fotot i more. A kanë ekzistuar vonesa në afatet e marrjes së lejes së ndërtimit dhe, nëse po, cilat kanë qenë arsyt pse kanë qenë këto vonesa, ka qenë faji juaj, i bashkisë, çfarë ka ndodhur?

Ariola Kodra – Ka pasur disa vonesa në zbardhjen e lejes së ndërtimit. Një prej tyre ka qenë procedura e shpronësimeve që u bë me shumë vonesë, ka qenë periudha e pandemisë, ka pasur një sërë gjërash, të cilat janë deklaruar pranë autoritetit kontraktor nga ana jonë, nga ana e supervisorëve, e supervisorit të punimeve.

Ina Zhupa – Më vjen mirë që e listoni pandeminë si penguese të punimet, por jo të udhëtimet. Gjatë fazave të ndërtimit të veprës më listoni disa nga kompanitë, me të cilat keni kontrata bashkëpunimi që kanë ofruar shërbimin për ndërtimin infrastrukturor të veprave, të godinave, sipas objektit të kontratës që keni?

Ariola Kodra – Kësaj pyetje iu përgjigja njëherë, thashë se shoqëria ka 30-40 nënkontraktorë, numrin e saktë nuk e mbaj mend, dhe emrat e çdo shoqërie nuk i mbaj mend.

Ina Zhupa – A mund të na e vini në dispozicion listën e plotë?

Ariola Kodra – Po, patjetër.

Ina Zhupa – A ka blerë kompania, që ju drejtoni deri tani, në shkurt të vitit 2022, pajisje, dhoma djegie apo ndonjë pajisje tjetër që kryen procesin e incenerimit?

Ariola Kodra – Shoqëria ka kryer investime dhe ka paguar pajisjet, por këto nuk janë pasqyruar në situacione, pasi situacionohen në momentin që mbërrijnë në *site*.

Ina Zhupa – Pra, keni blerë pajisje për incenerimin dhe nuk i keni në situacion?

Ariola Kodra – Sepse situacionohen në momentin që pajisjet vijnë në vend?

Ina Zhupa – Keni blerë pajisje për riciklimim dhe për diferencim? Nëse po, a mund të na e thoni vlerën dhe llojin e pajisjeve?

Ariola Kodra – Vlerën nuk e mbaj mend, por është blerë pajisja që ju e patë në kapanonin e riciklimit. E gjithë pajisja, që gjendej brenda, bën seleksionimin gjysmë manual dhe gjysmë automatik të mbetjeve.

Ina Zhupa – Cilat nga proceset, që janë objekt i kontratës, kryen kompania juaj gjatë 1 dite të zakonshëm pune, po marrim tani në shkurt 2022, depozitimin e mbetjeve nga momenti i pranimit të tyre deri në momentin e final, qoftë nga Bashkia e Tiranës, qoftë nga subjekte të tjera.

Ariola Kodra – Ka një procedurë të përcaktuar nga ana e shoqërisë që nga momenti i hyrjes së kamionëve me mbetje pranë zonës së trajtimit të mbetjeve në Sharrë, peshimi i tyre, marrja e të dhënave, depozitimi në kapanonet e seleksionimit, ku bëhet selektimi i mbetjeve, pjesa që kalon për riciklim selektohet dhe pjesa që nuk është për riciklim, depozitohet në landfillin e mbetjeve të ngurta urbane.

Ina Zhupa – A keni ndonjë të dhënë se sa ton vijnë çdo ditë nga bashkitë Durrës, Tiranë dhe Kavajë?

Ariola Kodra – Përgjithësisht rreth 700-800 ton, të saktë nuk e kam si shifër.

Ina Zhupa – A e kryen kompania juaj në ditën e sotme procesin e riciklimit të mbetjeve?

Ariola Kodra – Po, për sa kohë mbetjen seleksionohen dhe dalin veçantë, qelqi, kartoni, letra, metali e të tjera.

Ina Zhupa – Jo diferencim, por riciklimin e tyre?

Ariola Kodra – Riciklimin nuk e kryen shoqëria, por e kryejnë shoqëritë ricikluese.

Ina Zhupa – Nuk e kryen shoqëria juaj dhe ju ia jepni një shoqërie tjetër, apo çfarë ndodh?

Ariola Kodra – Shoqëria bën vetëm seleksionimin e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Nuk është se nuk e di unë, por ta thotë ajo.

Ariola Kodra – Shoqëria kryen vetëm seleksionimin, që nxjerr materialet për riciklim. Riciklimi kryet nga ricikluesit.

Ina Zhupa – Ju i dërgoni ricikluesit? Ju i ndatë, çfarë ndodh që të ndodhë procesi i riciklimit?Jua dërgoni ju, vjen një kompani, cilat janë kompanitë?

Ariola Kodra – Lidhen marrëdhënie kontraktuale nëpërmjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Faleminderit, do të të marr edhe ty në pyetje më vonë, meqenëse je i informuar, por tani kam zonzjën Kodra.

Ariola Kodra – Lidhe marrëdhënie kontraktuale me shoqëritë e riciklimit.

Ina Zhupa – Me sa shoqëri riciklimi keni marrëdhënie kontraktuale?

Ariola Kodra – Nuk e mbaj mend.

Ina Zhupa – Me sa kompani riciklimi të tjera keni marrëdhënie kontraktuale?

Ariola Kodra – Sapo ju përgjigja, nuk e mbaj mend.

Ina Zhupa – Ju lutem!

Zonja Denaj, prodhohen para.

A mund të na e vini në dispozicion edhe dokumentin që keni marrëdhënie kontraktuale me kompanitë e riciklimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Të nderuar anëtarë të maxhorancës, se si i bëjmë pyetjet brenda objektit, është puna jonë.

Jorida Tabaku – Zonja Zhupa, përfundo pyetjet, sepse merrem unë me komisionin!

Etjen Xhafaj – Ky komision, e nderuar zonja Zhupa, i ka të përcaktuara. Mos u jep mendje anëtarëve të maxhorancës, kur nuk ke lexuar Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Se çfarë kam lexuar, e di unë.

Zonja Kodra, sa është numri i personelit aktiv tani, në shkurt 2022? A i keni të ndarë sipas kompetencave? Sa kryejnë diferencim, sa janë për riciklimim dhe sa janë për incenerimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E di unë lidhjen, zotëri, sepse janë fonde publike.

Ariola Kodra – E përmenda numrin e punonjësve pak më parë, janë diku rreth 140- 145, të saktë nuk e mbaj mend, por mund t’jua vendos në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E fundit, sipas regjistrave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! E di që doni të bëni gjithçka që mos të dalë në pah e vërteta, por unë do të vazhdoj me pyetjet që zbardhin të vërtetën në qoftë se ju bëni zhurmuesin.

Jorida Tabaku – Ju lutem!

U tërheq vëmendjen anëtarëve të komisionit hetimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Zhupa, të lutem, mund të konkludoni?

Ina Zhupa – Po bëjnë zhurmuesin.

Jorida Tabaku – Mos u ktheni përgjigje.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Jorida Tabaku – Interesi i tyre është të mos pyesim ne.

Drejtojuni dëshmitares, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Sipas regjistrave preventivë që kompania juaj disponon, sa është sasia e mbetjeve që janë groposur në këtë kohë?

Ariola Kodra – Këto janë detaje teknike që nuk i mbaj mend. Mund t’jua vendosim në dispozicion më tutje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Ju lutem, na vini në dispozicion sasinë e mbetjeve të groposura gjatë kohës që ju keni këtë kontratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa është vlera e pagesave të marra...

Edhe dy pyetje.

Jorida Tabaku – Të konkludojmë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Sa është vlera e pagesave të marra nga ana e kompanisë suaj në monedhë, lek apo euro, gjatë periudhës shtator 2017-shkurt 2022 në shërbimin që ofron? Pra, jo vetëm nga shteti, sepse ju merrni edhe nga kompanitë private, se sjellin dherat atje.

Ariola Kodra – Shoqëria merr një tarifë depozitimi prej 29 euro për shërbimin që ofron.

Ina Zhupa – Nuk ishte kjo pyetja, por sa është vlera e pagesave të marra nga kompania juaj nga publiku dhe privati në periudhën shtator 2017-shkurt 2022?

Ariola Kodra – Vlerën totale nuk e mbaj mend.

Ina Zhupa – Mund të na e vini në dispozicion edhe këtë?

Ariola Kodra – Patjetër.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Në çfarë vlere, në qoftë se e dini, lek apo euro, nuk ka rëndësi, janë fitimet bruto apo neto të kompanisë suaj në një vit, për shembull, në vitin 2021?

Ariola Kodra – Për sa u përket vlerave, nuk i kujtoj tani, por mund t'ju vendosim në dispozicion më tej. Kështu që për çfarëdolloj vlere që mund t'i referoheni dhe mund të pyesni...

Ina Zhupa – Dhe pyetja e fundit, kur mendoni ju se do të ndodhë, muaji apo viti, afati i përfundimit të inceneratorit, atë që kanë paguar qytetarët shqiptarë?

Ariola Kodra – Sipas grafikut të punimeve, ka një afat të përcaktuar.

Faza e parë e lejes përfundon në vitin 2025, diku nga nëntori, kurse faza e dytë në vitin 2026.

Ina Zhupa – Shumë faleminderit!

Jorida Tabaku – Atëherë, unë kam nevojë për një specifikim nga pyetja e zonjës Zhupa. Ju thatë që shpronësimet i keni dërguar, në mos gaboj, në maj të vitit 2019...

Ariola Kodra – Ndoshta. Nuk e kujtoj datën e saktë.

Jorida Tabaku – Unë kam shkresat tuaja këtu, ku thuhet se leja për shpronësimin është marrë në datën 17 maj të vitit 2019, ndërkohë që është dorëzuar më 30 dhjetor të vitit 2019. Pse kaq vonë? Pse 7 muaj me vonesë? Sepse ju sapo na thatë që shpronësimet kanë qenë arsyeja kryesore pse nuk e keni zbatuar kontratën. Pra, paska qenë në dorën tuaj që ta mbani 7 muaj lejen e shpronësimit për ta dorëzuar nga maji në dhjetor. Kjo është edhe një nga shkeljet, në fakt, që ka konstatuar Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatimin e kontratës suaj.

Ariola Kodra – Ne nuk e kemi vonuar procedurën e shpronësimeve. Ne u jemi përmbajtur të gjitha kërkesave që ka pasur autoriteti kontraktor, i cili është marrë me procedurën e shpronësimeve. Kemi vendosur në dispozicion të gjithë dokumentacionin që ata kanë kërkuar.

Shpronësimet janë kryer në dy faza, pasi ka pasur edhe një rishikim VKM-je për disa prona, të cilat nuk ishin përfshirë në procedurën e shpronësimeve.

Për këtë arsye është zgjatur edhe procedura e shpronësimit.

(Deputeti Bushati ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Unë kam këtu raportin e KLSH-së që e keni marrë në maj dhe e keni dorëzuar në dhjetor. Domethënë, është edhe shkresa juaj.

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Bushati, kam dy pyetje në lidhje me qëndrueshmërinë financiare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni me zonzjën Zhupa? T'i lëmë në fund replikat, edhe sepse tani e ka kërkuar fjalën zoti Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë mund t'jua jap fjalën tani, por për replikë jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka kërkuar zoti Nasufi për procedurë, por sa të përfundoj unë, se isha duke folur, apo jo?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe zoti Ajazi do ta marrë fjalën pastaj për procedurë.

Fjalën e ka zoti Bushati për pyetje, por unë...

Helidon Bushati – Zonja kryetare, mos jepni shkas për ta kërkuar fjalën për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Bushati, por të përfundoj unë.

Ju lutem, më lini të përfundoj, sepse kam një gjë shumë të rëndësishme për interesin publik!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kam kryqëzuar raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, raportin e zbatimit të Ministrisë së Financave për vitet 2019-2020, njëkohësisht edhe pasqyrat financiare që ju keni dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga të cilat kam marrë ato të viteve 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa ajo e vitit 2021 nuk ka dalë ende.

Subjekti koncesionar ka dorëzuar shkresën nr. 480, në datën 19.12.2019 pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe është marrë nga ky i fundit në datën 23.12.2019, ku tregohet se “Vlera totale progresive e investimeve të kompania “Integrated Energy” për periudhën janar 2018-shtator 2019 është 29 milionë euro”. Është e saktë kjo, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një shkresë juaja.

Ariola Kodra – Nuk e mbaj mend këtë pjesë. Nuk më kujtohet.

Arben Pëllumbi – Për procedurë.

Jorida Tabaku – Ta përfundoj, sepse kam një logjikë...

Arben Pëllumbi – Besoj që procedura ka të bëjë me këtë pyetjen që bëtë ju, prandaj kërkoj ta marr fjalën.

Jorida Tabaku – Patjetër, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Këto dokumente që kërkoi kryetarja apo ju pyeti, a janë pjesë e materialeve që ju i keni dorëzuar institucionit të hetimit të posaçëm?

Ariola Kodra – Siç e përmenda edhe më herët, të gjithë dokumentacionin teknik, ligjor dhe financiar e disponon SPAK-u.

Arben Pëllumbi – Atëherë, nuk keni asnjë detyrë t’u përgjigjeni edhe pyetjeve që mund t’ju drejtojnë. Deputetët janë të lirë t’i bëjnë pyetjet e tyre, por ne nuk mbivendosim hetimin tonë me atë të organit të prokurorisë.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, mos u bëni avokat i kompanisë së inceneratorëve!

E ruajta veten ta them deri tani. Nuk është normale. Më lini të përfundoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Isha duke folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për procedurë jo! Do ta marrësh fjalën, sapo të përfundoj timen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I gjithë dokumentacioni, të cilit i referohem, ka ardhur në komisionin hetimor parlamentar.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është i gjithi dokumentacion zyrtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të përfundoj unë dhe do ta merrni fjalën për procedurë të gjithë!

Edmond Spaho – Për procedurë, në lidhje me çfarë tha zoti Pëllumbi, e keni gabim që flisni me këtë gjuhë.

SPAK-u mund të ketë mbledhur të gjithë dokumentacionin ekonomik, financiar, teknik e të tjera. Ndërkohë, këndvështrimi ynë, si komision hetimor, është i ndryshëm nga ai i SPAK-ut. Ne shikojmë të identifikojmë parregullsitë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem tani!

Edmond Spaho – ...në aspektin procedural dhe financiar, si dhe të bëjmë korrigjime në legjislacionin aktual, të japim rekomandime.

Ne nuk jemi të penguar...

Arben Pëllumbi – Ne nuk jemi këtu për të hetuar financat...

Edmond Spaho – Atëherë, ju nuk mund të thoni që sa kohë dokumentacioni është dorëzuar në SPAK, ne nuk mund të pyesim për këto dokumente dhe nuk mund t'i kërkojmë. Ne mund ta bëjmë këtë.

Jorida Tabaku – Ne po flasim për dokumente publike.

Edmond Spaho – Madje, po t'i referohesh praktikës së komisioneve hetimore, raportet midis kompanive private kanë qenë objekt pune i komisioneve hetimore. Shiko të dy komisionet për CEZ-in. Ky nuk është dokument që nuk duhet të...

Jorida Tabaku – Kemi rastin e zotit Balla, i cili e ka zbatuar në detaje këtë klauzolë të autoritetit që i ka dhënë ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, më lini të mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do të përfundoj unë, zonja Dhima!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, asnjë sekondë!

Do të përfundoj unë dhe pastaj do ta merrni fjalën.

Në pasqyrat që kompania ka dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dokument ky publik e zyrtar, i dorëzuar nga ju si administratore në vitin 2019, thuhet që investimi është 5 milionë euro, ndërkohë që Kontrollit të Lartë të Shtetit i thoni që keni investuar 29 milionë euro.

Kam këtu edhe raportin e përmbledhur të Ministrisë së Financave të monitorimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Në tabelën nr.8 të këtij raporti thuhet: “Investimi kapital deri tani është 2,9 miliardë euro, më pak se 26 milionë euro.”

Atëherë, unë dua të di se në cilin rast subjekti ka deklaruar të vërtetën, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ku keni thënë se investimin e keni në vlerën 5 milionë euro, ka gënjyer Ministria e Financave, kur thuhet se keni investuar 29 milionë euro, apo keni gënjyer ju Kontrollin e Lartë të Shtetit, kur thuhet se keni bërë po të njëjtën vlerë investimi? Janë tri shifra të ndryshme, për të cilat ne po flasim.

Këtu bëhet fjalë për një gënjeshtër në deklaram, një të pavërtetë në deklaram.

Ju dëgjova pak më parë të thoshit që nuk ka pagesa nga buxheti i shtetit dhe nuk keni bërë investime, ndërkohë që në tre dokumente të ndryshme këtu del se kanë ndodhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Kodra.

Ariola Kodra – Unë thashë që “shoqëria” nuk merr para nga buxheti i shtetit për investimin, por e kryen me fondet e veta, dhe se merr një tarifë depozitimi për shërbimin që ofron.

Jorida Tabaku – “Vlera e investimit për projektin e inceneratorit të Tiranës”, thuhet në tabelën e Ministrisë së Financave.

Ariola Kodra – Nuk i disponoj këto të dhëna, ndaj nuk mund t’ju përgjigjem tani.

Jorida Tabaku – Atëherë, Ministria e Financave, po në të njëjtin raport monitorimi, thotë se kompania koncesionare nuk e ka zbatuar kontratën e saj për sa i përket vlerës së investimit, e cila në vitin 2018 duhej të ishte 5,6 miliardë lekë, ndërkohë keni investuar 1,1, që është pothuajse 20% e vlerës; në vitin 2019, nga 5,9 miliardë keni investuar 560 milionë, që është 8% e vlerës, dhe në vitin 2020 po njësoj. Sakaq, pyetja ime është: cilat kanë qenë arsyet që kompania nuk e ka zbatuar dhe respektuar kontratën për sa i përket vlerës së investimit të saj, jo të buxhetit të shtetit?

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Për procedurë.

Jorida Tabaku – Jo, do të përfundojë përgjigjen zonja dhe pastaj do t’jua jap fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka kërkuar fjalën zoti Nasufi.

Jorida Tabaku – Po, zonja Kodra.

Ariola Kodra – Unë u përgjigja pak më herët, referuar vlerës së investimit të shoqërisë, që deri në këto momente që flasim, ka investuar diku te rreth 30 milionë euro, me përafërsi,

Jorida Tabaku – Pse nuk është respektuar pagesa sipas viteve përkatëse? Kjo është e dhënë nga Ministria e Financave. Ky nuk është dokument i opozitës, është dokument zyrtar i shtetit shqiptar.

Ariola Kodra – Atë pjesë më duhet ta konsultoj me sektorin e financës dhe t'ju kthej një përgjigje.

Jorida Tabaku – Sipas kontratës, kompania juaj duhet të paguajë penalitete në qoftë se nuk kryen pagesat dhe investimet në kohë. Unë ju përmenda që kompania juaj nuk i ka kryer këto shërbime në kohë në masën 20% vitin e parë, 8% vitin e dytë dhe me radhë. Në dijeninë tuaj, a ka pasur ndonjëherë gjoba dhe penalitete për kompaninë tuaj, për koncesionarin nga autoriteti kontraktues?

Ariola Kodra - Në dijeninë time nuk ka pasur, por në dijeninë time, di t'ju them se ne kemi realizuar hap pas hapi dhe në përputhje me kontratën e koncesionit të gjitha ndërtimet që janë kryer deri më sot, pranë zonës së trajtimit të mbetjeve në Tiranë.

Jorida Tabaku – Ne sapo konstatuam këtu në komision që në fakt nuk janë realizuar detyrimet dhe unë po ju them edhe raste të tjera kur nuk është zbatuar kontrata. Kam një dokument shteti, ku thuhet: Ministria e Financave me Arben Ahmetaj (nuk po e përmend zonjën Denaj, se është këtu në komision), thuhet Kontrolli i Lartë i Shtetit me përfaqësuesin, zotin Arben Shehu, ku nuk është zbatuar çështja e penaliteve. Për këtë rast ishte pyetja ime, por në dijeninë tuaj nuk ka pasur asnjë penalitet.

E ka fjalën zoti Pëllumbi, për procedurë.

E ka zoti Nasufi për procedurë, ju kërkoi ndjesë.

Zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – E para, zonja është për herë të parë në komision, dëshmitarja e parë që vjen dhe ne po e bombardojmë për gjithçka, po artikulojmë 3 muaj që ka komisioni. Ajo ka një funksion të përcaktuar, administratore dhe duhet të përgjigjet për aq sa kryen funksioni i saj në atë kompani.

E dyta, ju duhet të mbani drejtimin e mbledhjes, që të jepni fjalën për pyetje edhe nga ana e opozitës, edhe nga ana e mazhorancës.

E treta, ju nuk duhet të impononi përgjigjen e pyetjeve, aq më tepër të ricikloni pyetjet, se me riciklimin e mbetjeve po merreni, por jo me riciklimin e të njëjtave akuza, e të njëjtave pyetje dhe e të njëjtit refren.

E katërta, nuk duhet të komentoj. Merrni përgjigjet, po ose jo, dhe s'keni të drejtë të ktheni nga 10 herë tek e njëjta çështje.

Ta fillojmë mbarë, se do të kemi 41 dëshmitarë të tjerë në këtë proces.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Nasufi!

Unë e pyeta zotin Pëllumbi, nëse kishte pyetje të tjera, por nga të gjithë kolegët socialistë nuk ka asnjë pyetje, ka vetëm komente. Unë do të përfundoj me pyetjet, pastaj do të vazhdojmë me komentet.

Etjen Xhafaj – Mos paragjykoj atë që do të thonë, por kur ngremë dorën na jepni fjalën. Dhe lëre këtë muhabet.

Jorida Tabaku – Zoti Xhafaj, do të marr masa për shkelje të kodit të etikës. E merr mikrofonin dhe flet sa herë ke qejf.

Etjen Xhafaj – Po merre etikën, mbaje etikën.

Jorida Tabaku – Sa herë ke qejf të flasësh merr mikrofonin.

Etjen Xhafaj – I komenton të gjithë, se ke ardhur këtu do të flasësh vetëm. Nëse dikush ka ngritur dorën jepi fjalën.

Jorida Tabaku – Mjaft pra tani.

Etjen Xhafaj – Ka ngritur dorën, jepi fjalën.

Jorida Tabaku – Mos e merr mikrofonin sa herë ke dëshirë ti.

E ka fjalën për procedurë zoti Ajazi dhe zoti Helidon Bushati.

Etjen Xhafaj – Mbaje atë etikë për të cilën flet, se po bën pyetje qesharake.

(Debat pa mikrofon në sallë.)

Besion Ajazi – Zonja kryetare,

Unë do të nis pikërisht me këtë të fundit, nuk është etike të thoni për mua, që ka 3 muaj, ka 2 muaj në komision dhe ka folur 1 herë apo 10 herë. Kjo nuk është etike, sepse nuk të shkon edhe si zonjë që je, edhe si nënë që je, të bësh këto ironi. Unë e marr fjalën sa herë mendoj se duhet ta marr fjalën dhe për këtë nuk të jap llogari ty, fare.

Jorida Tabaku – Duhet të më drejtoheni siç ju drejtova, zoti Ajazi edhe ju, zonja Tabakau.

Besion Ajazi – E dyta...

Jorida Tabaku – “Ty”, thuaju atyre që ke në krahë

Besion Ajazi – Jo, nuk të flas me etikë dhe me kulturë, deri në momentin kur do më drejtoheni në këtë mënyrë.

E dyta, më thoni një pikë të Rregullores, një nen, i cili ju jep juve të drejtën të bëni Gestapon këtu,. Një pikë të Rregullores që merrni fjalën pas çdo diskutimi dhe bëni ose komente, ose ironi, ose pyetje që nuk ju takojnë. Merrni fjalën për pyetje bëni pyetjet tuaja dhe vazhdoni drejtoni mbledhjen. Ju si drejtuese e komisionit, nuk mund ta merrni fjalën për pyetje mbas çdo diskutimi, se nuk e parashikon Rregullorja. Në qoftë se e parashikon Rregullorja, unë tërhiqem dhe kërkoj ndjesë.

Më thoni, e parashikon Rregullorja që ju si drejtuese e komisionit të merrni fjalën për të bërë pyetje mbas çdo diskutimi, të bëni komente mbas çdo diskutimi madje edhe kur dëshmitarja apo dëshmitarët që do të vijnë janë duke u përgjigjur?

Jo, nuk e parashikon. Rregullorja parashikon që në seancën e dëshmimeve, kur dëgjohen dëshmitarët, deputeti bën pyetjen, dëshmitari përgjigjet, nuk ka as komente as ironi, as sarkazëm, as gallatë.

Nëse do të jemi seriozë, të zbatojmë Rregulloren e Kuvendit dhe të komisionit, në qoftë se nuk doni të jeni, pjesë e kësaj palaçoje këtu, ne nuk bëhemi.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Atëherë të nderuar, i kërkoj së pari teknikës, të mos i japë të drejtën të hapë mikrofonin kujtdo, ju lutem.

Etjen Xhafaj – Jo, do të flasësh vetëm ti! Ke të drejtë.

Jorida Tabaku – Do të flasë kushdo që kërkon fjalën me radhë.

Së dyti, u kërkoj deputetëve dhe kolegëve socialistë, ju lutem, dakord avokatinë e ministrave dhe të deputetëve socialistë e bëni, por mos bëni edhe të kompanisë.

Të flasë zoti Bushati dhe më pas zonja Dhima.

(Debate pa mikrofon në sallë)

Helidon Bushati – Të nderuar kolegë dhe kolege.

Kam disa pyetje dhe të gjitha lidhen me funksionin e zonjës apo zonjushës administratore. Te kreu 2 i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i referohem njëres prej pikave që janë detyrat

e administratorit, ku thuhet: “...të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë”, besoj se ju keni familjaritet me këtë pikë.

Gjithashtu, te neni 63, gjithmonë te kontrata e inceneratorit të Tiranës monitorimi dhe inspektimi i impianteve, pika “a” thotë: “Autoriteti kontraktor, (koncesionari, ju) çdo 3 muaj raporton tek autoriteti kontraktor”, një ndër pikat është për përparimin e punimeve dhe masat e marra për eliminimin e vonesave dhe unë besoj se keni qenë të saktë në këto gjëra. A mund të sillni ju pranë këtij komisioni këto raporte 3- mujore, që keni bërë pranë autoritetit kontraktor, që prej fillimit në vitin 2017?

Ariola Kodra – Të gjitha këto raporte ndodhen pranë autoritetit kontraktor, se ne i bëjmë rregullisht dhe ju mund t’i aksesoni lehtësisht aty.

Helidon Bushati – Gjithashtu, referuar nenit 62, ku supervizori, që është pala juaj, çdo 3 muaj sjell këto raporte, edhe te ju, edhe autoritetit kontraktor, a mund t’i kemi këto raporte të supervizorit?

Ariola Kodra – E njëjta përgjigje vlen edhe për pjesën e supervizorit.

Helidon Bushati – Zonja kryetare, të mbahet shënim, që të merren raportet e supervizorit dhe të koncesionarit, pasi tregojnë sa janë kërkuar pranë autoriteteve kontraktore, çfarë është kërkuar, pse ka qenë vonesa e të tjera si këto.

Tani, i referohem një pike tjetër, e cila flet po për kompetencat e administratorit e cila është: “...të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë”. Jam i saktë?

Mund ta dimë rezultatin financiar të kompanisë për vitet 2018, 2019, 2020? Për viti 2021 s’ka dalë ende.

Ariola Kodra – Mund ta konsultoj me sektorin e financës edhe t’jua vëmë në dispozicion këtë informacion.

Helidon Bushati – Po jua them unë, që t’ju lehtësoj pak punën. Në vitin 2018 ka qenë 35 milionë lekë, në vitin 2019 ka qenë 226 milionë lekë dhe në vitin 2020 ka qenë 746 milionë lekë. Ju rezultojnë familjare këto shifra apo jo, të përafërta së paku?

Ariola Kodra – Nuk më kujtohen. Nuk i mbaj mend.

Helidon Bushati – Një pyetje tjetër: nga se vjen fitimi neto i kompanisë tuaj, i objektit të koncesionit?

Ariola Kodra – Nga shërbimi që ofrohet, nga tarifa e depozitimit që merret për shërbimin e ofruar.

Helidon Bushati – Domethënë, edhe kur të vendoset inceneratori, djegësi në funksion, edhe kur të bëni selektimin për shitjen e materialeve, siç mund ta bëni tani, ju, fitimin e keni dhe do ta keni vetëm nga tarifa?

Jorida Tabaku – Pra, vetëm nga pagesat, thotë zoti Bushati.

Ariola Kodra – Të ardhurat e vetme janë ato nga tarifa e depozitimi, e cilat merret për shërbimin që ofrohet.

Helidon Bushati – Ju lutem, jam shumë i saktë kur pyes. Pyetja ime është: ju krijoni fitim neto vetëm nga tarifa e depozitimit apo do të krijoni fitime nga incenerimi dhe shitja e materialeve të selektuara?

Ariola Kodra – Tarifa prej 29 eurosh nuk do të ndryshojë përgjatë 30 vjetëve të periudhës së koncesionit.

Helidon Bushati – Unë kam pak pyetje, që janë të sakta, dhe do të doja që përgjigjet të ishin të sakta. Unë e kuptoj që te 29 eurot janë të përfshira të gjitha kostot që mbulon kompania. Apo jo? Domethënë, në të gjithë tridhjetëvjeçarin do të jetë 29 euro plus TVSH. E kuptoj dhe e pranoj këtë, por unë po bëj një tjetër pyetje. Fitimi do të jetë vetëm nga tarifën apo do të fitohet edhe nga shitja e energjisë dhe shitja e materialeve të riciklueshme? Është shumë e thjeshtë.

Ariola Kodra – Për momentin sigurohet vetëm nga tarifa e depozitimit.

Helidon Bushati – Dakord, shumë e saktë. Domethënë, sot bëhet vetëm depozitim, nuk shitet material i selektuar dhe energji elektrike dhe kompania, siç jua thashë më përpara, sot del me fitim dhe fitimi është në rritje; në vitin 2018 35 milionë, në vitin 2019 226 milionë, në vitin 2020 746 milionë. Edhe sot vetëm me anë të depozitimit del me fitim, merre me mend se me sa fitim do të dalë kur të vendoset edhe inseneratori dhe kur të filloj të shiten materialet e selektuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem! Iu referova vetëm kontratës dhe detyrave që ka administratori. Kjo është shumë e thjeshtë.

Vetëm me tarifën e depozitimit ju dilni me fitim. Domethënë, janë fryrë kostot kur është parashikuar tarifa prej 29 eurosh. Apo jo?

Ariola Kodra – Nuk jam eksperte e fushës financiare, kështu që, më lejoni ta konsultoj dhe do ju kthej përgjigje për pyetjet tuaja.

Helidon Bushati – Unë ju falenderoj për përgjigjet!

Jorida Tabaku – Fjala për zotin Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Shkurtimisht, në vazhdim të asaj që tha kolegu. E kuptoj që ju nuk jeni financiare, por, nëse e dini, a e dini që ka një normë amortizimi mbi investimin që bëhet? Pra, investimi që ju do të bëni, do të ketë normë amortizimi? Ju e llogarisni këtë?

E dyta, a do të punësoni njerëz të tjerë pasi të ndërtoni insineratorin apo do ta bëni me ata punëtorë që keni edhe sot?

Ariola Kodra – Patjetër që do të punësohen edhe njerëz të tjerë në varësi të nevojave që do të ketë shoqëria përgjatë gjithë procedurave të punës së saj.

(Diskutime pa mikrofon)

Jorida Tabaku – E ka kërkuar fjalën zoti Luçiano Boçi për pyetje.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Zonja Kodra, ju dëgjova me vëmendje në përgjigjet tuaja. Në fakt, këtu në komision jeni paraqitur si administratore e koncesionarit dhe jo zi zonja Kodra. Ta bëjmë të qartë këtë.

Përgjigjet tuaja, në shumë raste, si në rastin e pyetjeve të zotit Bushati, të zonjës Zhupa, por edhe të tjera, kanë qenë “nuk e di” ose “do të marr stafin ndërkohë”. Thirrja juaj këtu ka të bëjë pikërisht edhe me këtë që ti nuk e di, sepse nëse përgjigjesh “nuk e di”, atëherë akuzohesh për pengim të hetimit. Këtu duhet të kishe ardhur e përgatitur totalisht, mund të kishe marrë stafin juridik dhe atë financiar me vete, për të dhënë përgjigjet që ju kërkoi zoti Pëllumbi (nuk po them zoti Bushati se i kishte vetë përgjigjet e shifrave) apo përgjigje të tjera për të ardhurat neto.

Ne nuk pyesim për biografinë, që ti e di shumë mirë, por pyesim për ato gjëra për të cilat duhet të jesh e përgatitur si administratore, sepse ju administroni të ardhurat, shpenzimet dhe përgjigja “nuk e di” për mua është pengim i hetimeve të komisionit hetimor. Këtu e mbyllim, nuk do të presim, nuk marrim shkresa të tjera. Kjo ishte pjesë e hyrjes, si një këshillë që në të gjitha rastet që do të marrësh pyetje të mos përgjigjesh “nuk e di”. Siç ishte përgatitur me foto, kishe ardhur me staf origjinal këtu dhe secili...

Financieri jepte procedurën financiare të kryer, fitimin, të ardhurat neto, të gjitha këto gjëra.

Kjo nuk ishte pyetje, por parashtim.

Ju keni filluar punë në koncesionar si administratore në vitin 2019. Pyetja ime e parë ka të bëjë me aktivizimin tuaj në raport me pronarët, aksionerët. Ju si individ a keni pasur marrëdhënie biznesi, pjesë të aksioneve, në biznese të mëparshme të aksionerëve?

Ariola Kodra – Referuar asaj që ju thatë më parë, nëse do ta dija për çfarë isha thirrur konkretisht këtu, do të kisha përgatitur të gjithë listën e përgjigjeve të pyetjeve që ju do të më drejtonit dhe mund të kisha marrë edhe stafin me vete.

Për sa i përket pyetjes suaj, jo nuk kam pasur marrëdhënie më parë.

Luçiano Boçi – Në kontratë flitet për datën e fillimit të punimeve, e cila më pas duhet të ketë një afat 6-vjeçar. A ka një datë aktuale të fillimit të punimeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në kontratë flitet për datën e fillimit të punimeve. Data e fillimit nga data e përfundimit është ...

A është e përcaktuar data e fillimit të punimeve, sepse në kontratë përcaktohet fillimi i punimeve me datë dhe pas kësaj date afati 6-vjeçar, që është data e përfundimit të punimeve? A ka aktualisht një datë të fillimit të punimeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cila është data?

Ariola Kodra – Data e fillimit të punimeve, sikurse e përmenda edhe më herët, është menjëherë pas momentit të zbardhjes së lejes së ndërtimit në nëntor të vitit 2020. Kjo është paraqitur edhe në grafikun e rishikuar të punimeve që ne kemi paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Luçiano Boçi - Në kontratën tuaj përcaktohet qartë që data e fillimit të punimeve do të jetë dita kur koncesionari do të jetë pajisur me lejen zhvillimore (kjo është njëshi, sepse përcaktohet) dhe me të gjitha autorizimet, lejet, licencat, në vazhdimësi. Pse ju e lidhët me lejen e ndërtimit fillimin e punimeve kur mund ta kishit lidhur me lejen zhvillimore?

Ariola Kodra – Sepse ne jemi pajisur me leje ndërtimi. Koncesionari është pajisur me leje ndërtimi në nëntor të vitit 2020, të lëshuar nga autoriteti kompetent Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe miratuar nga KKT-ja.

Luçiano Boçi - Aplikimi për lejen e ndërtimit në kontratat tip bëhet në afate të përcaktuara 10 ditë pasi është miratuar projekt-zbatimi dhe brenda 10 ditëve ju duhet të kishit

bërë aplikimin për leje ndërtimi, që i bie nga viti 2017 deri në momentin që e keni marrë. Pra, në momentin që është miratuar projekt-zbatimi keni aplikuar për leje ndërtimi, para 3 vjetësh, para se ta merrnit.

Ariola Kodra – Po, në dijeninë time janë bërë procedura dhe aplikime nga pjesa e stafit teknik.

Luçiano Boçi – Në detyrimet kontraktore angazhohet autoriteti kontraktues që të krijojë të gjitha fasilitetet për pajisjen me leje, përfshirë lejen e ndërtimit, lejet e tjera, sheshet, territoret, licencat e të tjera. Duke qenë se ju u vonuat 3 vjet, a keni bërë kërkesa që autoriteti kontraktues t’ju ndihmojë në të gjitha këto procedura?

Ariola Kodra - Po, kemi dërguar shkresa të njëpasnjëshme drejtuar autoritetit dhe institucioneve kompetente në lidhje me zbardhjen e lejes së ndërtimit.

Luçiano Boçi – Në kontratë, për arsye të shkeljes së afateve, parashikohen penalitete dhe gjoba. A keni marrë ju gjoba nga autoriteti kontraktues për vonesat në fillimin e punimeve?

Ariola Gjoni – Shoqëria nuk ka qenë shkaktare për vonesat në fillimin e punimeve dhe për rrjedhojë nuk ka marrë as penalitete.

Luçiano Boçi – Në qoftë se nuk ka marrë penalitete, a ka kërkuar kompensim, sepse parashikohet në kontratë që, në rastet kur faji u takon autoriteteve duhet të ketë edhe penalitete të kundërthëna në raport me atë që e ka pasur detyrim? Sepse i bie që autoriteti kontraktues, se do të vij të përgjigjet ministri përkatës, paska thyer të gjitha rregullat e zbatimit të kontratës. Pra, kjo duhet shënuar, sepse automatikisht administratorja deklaron që është autoriteti kontraktues ai që ka penguar fillimin e punimeve në insineratorin e Tiranës. Është shumë e rëndësishme kjo dëshmi dhe duhet shënuar.

Këto ishin pyetjet e mia.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja kryetare, për procedurë, të lutem!

Kolegët e nderuar të opozitës, si parafolësi, kanë bërë pyetje më se normale, por është e panevojshme, e tepërt, joetike dhe aspak ligjore t’i komentosh përgjigjet e pyetjeve, dhe, mbi të gjitha, të tregosh vend e pa vend pasojat e përgjigjeve të pyetjeve apo të deklaratave të bëra. E bëtë ju në krye të herës dhe do t’u lutesha kolegëve të jemi shumë të kujdesshëm të paktën me gjuhën, duke respektuar dhe duke mos “shantazhuar”. Nuk e kam për të gjithë kolegët e opozitës, por vetëm për një pjesë të tyre. Është shumë normale të drejtohen pyetje, por duke mos harruar që

nuk jemi në hetim penal, duke mos harruar që nuk na lejohen komentet mbi përgjigjet e pyetjeve. Besoj se secili prej nesh është mjaftueshmërisht i zgjuar për të nxjerrë konkluzione për përgjigjet e pyetjeve që bëjnë kolegët, por askush prej nesh nuk ka të drejtë të dalë mbi planin e hetimit dhe mbi procedurat parlamentare në rastin konkret.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Po, zoti Shalsi.

Nëse kolegët nuk kanë pyetje, unë kam.

Zonja sapo na tha që i ka dorëzuar të gjitha materialet në SPAK.

A jeni thirrur ju në SPAK si dëshmitare?

Ariola Kodra – Jo, nuk jam thirrur.

Jorida Tabaku – Në dijeninë tuaj, a janë thirrur punonjësit e tjerë të kompanisë?

Ariola Kodra – Jo.

Jorida Tabaku – Asnjë punonjës tjetër nuk është thirrur deri në këto momente.

Ariola Kodra – Jo.

Jorida Tabaku – Atëherë, kam këtu një informacion të drejtorisë së tatimeve për skemën e mashtrimit me TVSH-në, të zbuluar në Republikën e Shqipërisë, ku disa kompani kanë xhiruar fatura fiktive, joreale, bosh, për të justifikuar shpenzimet, të cilat, në fakt, nuk i kishin kryer. Njëra nga këto kompani është kompania e inceneratorit të Tiranës. Kompania e inceneratorit të Fierit ka bërë pagesa dhe ka shitur shërbime, ku blerëse është kompania e inceneratorit të Tiranës.

Si qëndron situata me këtë hetim?

Cila është arsyeja që inceneratori i Tiranës ka marrë pagesa për shërbime të pakryera? Kështu thotë drejtorja e hetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ariola Kodra – Nuk kam informacion për këtë që po thoni.

Jorida Tabaku – Kjo ka ndodhur në fund të vitit 2018 dhe është një njoftim publik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kompania “*Integrated Technology BV*” është një nga blerëset me fatura fiktive të inceneratorit të Fierit, që ka bërë po shitje fiktive.

Ariola Kodra – Në vitin 2018 nuk kam qenë pjesë e kësaj kompanie. Nuk e di.

Jorida Tabaku – Zonja administratore, e mora vesh që ju keni filluar punë në mars të vitit 2019, por një administratore, e cila nuk njih studimin e fizibilitetit, që nuk e di rezultatin financiar të kompanisë, që nuk di një sërë gjërash, nuk e di se çfarë bëni ju atje, se kush e administron punën...

Në vijim të pyetjes së zotit Bushati, ju deklaruat se merrni tarifën 29 euro për ton mbetje, që është e vetmja pagesë që merr inceneratori juaj.

A keni një kontratë prej 10 milionë eurosh me Bashkinë e Durrësit për depozitimin e mbetjeve të qytetit të Durrësit?

Ariola Kodra – Ka një kontratë me Bashkinë e Durrësit për depozitimin e mbetjeve të qytetit të Durrësit pranë ZTMT-ës.

Jorida Tabaku – A e zbaton kompania juaj vendimin e këshillit bashkiak të Tiranës për depozitimin e dherave në inceneratorin e Tiranës?

A i depozitojnë të gjitha kompanitë e ndërtimit dherat me një tarifë të veçantë në inceneratorin e Tiranës dhe më pas, po me një tarifë të veçantë, bëjnë tërheqjen e tyre në momentin kur i marrin dhe u duhen proceseve të tjera të ndërtimit?

Ariola Kodra – Kompani të ndryshme bëjnë depozitimin e dherave pranë zonës së trajtimit të mbetjeve të Tiranës kundrejt një tarife të përcaktuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rreth 300 lekë, por nuk e kujtoj saktë.

Jorida Tabaku – Atëherë, përveç depozitimit të mbetjeve, për të cilat zoti Bushati ju pyeti disa herë, ndodh edhe depozitimi i dherave, që nuk është pjesë fillestare e kontratës koncensionare, por është shtuar më vonë, me një vendim të këshillit bashkiak, për të cilin ne, sigurisht, do të pyesim kryetarin e bashkisë. Janë këto dy procese ku ju merrni të ardhura. Nuk merrni të ardhura vetëm në një proces, apo jo?

Ariola Kodra – Ne ofrojmë një shërbim të caktuar pranë zonës së depozitimit të mbetjeve, depozitim mbetjesh, për të cilat marrim të ardhura.

Jorida Tabaku – Po, pra, por zoti Bushati ju pyeti 4 herë qëparë dhe ju thatë se marrim vetëm tarifën e pastrimit.

Tani, ne po diskutojmë për një kontratë publike. Në njoftimin që ju ka ardhur, unë e lexova me kujdes, ju thuhet se cili është objekti i punës së komisionit hetimor. Kur thuhet objekti i punës së komisionit hetimor, një administratore, që është regjistruar si e tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, besoj se është përgjegjëse që ta ketë të gjithë informacionin, jo të thotë që këtë e di dhe këtë nuk e di. Sidoqoftë, kjo është në të drejtën tuaj. Nëse nuk doni të përgjigjeni, është gjë tjetër.

Kam edhe një pyetje për lejen e ndërtimit. U pyet disa herë se kur është leja e ndërtimit dhe është shumë e rëndësishme për qytetarët të kuptojnë se këtu po diskutojmë për dy elemente të

ndryshme: për zbatimin e kontratës, të cilën ne e kemi lexuar të gjithën në detaje, ku janë përgjegjës kompania dhe autoriteti koncensionar, por njëkohësisht edhe për eficiencën dhe përdorimin e fondeve publike, ku përgjegjëse këtu është zonja administratore, në emër të kompanisë.

Në faqen 26 të kontratës koncensionare thuhet: “Leja e ndërtimit do të merret 6 muaj pas firmosjes së kontratës”. E përmendi zoti Boçi, e përmendi zonja Çupi, zoti Helidon Bushati dhe disa prej nesh. Është shumë e rëndësishme për ta kuptuar këtë, sepse nga marrja e lejes së ndërtimit dhe nga zbatimi i saj varet grafiku i punimeve dhe fakti që kompania nuk i ka përmbushur detyrimet e saj.

Edhe një herë, do të doja të dija, përse nuk është marrë leja e ndërtimit menjëherë, 6 muaj pas firmosjes së kësaj kontrate?

Ariola Kodra – Mendoj se këtë pyetje duhet t’ua bëni institucioneve kompetente për lëshimin e lejes së ndërtimit.

Jorida Tabaku – Ju keni aplikuar dhe nuk është dhënë leja e ndërtimit, 6 muaj pas firmosjes së kontratës?

Ariola Kodra – Kemi bërë aplikime dhe shkëmbime shkresore me institucionet kompetente.

Jorida Tabaku – A keni aplikuar apo jo për leje ndërtimi? Sepse shkëmbime shkresore kemi bërë edhe bashkë dhe keni kthyer një përgjigje negative, kur ju kemi kërkuar këto informacione që po ju themi tani.

Ariola Kodra – Po, në dijeninë time, është aplikuar për leje ndërtimi.

Jorida Tabaku – 6 muaj pas firmosjes së kontratës?

Ariola Kodra – Ka një staf teknik që merret me procedurën. Datën e saktë të aplikimit nuk e kujtoj. Mund t’jua vendos në dispozicion.

Jorida Tabaku – Patjetër, në listën e gjatë për të cilën ky komision ka nevojë për informacion.

Fjalën e ka zoti Pëllumbi. Më pas do të vazhdoj edhe me dy pyetje të tjera.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, për procedurë, të lutem!

Gjykoj se nuk jemi duke operuar ashtu siç duhet. Ju filluat e para me pyetje dhe, në qoftë se kishit një bateri të tërë pyetjesh, mund t’i kishit bërë në atë moment. Flasin disa nga kolegët qoftë të opozitës, qoftë të maxhorancës, dhe më pas ju ndërhyri me pyetje të tjera. Nuk më duket e drejtë mënyra se si duhet ta zhvillojmë këtë seancë pyetjesh.

Nëse keni një grup pyetjesh, drejtojini në kohën kur merrni fjalën për të bërë pyetje dhe më pas vazhdoni me drejtimin e komisionit. Sa herë krijohet një boshllëk i vogël ju ndërhyini me pyetje të tjera. Kjo nuk më duket e drejtë dhe do të doja ta mbanit parasysht për dëshmitarët e ardhshëm.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, edhe unë ju falënderoj!

Ndryshe nga zoti Ajazi, unë besoj se ky komision nuk është një palaço. Ne po tregojmë seriozitet këtu, në komision. Kemi diskutuar çdo letër dhe çdo shkresë. Nga pyetja del një pyetje e radhës. Qëllimi i kësaj seance...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të përgatitur jemi. Të gjitha... Nga përgjigjet e zonjës dalin pyetje të tjera.

Unë dua t'i rikthehem edhe një herë në fund diskutimit të shpenzimeve, që ne e nisëm, dhe dua të përfundoj pyetjet, në qoftë se asnjë nga kolegët e tjerë nuk ka pyetje.

Zonjë, a e njihni ju zotin Edmond Arqile Bllako?

A keni pasur marrëdhënie pune?

Për çfarë ka qenë ai i punësuar në kompaninë tuaj?

Ariola Kodra – Sikurse e përmenda, zoti Edmond Bllako ka qenë punonjës i shoqërisë, i cili është punësuar para administrimit tim. Pozicioni i punës së tij ka qenë inxhinier mekanik, drejtues departamenti për sa u përket çështjeve teknike.

Jorida Tabaku – Dakord.

Ju falënderoj!

A keni pasur marrëdhënie të shpeshta pune me zotin Edmond Bllako?

A kishit dijeni që djali i tij ishte sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, vendimmarrës në kontratat koncensionare dhe në zbatimin e kontratës koncensionare? Të mos harrojmë se autoriteti kontraktues është Ministria e Mjedisit.

Ariola Kodra – Unë nuk e njoh personalisht as zotin Edmond Bllako dhe as djalin e zotërisë në fjalë.

Jorida Tabaku – A keni dijeni që autoriteti kontraktues përgjegjës për zbatimin e projektit është Ministria e Mjedisit, në të cilën ka qenë sekretar zoti Alqi Bllako?

A keni kontakte me autoritetin kontraktues?

Kush ka qenë *counterpart*-i juaj në autoritetin kontraktues?

Ariola Kodra – Kontaktet me ish-autoritetin kontraktues, Ministrinë e Mjedisit, se më pas kaloi në kompetencë të MIE-së, i kanë mbajtur paraardhësit e mi. Për këtë pjesë nuk mund të kem një...

Jorida Tabaku – Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Zonja Kodra, nga ajo çfarë u fol deri tani duket që është e qartë, sipas jush, që *landfill*-i depoziton, komposton mbetjet dhe i seleksionon. Po ato që janë për incenerim, i heq veçmas dhe kur të ndërtohet inceneratori do të digjen apo i depoziton në *landfill*?

Ariola Kodra – Mbetjet që mbeten pas trajtimit të seleksionimit depozitohen në *landfill*-in e ri të ndërtuar dhe aty kompostohen.

Luçiano Boçi – Shumë mirë.

Atëherë, kur mbetjet ndjekin këtë procedurë dhe kompostohen edhe ato që do të incenerohen, tani, tarifën ju e keni 29 euro, do ta keni për 30 vjet 29 euro. Ambienti, sipas fotove tuaja, është i gjelbër, ajri i pastër, Tirana nuk ndotet. Pyetja e fundit, po përse, dreqi e mori, duhet inceneratori? Ju me fitim jeni, duke e rritur vit për vit, përse duhet inceneratori pas kësaj, sepse gjithçka qenka në rregull, e paketuar? Përse duhet inceneratori?

Ariola Kodra – Sepse *landfill* ka një jetëgjatësi të përcaktuar, nuk mund të jetë përjetësisht.

Luciano Boçi – Pse inceneratori është përjetësisht? Edhe inceneratori ka një kohë të caktuar. Sipas dokumenteve, *landfill* mund të zgjasë më shumë se inceneratori. Për shembull, inceneratori i Elbasanit parashikohet deri në 90 vjet, sipas dokumenteve, ndërsa *landfill* që do të ndërtohej në Elbasan ishte parashikuar për 100 vjet. Prandaj nuk është kjo përgjigjja.

Jorida Tabaku – A ka pyetje të tjera për zonjën Ariola Kodra? Nuk ka. Unë besoj se sot nxorëm disa elemente shumë të rëndësishme, që do t'i shërbejnë punës së këtij komisioni, në lidhje me zbatimin e kontratës, me faktin që nuk ndodh incenerimi dhe me pagesat publike.

Unë dua të bëj një përmbledhje të kërkesave që zonja premtoi që t'ia sjellë më vonë këtij komisioni, si:

Bilancet e miratuar nga kompania e zonjës Stela Gugalli, që zotëronte një kompani autiditimi.

Vlera e dy kredive, që janë përdorur për projektin, megjithëse u tha se në planin e biznesit që nuk është e nevojshme për kredi.

Deklaratën paraprake për fillimin e punimeve.

Dokumentin për shpalljen e gjendjes së emergjencës mjedisore.

Kontratën e punësimit të zotit Edmond Bllako dhe pagesat që i janë bërë atij.

Grafikun e ri të punimeve nga kompania e konsultimit, të supervizimit mos gaboj, e zotit Arben Dervishaj.

Zoti Këlliçi ju kërkoi kontratat që keni me dy kompanitë e zotëruara nga zoti Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, në shërbimet e konsulencës me pagesën 650 mijë euro.

Unë ju kërkova kontratat me televizionet për publicitetin dhe marketingun, njëkohësisht edhe listën e kontratave me institucionet arsimore dhe ato universitare.

Zonja Zhupa pati një sërë pyetjesh në lidhje me çështjen e grafikut të punimeve, ndërsa zoti Helidon Bushati bëri disa pyetje për sa i përket vlerës së fitimeve të realizuara. Nuk e di nëse harrova diçka tjetër, nëse nuk kam harruar ndonjë gjë tjetër, dua që zonja Ariola Kodra...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sigurisht që do ta bëjmë. Kërkoj që zonja Ariola Kodra t'i sjellë këtij komisioni këto dokumente, si dhe kërkoj praninë e saj në fund të kësaj jave me këto dokumente. Tani që zonja Ariola Kodra mori edhe njoftimin se cila është puna dhe objekti i këtij komisioni hetimor, herën tjetër do të jemi shumë shkurt, vetëm për dokumentet e kërkuara dhe për pyetjet që nuk kishit përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto që përmenda unë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj thashë a ka ndonjë gjë tjetër që kam harruar?

Ina Zhupa – Po, ka premtuar se do të sjellë listën e kompanive me të cilat ka kryer marrëdhënie transaksioni, listën e kompanive që bëjnë riciklimin, listën e punëtorëve, të ndara sipas angazhimeve në faza, kush merret me diferencimin dhe kush me riciklimin...

Jorida Tabaku – Zonja Zhupa, unë e përmenda grupin e pyetjeve, por të gjitha pyetjet do t'i nxjerrim kur të zbardhim procesverbalin, sepse ishin shumë pyetje dhe të mos i përmendim edhe njëherë.

Ina Zhupa – Se mos thuhet që nuk duhet t'i sjellë.

Jorida Tabaku – Përmenda vetëm këto. E rëndësishme është që të marrim librat e shitjes dhe blerjes, sidomos për tre kompanitë që janë vërtetuar se kanë kryer pastrim parash, të cilat janë nën hetim të lidhura me zotin Lefter Koka.

Zoti Pëllumbi keni diçka tjetër?

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, zonja Kodra ishte dëshmitarja e parë, ne në ditët në vijim do të kemi dëshmitarë të tjerë. Unë dua t'ju kujtoj juve, si kryetare e këtij komisioni, se, në zbatim të ligjit dhe të rregullores, që kemi miratuar, çdo deputet që është anëtar i këtij komisioni ka të drejtë të bëjë pyetje dhe dëshmitarët të përgjigjen. Nuk mund të bëhen komente as nga ju, si kryetare e këtij komisioni, dhe as nga ne, si anëtarë, dëshmitarëve u bëhet pyetje dhe ata duhet të përgjigjen.

E dyta, duhet t'i përmbaheni planit të hetimit, të cilin ne e kemi miratuar në këtë komision. Nuk mund të bëjmë dy pyetje dhe të rrimë gjysmë ore pastaj të bëjmë 2 pyetje të tjera dhe pastaj 2 pyetje të tjera. Prandaj duhet të unifikohet, të bëjmë pyetje, dëshmitarët të përgjigjen dhe të mos bëhen komente.

Faleminderit!

Jurida Tabaku – Po, zoti Këlliçi.

Belind Këlliçi – Zonja Tabaku, vetëm një kujtesë, nëse nuk u mbajt shënim, u deklarua nga zonja Kodra që do të vë në dispozicion edhe kontratat me dy kompanitë “Pivo 04” dhe “AS Grup”, të cilët janë nën objekt hetimi nga SPAK-u.

Jorida Tabaku – Në fakt, janë 3 kompani, zoti Këlliçi. Unë i kërkoja zonjës kontratat, librin e shitjeve dhe të blerjeve, që njëkohësisht është pjesë edhe grupi i kontratave që përmendi zoti Këlliçi, dhe nënkontraktorëve.

Unë dua t'u kujtoj të gjithë deputetëve këtu që ne këtu jemi për të mbrojtur interesin publik, ne këtu jemi për të parë se si fondet publike po përdoren dhe si po zbatohet një kontratë koncesionare 430 milionë euro. E di që mund të bezdiseni pak nga kjo procedura, por interesi publik prevalon. Është më e rëndësishme të kuptojmë se si përdoren fondet publike, se sa të rrimë t'i bëjmë avokatinë kompanisë, personave që janë sot në kërkim apo njëkohësisht edhe kujtdo që ulet në atë bankë dëshmitarësh.

Të nderuar kolegë,

Parlamenti na ka dhënë një mandat shumë të rëndësishëm, mandatin për të hetuar këtë aferë korruptive. Unë e kuptoj që nuk keni pyetje, por të paktën mos u bëni pengesë e këtij hetimi.

Dua të njoftoj komisionin, përpara se t'ia jap fjalën zotit Pëllumbi, që do të riskedulojmë takimin me zotin Faraudin Arapi dhe Arjan Baçi, nëse nuk gaboj, përfaqësuesit që sot

administrojnë inceneratorin e Elbasanit, sepse është një skenë krimi dhe administrohet nga dy përfaqësues shtetërorë.

Zoti Loren Dusha, sapo na kontaktoi, e ka marrë njoftimin me vonesë në atë adresë, dhe nuk mund të vijë në orën 15:00.

Me zotin Pëllumbi do të lëmë një orar se kur do të vijë dhe presim në orën 16:00 zotin Arenc Myrtezani, për të cilin nuk kemi asnjë informacion. Prandaj, po nuk pati ndonjë gjë tjetër, bëjmë 30 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë e ka kërkuar fjalën zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Zonja kryetare, ne thamë që nuk do të bëjmë komente, por ju nuk i shpëtuat këtij tundimi, prandaj më duhet të ndërhyj për t’ju kujtuar edhe një herë që të gjitha palët këtu jemi për të njëjtin qëllim. Nuk jeni ju dhe nuk e keni tagrin fare e atij që mbron më shumë se sa ne të tjerët interesin publik dhe financat e shtetit. Të mos harrojmë që qytetarët na kanë besuar neve për ta drejtuar këtë vend dhe ne jemi parët më të interesuar, se sa të gjithë të tjerët, që gjërat të shkojnë mirë, që kur të përballemi përsëri me elektoratin të mund të jemi ballëhapur.

Prandaj, nuk dua që në mbledhjet e ardhshme të vazhdojmë me të njëjtin ritual, që ju jeni të ndershmit dhe ne të pandershmit; ju jeni ata që mbronin interesin e publikut, ndërsa ne bëjmë këtu avokatin e kompanive. Dua që këtë të mos e bënit, të hiqni dorë nga kjo gjë. Nuk e keni ju tagrin të gjykoni nëse ka ndodhur apo nuk ka ndodhur, nuk jua jep askush këtë të drejtë. Të gjithë ne këtu jemi për të bërë një punë, kemi një plan hetimi, kemi Rregulloren e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare. Për sa kohë ju dilni përtej kësaj, ne do të bëjmë ndërhyrjet tona në çdolloj rasti.

Jorida Tabaku – Atëherë, nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër bëjmë 30 minuta pushim dhe i diskutojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e ka kërkuar edhe zonja Dhima, por të mos e zgjasim, sepse po vazhduat ju do të vazhdojë edhe krahu tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj, kur të më heqin mua, mund të vish ti si kryetar, mua urdhra nuk më jep dot!

Fjala për zonjë Dhima.

Etjen Xhafaj – Atëherë, mbani etikë dhe jepua fjalën njerëzve.

(Ndërhyrje pa mikrofon e zonjës Tabaku)

Dakord, lexo Rregulloren e Kuvendit.

(Debat pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Zonja Kryetare, në vijim të marrëdhënies që ne kemi pasur deri tani, kërkoj që kërkesat e reja t'i drejtohen jo vetëm zonjës Kodra, por edhe personave të tjerë, me shkresë zyrtare, pasi procesverbali të zbardhet nga ana e sekretarisë së komisionit.

Jorida Tabaku – Zonja Dhima, dua t'ju kujtoj që për pengesat që i keni krijuar këtij komisioni dhe kohëzgjatje, nuk kemi kohë fizike. Ia kërkoja zonjës, në dëshmi e kemi këtu që do t'i sjellë.

Rregullorja e komisionit hetimor, zonja Dhima, thuaja kujt do që po ju sjell mesazh, merr parasysh materialet që dorëzohen këtu në dëshmi. Zonja të vijë dhe të na i sjellë dhe ne të skedulojmë një orar. Zonja e pranoi që do të na i sjellë, prandaj mos na e pengoni punën e komisionit.

Fjala për zotin Nasufi.

Antoneta Dhima – Bëhet me shkresë zyrtare, nuk kërkoja ndonjë gjë ndryshe nga ajo çfarë kemi bërë deri tani.

Fadil Nasufi – Ne këtu jemi komisioni i hetimit për çështjen e inceneratorëve dhe nuk jemi skemë krimi, siç e artikulonin ju. Skenë krimi, në dijeninë time, është vendi ku vrasësi ka zgjedhur të vrasë viktimën. Skenë krimi shtetëror unë quaj Gërdecin, quaj vrasjen e Azem Hajdarit, quaj vrasjen e Remzi Hoxhës, quaj vrasjet e 21 janarit dhe nuk i quaj këto skenë krimi. Prandaj korrigjo gjuhën dhe futu në procedurë, mos përdor këtu terma as provokimi dhe as politike. Këto janë skena krimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem, unë këtë retorikën politike e dëgjoj sa herë gjenden keq zotërinjtë dhe përmendin “x” dhe “y” pas 9 vjetëve në pushtet, hetojini të gjitha. Këtu Partia Demokratike ka ardhur për komisionin e inceneratorëve dhe do t'i shkojë deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngrini komision hetimor dhe çojini që të gjitha përpara drejtësisë, keni 9 vjet në pushtet, vijmë edhe ne të marrim pjesë. Për inceneratorët do t'i shkojmë deri në fund.

(Debat pa mikrofon)

30 minuta pushim. Fillojmë në orën 16:00.

(Rifillon mbledhja.)

Jorida Tabaku – A jemi gati për mbledhjen? Po.

Të nderuar kolegë, faleminderit për durimin që treguat në seancën e gjatë të pyetjeve të zonjës Arjola Kodra, administratoren e inceneratorit të Tiranës.

Sot ishte planifikuar zoti Faraudin Arapi, administratori aktual i inceneratorit të Elbasanit, i cili e ka marrë njoftimin vonë dhe do ta skedulojmë orarin për ditën e nesërme, në bashkëpunim me orarin e zotit Pëllumbi.

Zoti Loren Duzha, administratori i inceneratorit të Fierit, na komunikoi që ka shprehur vullnetin për të dëshmuar, por e ka marrë njoftimin me vonesë, dhe zotit Elvi Fundo, nuk i është nisur njoftim, por zoti Këlliçi na njoftoi se ka komunikuar me të dhe ai ndodhet jashtë Shqipërisë.

Sot në orën 16:00 kishim lënë dëshminë e zotit Arenc Myrtezani. Sipas informacioneve që kemi deri në këtë moment në Kuvend, njoftimi për zotin Arenc Myrtezani nuk është kthyer, prandaj gjykojmë që ai duhet ta ketë marrë njoftimin. Nëse zoti Myrtezani nuk ndodhet këtu, unë i kërkoj stafit të komisioni dhe strukturave të parlamentit të mbështesin komisionin hetimor me njoftimin e policisë dhe shoqërimin e zotit Arenc Myrtezani përpara këtij komisioni. Shoqërimi i tij nuk bëhet vetëm në rastin kur zoti Arenc Myrtezani është person i shpallur në kërkim. Në informacionin tonë, ne kemi komunikuar me institucionet përkatëse, ai nuk është person në kërkim, prandaj i kërkoj stafit të Kuvendit që të ndjekë këtë procedurë dhe të vazhdojmë më pas nesër, sipas skedulimit të dëshmive që kemi rënë dakord dhe me njoftimet përkatëse.

Po, zonja Denaj.

Anila Denaj – Nëse zoti Fundo i konfirmoi me një sms zotit Këlliçi për arsye të njohjes, kjo nuk do të thotë që njoftimi është zyrtar. Pra, ne duhet të jemi të njëtrajtshëm me të gjitha njoftimet si për zotin Fundo, ashtu dhe për zotin Myrtezani e të tjerë.

Gjithashtu, të mos paragjykojmë nëse e ka marrë apo jo njoftimin, kur nuk e dimë, sepse nuk kemi ndonjë kontakt që të na sjellë ndonjë sms. Fakti që njoftohen dhe ka një afat të shkurtër kohe është i argumentuar dhe jemi të gjithë të hapur për ta riskeduluar, por për të shkuar deri në paragjykimin që nuk e ka marrë mesazhin, sepse nuk kemi asnjë përgjigje... Ne duhet të punojmë me sekretarinë, në mënyrë që të gjithë të marrim dhe dimë që ka një përgjigje, e cila të justifikojë refuzimin e tij, kushdo qoftë, sepse jo të gjithë mund të kenë të njëjtën marrëdhënie siç ka zoti Fundo me zotin Këlliçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ja një sekondë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po thotë për rastin e zotit Myrtezani, nëse ia japim mundësinë këtij zotërisë, përse të mos e japim edhe për tjetrin.

Zonja Denaj, jam jashtëzakonisht e hapur për këtë pjesë.

Zoti Loren Duzha na kishte dëgjuar dje në medie që e kishim thirrur si dëshmitar, megjithëse njoftimi kishte shkuar në të njëjtën adresë, nuk e kishte marrë kërkesën dhe na kontaktoi vetë sot. Ndërkohë, në rastin e zotërisë posta nuk është kthyer pas. Ne jemi të hapur deri në fund.

Stafi i Kuvendit, këshilltarët dhe sekretarja e komisionit, sot nga ora 08:00 e mëngjesit dhe deri tani vetëm këtë gjë ka bërë, pra janë marrë vetëm me kontaktet për ditën e sotme dhe të nesërme, deri në momentin që ai vjen. Pastaj nëse ne na kalon koha fizike deri në fund të javës dhe nuk kemi asnjë përgjigje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht.

Besion Ajazi – Faleminderit!

Zonja kryetare, ndoshta në fjalën tuaj të parë bëtë një gabim procedural, sepse nuk mund të kërkonti thirrjen me forcë apo me polici të një dëshmitari pa konsumuar 2 thirrje për të. Pra, proceduralisht dëshmitari thërritet herën e parë, merret konfirmimi që e ka marrë thirrjen, por nuk vjen, atëherë bëhet thirrja e dytë dhe në rast se ai nuk vjen...

(Diskutim pa mikrofon)

Dakord, a mund ta mbaroj si procedurë, sepse ishit në shkelje, që ta informojmë edhe opinionin?

Nëse edhe në rastin e thirrjes së dytë nuk paraqitet, atëherë i bëhet një shkresë Policisë së Shtetit, që e thërret me forcën e ligjit. Pra, nuk mund të kërkojmë thirrjen me forcë të një dëshmitari që në thirrje të parë.

Jorida Tabaku – Zoti Ajazi, këtë gjë e sqarova me zonjën Denaj, pak përpara se ju të vinit.

Unë ju falënderoj për të gjithë sugjerimi dhe shpresoj që deri në fund të komisionit të jemi të gjithë po kaq aktivë sa kemi qenë sot.

Faleminderit!

Atëherë, në komision kemi zotin Myrtezani dhe specialistin, ekspertin e Partisë Socialiste, që na u bashkua në këtë moment. Pra, jemi gati të fillojmë me zotin Myrtezani.

Zoti Myrtezani, faleminderit që erdhët!

Ishim në dyshim nëse do të vinit ose jo. Njoftimi që kemi bërë nuk na ka ardhur mbrapsht nga ju dhe nuk e kishim të qartë adresën, prandaj po diskutonim për hapësirën deri në fund të javës që ju të ishit i pranishëm.

Unë dua t'ju kujtoj që, sipas nenit 18, dëshmia do të merret pas kryerjes së betimit.

“Betohe se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë”.

Arenc Myrtezani – Betohe.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Myrtezani, dua t'ju kujtoj që, sipas nenit 306 të Kodit të Procedurës Penale, për dëshminë e rreme, kushdo mund të dënohet deri në 6 vjet dhe ky komision hetimor, me gjithë autoritetin, përgjegjësinë dhe tagrin që i takon, të gjitha informacionet që ka do t'ia dorëzojë organeve kompetente dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk jemi as hetues dhe as vendosim pranga, se po të vendosnim pranga, do t'ia kishim vendosur Edi Ramës me kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Institucioneve të drejtësisë për të gjitha seancat me pyetjet e dëshmitarëve që ne do të konsumojmë gjatë kësaj jave, por edhe fillimit të javës tjetër.

Fillojmë me pyetjet për zotin Myrtezani. Meqenëse e kemi eksperiencën e zonjës Kodra, do të procedojmë pak më shpejt dhe do t'i grupojmë pyetjet në grupe, që të mos përsërisim veten.

Zoti Myrtezani, a mund t'i prezantoheni komisionit dhe të na sqaroni pozicionin tuaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke parë se si vajti pjesa e parë e mbledhjes dhe kohëzgjatja e saj, unë dua që ne t'i qëndronim striktë asaj për të cilën ne kemi rënë dakord. Sot pyetjen e dëshmitarit e kemi 1 orë, prandaj t'i përmbledhim pyetjet dhe të jemi koncizë në atë që bëjmë, në mënyrë që të kemi rentabilitet dhe efikasitet në këtë punë që po bëjmë, duke pasur parasysh që përpara kemi shumë dëshmitarë të tjerë për të pyetur.

Besoje se do ta merrni parasysh këtë sugjerim timin.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Myrtezani, a mund t’i prezantoheni këtij komision dhe njëkohësisht marrëdhënien tuaj me kompaninë e inceneratorit të Fierit?

Arenc Myrtezani – Përshëndetje të gjithëve!

Ajo që dua të them në fillim, është se po më merret frymë akoma, se kam ardhur me vrap...

Jorida Tabaku – Ju kërkohet ndjesë, i kërkohet stafit të sjellë një shishe me ujë për zotin Myrtezani.

Arenc Myrtezani – Jo, jo nuk ka nevojë për ujë, por thjesht për t’ju treguar që në këtë moment më ka rënë një telefon, por për fat isha afër dhe erdha me vrap, se nuk dija gjë. Pra, nuk më ka lajmëruar njeri.

Jorida Tabaku – Ne e kemi çuar njoftim, në një adresë që me stafin e Kuvendit mund ta konfirmojmë më vonë.

Meqenëse keni ardhur rastësisht, nëse keni dëshirë edhe mund ta riskedulojmë takimin.

Arenc Myrtezani – Jo, unë jam i gatshëm të përgjigjem me ato që mbaj mend, në të kundërt pastaj nuk e di...

Jorida Tabaku – Gjykojeni ju, anëtarët e komisionit janë të hapur ta vendosin si ta vendosni ju. Zoti Pëllumbi, si e gjykoni?

Arenc Myrtezani – Jo për mua e vazhdojmë për aq sa e mbaj mend, sepse edhe periudha ime nuk ka qenë e ngarkuar.

Jorida Tabaku – Dakord, atëherë e ezaurojmë tani, meqenëse keni ardhur.

Në cilën periudhë keni qenë i përfshirë në kompaninë e inceneratorit?

Arenc Myrtezani – Unë kam qenë i përfshirë nga tetori i vitit 2016 deri në shtator, nëse nuk gaboj, të vitit 2017.

Jorida Tabaku – Cilët janë pronarët e kompanisë për të cilën ju punonit?

Arenc Myrtezani – Pronari i kompanisë ku unë kam punuar është Klodian Zoto, kjo është dhe arsyeja që më bashkon me Fierin, sepse punoja për Zoton dhe më ofroi mundësinë për të punuar në Fier.

Jorida Tabaku – Ju ishit i punësuar në një biznes tjetër dhe lëvizët këtu?

Arenc Myrtezani – Po, tek ITS-ja.

Jorida Tabaku – Zotin Zoto e njihni në marrëdhënie pune, siç deklaroni, po zonjën Stela Gugallja dhe zotin Mirel Mërtiri a i njihni?

Arenc Myrtezani – Në të njëjta marrëdhënie i njoh, nuk na ka lidhur puna, por për shkak të njohjes që kishin, por jo ndonjë ...

Jorida Tabaku – Zoti Mirel Mërtiri nuk është aksioner në rastin e inceneratorit të Fierit...

Arenc Myrtezani – Jo, jo, janë njohje të vjetra personale. Nëse doni jua shpjegoj më gjatë.

Jorida Tabaku – Jo, për ne nuk ka rëndësi.

Arenc Myrtezani – Nëse ka interes mund t'jua shpjegoj më gjatë.

Jorida Tabaku – Nuk na intereson vetëm thjesht...

Arenc Myrtezani – Kjo lidhet me shumë vite më përpara, janë njohje me babai e Stelës, që unë kam punuar dhe për rrjedhojë...

Jorida Tabaku – Për këtë komision nuk ka rëndësi, vetëm marrëdhëniet e punës po diskutojmë.

Arenc Myrtezani – Dakord.

Jorida Tabaku – Kur ka qenë komunikimi i fundit i juaji me këta shtetas?

Arenc Myrtezani – Komunikimi im i fundit ka më shumë se një vit e gjysmë. Me komunikim nënkuptoni takim?

Jorida Tabaku – Jo, komunikime telefonike dhe takime.

Arenc Myrtezani- Takimet kanë qenë shumë të rralla, ka mbase një vit.

Jorida Tabaku- Pse u larguar nga kompania ku ishit administrator?

Arenc Myrtezani- Jam larguar për shkak të distancës, nuk e përballoja dot, ishte ngarkesë e madhe çdo ditë për mua. Pata, gjithashtu, edhe probleme shëndetësore.

Jorida Tabaku – Cili është profesioni juaj?

Arenc Myrtezani- Jurist.

Jorida Tabaku - A keni njohuri në administrimin e mbetjeve?

Arenc Myrtezani - Jo.

Jorida Tabaku - Është e para.

A keni pasur informacione paraprake para se të fillonte kontrata e inceneratorit të Fierit?
A jeni përfshirë në grupin e hartimit të propozimit për tender?

Arenc Myrtezani - Jo, kam hyrë më pas.

Jorida Tabaku - Ju keni lidhje vetëm me zbatimin e kontratës?

Arenc Myrtezani - Po.

Jorida Tabaku – Kompania në të cilën është inceneratori i Fierit në momentin që ka marrë kontratën për zbatim, ka bërë edhe një ndryshim të kuotave të aksioneve?

Arenc Myrtezani – Po.

Jorida Tabaku - Ndryshim i kuaotave të aksioneve për kompaninë e ndërtim –montimit në Patos, ka kaluar nga aksioneri italian, i cili ishte përgjegjës, në fakt, kishte eksperiencën për incenerim dhe i kaloi kompanisë ndërtim-montim Patosit. A keni ndonjë dijeni për transferimin e këtyre aksioneve? Pse ndodhi, dhe me vlerën 20 mijë lekët të rinj, në mos gaboj, një kontratë koncesionare që kushtonte 28 milionë euro.

Arenc Myrtezani- Nuk kam dijeni, sepse nuk kam bërë pjesë aty.

Jorida Tabaku - A keni dijeni nëse kompania e inceneratorit të Fierit ka lidhur kontrata për kredi?

Arenc Myrtezani – Po, për këtë kam dijeni.

Jorida Tabaku - Edhe në rastin e inceneratorit të Fierit duhet t’u kujtoj kolegëve të këtij komisioni që në planin e biznesit nuk thuhet që do të merrej një kredi, por do të mbulohej me fondet e vetë kompanisë. A ka rezultuar i punësuar në kompaninë e inceneratorit të Fierit shtetasi Edmond Arqile Bllako?

Arenc Myrtezani - Jo.

Jorida Tabaku– Në dijeninë tuaj në kohën që keni qenë ju?

Arenc Myrtezani – Jo. Unë kam qenë që në fillim dhe ishin të paktë njerëzit, kështu që i njoh.

Jorida Tabaku - A e mbani mend listën e kontraktorëve të kompanisë? Kompania merrte shërbime të tjera njëkohësisht nga kompanitë e zotërinjve Klodian Zoto dhe Mirel Mërtir?

Arenc Myrtezani - Në atë kohë ka qenë fillimi i punimeve. Pra, unë jam marrë konkretisht me terrenin, që do të thotë me pak probleme me banorët, ato që janë parë edhe ne medie, pastaj edhe me sistemimin e të terrenit, rrethimin dhe këto gjëra. Me ITS-në është lidhur kontratë për zhvillimin, për shkak të eksperiencës që ITS-ja kishte në këtë fushë. Gjë tjetër nuk di.

Jorida Tabaku - Inceneratori i Fierit është rasti i vetëm në të cilin kontrata ka filluar zbatimin më vonë. Unë e kam kontratën koncesionare këtu dhe nuk është zbatuar kalendari i punimeve, sipas kontratës. Juve sapa përmendët disa arsye që lidhen me banorët. A ka pasur nga autoriteti kontraktues shprehje të vullnetit për të ndaluar pagesat, meqenëse nuk po kryheshin punimet?

Arenc Myrtezani - Unë nuk e kujtoj këtë pjesë.

Jorida Tabaku - A ka në dijeninë tuaj informacione, kontakte me autoritetin kontraktues sa i përket skedulit të pagesave. Kontrata koncesionare e inceneratorit të Fierit merr parasysh që pagesa fillon 7 muaj pas firmosjes së kontratës, ndërkohë që pagesat kanë filluar menjëherë. Elbasani dhe Fieri janë njëlloj, Tirana është ndryshe. A keni dijeni pse filluan pagesat menjëherë në inceneratorin e Fierit?

Arenc Myrtezani - Nuk kam dijeni. Në dijeninë time, me çfarë kujtoj nga leximi i kontratës, kjo ishte rrjedhojë e një kontrate të lidhur ndërmjet dy kompanive me të gjitha kushtet që ajo përmban brenda, si një kalendar pagesash kundrejt. E vërteta është që ne atje kemi filluar edhe më përpara se të bëheshin këto, me sistemimet dhe gjërat, sepse kemi pasur peripeci, ishte vendi i tretë, pra shkuam si top futbollit, hidh këtë hidh andej, nuk kuptohej gjë se çfarë bëhej.

Jorida Tabaku – Ju e keni lexuar studimin e fizibilitetit të kompanisë?

Arenc Myrtezani – Jo.

Jorida Tabaku – Sepse në studimin e fizibilitetit ishte një analizë e detajuar, zonja Çupi ndoshta mund ta zhvillojë pak më shumë këtë pyetje, për sa i përket tokës ku do të zhvillohej, ndërkohë që më pas doli që toka nuk ka mundësitë gjeofizike të përshtatshme për ta ndërtuar aty. Në studimin e fizibilitetit thuhej që këtu ka ndodhur një analizë e mjedisit dhe këtu mund të realizohet ndërtimi. Kjo është një pikëpyetje e madhe për ne. Pse në studimin e fizibilitetit ishte sqaruar që kjo mund të ndodhë, ndërkohë që në praktikë?

Arenc Myrtezani – Mundem?

Jorida Tabaku – Po, patjetër.

Arenc Myrtezani – Atëherë, në kujtesën time, më tepër ishin biseda me inxhinierët dhe specialistët e fushës, që një problem i tillë është i parashikuar në inxhinieri: nëntoka nxjerr problemi nga më të ndryshme, të paparashikuara dhe kjo pikërisht ka ndodhur atje, u shtuan kostot, po zgjidhja ishte dhe u bë.

Jorida Tabaku – Zonja Çupi, a keni pyetje për këtë, sepse unë kam dhe disa pyetje të tjera, po të mos ta rimarrim disa herë këtë temë.

Dhurata Çupi – Faleminderit për praninë!

Unë kam edhe një komision tjetër në 16:30, zonja kryetare, kështu që do më duhet të lëviz, por diskutimi ka qenë i tillë. Ka pasur një vendim të këshilli bashkiak të Fierit që në një nga fshatrat e komunës së Portës do të miratohej ose u miratua vendosja e këtij landfilli dhe më vonë të

inceneratorit. Nga ky fshat u kalua në një fshat tjetër të Portësit, me arsyetimin se studimi i fizibilitetit këtu është i kryer profesionalisht, ka një studim të thelluar dhe garantohej që në komunën Portës do të kryhej investimi për inceneratorët, më pas kalon nga këtu, me arsyetimin që aty kalon Gjanica dhe nuk është toka e qëndrueshme. Pra, vetë ata që e kishin studiuar pretendojnë se nuk ka qëndrueshmëri toka.

Ndërkohë, në Mbrostar, që është vendimi i tretë, jo vetëm që nuk reflektohen në kontratë ndryshimet e destinacionit ku do të ndërtohej inceneratori, gjendet një pjesë ku pikërisht qëlloj të ishte tokë private, pra nga 10 zgjedhje që vendoste në dispozicion ZRPP-ja, ku ishin dy pasuri shtetërore, katër pasuri në pronësi të bashkisë dhe 2 private, është zgjedhur pikërisht kjo privatja, me një kosto rreth 400 milionë lekë shpronësimi, ku me vendim të Këshilli të Ministrave i kalon t'i paguajë OST-së. Diskutimi është, edhe gjatë vizitës në vend pamë që lumi kalon edhe tek kjo që po ndërtohet, pra kam përshtypjen që në të dy...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po shumë pak larg ishin, jo, po sepse ju i ratë diagonal, zonja Dhima, ne i ramë përreth dhe pamë që ishin shumë afër, e njëjta çështje.

Problematika është pse kaluan, pra kishte një studim, ku jepej dhe garanci profesionale që në fshatin e Portësit të vendosej ky incenerator, dhe ikën nga ky destinacion dhe kalon në Mbrostar, ku të paktën minimalisht shtohet dhe 400 milionë shpronësimi i pasurisë së privatit? Cili ishte argumenti që u transferua vendndërtimit të inceneratorit në tre pika të ndryshme dhe çfarë bëtë ju që të reflektohej në kontratë, pasi në këtë të fundit vendndërtimi i inceneratorit është shtuar pas dy vitesh, me sa kam parë unë në kontratë?

Mbas dy vitesh është shtuar, është bërë pjesë e kontratës pika e tretë e ndërtimit. Pra, është ndërruar tre herë vendi i ndërtimit të inceneratorit. Ndërkohë që studimi i fizibilitetit e kishte përcaktuar qartë, e ritheksoj dhe nga ana profesionale, që ka një qëndrueshmëri dhe është e studiuar për në komunën Portës.

Arenc Myrtezani – Atëherë, për gjithë këtë proces bëhet fjalë para se unë të filloja aty. Mund t'ju sqaroj se çfarë kam dëgjuar kur unë kam ardhur tek i treti, që kemi filluar punë: kanë qenë as më shumë, as më pak këto problematika, të cilat kishin bërë shpërnguljen nga dy të parat dhe përsëri tek i treti na doli një problem i tillë, por në një pjesë, jo në të gjithën. Siç shpjegova dhe më përpara, këto janë fenomene që inxhinieria i njeh, të thëna nga inxhinierët, sepse unë nuk jam inxhinier.

Jorida Tabaku – Zoti Myrtezani, ju pyesim ju për arsyen pse është bërë me kërkesë të kompanisë ndryshimi i vendit. Kompania kur ka aplikuar për kontratën koncesionare ka bërë një studim fizibiliteti dhe ka zgjedhur vetë ajo tokën. Kjo është arsyeja se përse po pyesim, sepse gjatë kësaj periudhe vendi ka ndryshuar tre herë. Mund ta njoh ekspertët mund të mos e njohin, prandaj bëhen studimet e fizibilitetit me idenë që aty ku investohet të investohet tamam, pastaj vendimin se ku është zgjedhur prona nga publike në private i takon ta thotë kryetari i bashkisë kur të vijë këtu, siç e shpjegoi edhe zonja Çupi, kur kishte alternativa të tjera.

(Diskutime pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Në tetor të vitit 2016, i cili përkonte me momentin kur ju thatë se kishit filluar punë si administrator, është pikërisht data e lidhjes së kontratës së koncesionarit me autoritetin publik. Në këto momente ju nuk e keni pasur në kontratë të përcaktuar destinacionin e tretë, por në kontratë keni pasur të shënuar vendin, madje fshatin e parë të komunës së Portës.

Arenc Myrtezani – Kjo nuk më kujtohet, por ajo që kujtoj është pjesa...

Problematika që doli aty ishte e tillë, siç gënjejnë të gjithë, sepse studimin nuk e bëjmë ne e bën kompania tjetër dhe përfundimi i të gjithë historisë për të mos e zgjatur është që na kishin gënjyer ose nuk kishin ditur t'i bënin, kështu që u mor dikush tjetër për ta bërë më mirë studimin e fizibilitetit. Kjo është diçka që në ndërtim, të paktën me atë që më kanë thënë specialistët, ndodh.

Jorida Tabaku – Edhe ne po ngrejmë të njëjtin shqetësim, por kur të vijë administratori këtu i kompanisë do ta pyesin në detaje për studimin aktual të fizibilitetit.

Në dijeninë tuaj sa është vlera e kredisë e marrë nga kompania koncesionare?

Arenc Myrtezani – Nëse nuk gabo, ishte diku te 2 milionë.

Jorida Tabaku – Në dijeninë time janë marrë 2 kredi.

Kompania Energy 2 s.r.l., jua përmenda edhe pak më parë, ishte ortak i shoqërisë koncesionare Integrated Technology Waste e shiti kuotën e tij te Ndërtim-Montim Patosi, e cila është një kompani që kishte një bilanc shumë modest, 900 mijë lekë të reja dhe nuk kishte kapacitetet për t'i kryer punimet dhe për ta zbatuar këtë kontratë koncesionare, por njëkohësisht nuk kishte asnjë eksperiencë në këtë fushë. Ndërkohë që menjëherë vitin pasardhës fitimet e kompanisë u rritën pothuajse 10 herë më shumë, sipas bilanceve që ne kemi analizuar. Në gjykimin tuaj, pse u mor ky vendim për shitjen e kuotave të kompanisë?

Arenc Myrtezani – Unë nuk jam në gjendje ta gjykoj këtë, sepse të gjitha janë procese që kanë ndodhur jashtë dijenisë sime i kanë bërë pronarët, por ajo që di, për shkak të njohjes personale

(zotëria nuk jeton më), zotëria merrej me ndërtim dhe kam përshtypjen që kjo do të ketë qenë lidhja që është bërë, sipas mendimit tim.

Jorida Tabaku – Më 10 nëntor të vitit 2016 kompania ka blerë impiantin e përpunimit të plehrave të prodhimit të energjisë në vlerën 15 milionë euro. A është e saktë kjo apo jo?

Arenc Myrtezani – Ka blerë? Besoj se duhet të jetë porosia, sepse kishte faza të ndryshme. Deri sa të shkonte te blerja, porosia kalonte në faza të ndryshme dhe më pas është edhe një fazë e ndërmjetme ku shkonte inxhinieri ynë që vërtetonte në vend ecurinë e projektit, siç vinin pjesë-pjesë, kolaudimin e prodhimit dhe e treta që ishte montimi në vend.

Për të tria këto besoj se kjo është shifra që shkon.

Jorida Tabaku – Po i referohem kontratës së vitit 2016, sepse kolegët tanë që ishin tek inceneratori i Fierit panë që pajisja ishte vendosur pak ditë më parë dhe nuk ishte kolauduar ende, por do të kolaudohej për 35 ditë. Ndërkohë që atje nuk ka pasur asgjë, ju vetë thatë se fizikisht godina nuk ekzistonte, u ndryshua 3 herë vendi dhe vetëm vitin e kaluar ka filluar ndërtimi fizik i godinës dhe më pas ka përfunduar.

Arenc Myrtezani - Realisht ka filluar më parë, por pjesa teknike në të cilën bën pjesë edhe kolaudimi (unë ju fola për kolaudimin, sepse kompanitë kishin një protokoll të vetin për çdo pjesë kryesore, pra ata kur bënin provat e tyre në Itali apo në Gjermani, thërrisnin një grup pune nga Shqipëria për të verifikuar në vend funksionin dhe më pas vinte pjesa e fundit për montim dhe kolaudim këtu në vend), me informacionet që unë kam, pothuajse është mbaruar puna në fazë kolaudimi, duhet të jetë, por nuk e kam informacionin.

Jorida Tabaku – Deputetët ishin atje javën e kaluar dhe pas 5 vjetësh blerje të kësaj pajisjeje prej 15 milionë eurosh duhen edhe 35 ditë të kolaudohet, ashtu siç edhe në prill kërkonte 35 ditë kolaudohej, por edhe në dhjetorin e vitit të shkuar donte po 35 ditë të kolaudohej.

Arenc Myrtezani – Për të qenë të sigurtë në këtë kohë pandemie të gjithë ceduan dhe nuk ceduan pak edhe kompanitë që ishin kontraktuar, kështu që këto që kanë ndodhur janë pasoja të...

Jorida Tabaku – Por vetëm pagesat e shtetit nuk kanë ceduar dhe kanë vazhduar.

Arenc Myrtezani – Edhe pagesat që janë bërë nga kompania janë të vërteta dhe kanë vajtur atje, por në shumë raste kanë ngelur peng i tyre dhe nuk ke se çfarë t'i bësh, sepse nuk është diçka që mund ta ndërrosh, pra një mall që mund të shkosh dhe ta blesh diku tjetër në një moment.

Jorida Tabaku – Nga problemi i funksionimit të inceneratorit të Fierit, kompania që ka koncesionin e inceneratorit të Fierit ka lëshuar fatura fiktive TVSH-je për një sërë kompanish, të cilat unë i kam këtu, kam një njoftim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sektorit të Hetimit Tatimor, i cili e ka konsideruar këtë si një krim financiar. Janë të paktën 20 kompani, ndër të cilat edhe inceneratori i Tiranës. A keni dijeni për këtë, pasi këto janë pagesa të ndodhura gjatë periudhës 2016, 2017 dhe 2018, pra 3 vjet me radhë?

Arenc Myrtezani – Nuk e dëgjova mirë, thatë inceneratori i Tiranës?

Jorida Tabaku – Kompania që ka koncesionin e inceneratorit të Fierit ka lëshuar një sërë faturash për punë fiktive të pakryera për TVSH-në, ku një ndër to është edhe kompania e inceneratorit të Tiranës Integrated Energy BV SPV, si dhe një sërë kompanish të tjera, të cilat nuk po i përmend këtu, disa janë biznese të njohura disa të panjohura, por nuk është objekt i këtij komisioni të përmendim të tjerët, përveç atyre që kanë abuzuar me fondet publike.

Kjo ka ndodhur në vitin 2016 dhe në vitin 2017 dhe këtë informacion e kam nga Drejtoria e Hetimit Tatimor. Të dy kompanitë, thuhet, se kanë shkëmbyer ndërmjet njëra-tjetër shërbime, por ndërkoh faktikisht kjo nuk ka ndodhur. Janë 20 kompani, për të cilat janë xhiruar fatura fiktive TVSH-je. A keni dijeni për këtë?

Arenc Myrtezani – Nuk kam dijeni, por për ta kuptuar më mirë për vete bëhet fjalë për ITS-në që e ka pasur, sepse nuk po e kuptoj se nga kush kompani janë prerë?

Jorida Tabaku – Kompania ITS që ka pasur...

Arenc Myrtezani – Po ITS-ja ka pasur rolin e zhvillimit për shkak të eksperiencës dhe të gjërave të tjera të inceneratorit të Fierit.

Jorida Tabaku – Po, të inceneratorit të Fierit dhe ka lëshuar fatura fiktive për një grup kompanish, 20 kompani, ku një ndër to është edhe kompania e inceneratorit të Tiranës Integrated Energy BV SPV.

Më parë pyeta edhe zonzjën që ishte administratore e kësaj kompanie për të njëjtën gjë, por asaj i duhej të merrte informacion ngaqë nuk kishte. Po ju pyes edhe ju, pasi është e njëjta periudhë ku ju keni administruar shoqërinë koncesionare.

Arenc Myrtezani – Nuk më kujtohet të kem dijeni për këto.

Jorida Tabaku – Në fakt, ky është një hetim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Policinë e Shtetit. Arsyeja është se kompania, duke qenë se nuk ofronte shërbime, nuk dinte si t'i xhironte pagesat dhe siç duket ka bërë një grup faturash fiktive. Në dijeninë tuaj, a ka pasur

ndonjëherë penaltete për kompaninë koncesionare që menaxhonte koncesionin e inceneratorit të Fierit?

Arenc Myrtezani – Për sa kohë kam qenë unë nuk ka pasur, sepse nuk kishte arsye pse të penalizohej, pra nuk ka pasur penaltete.

Jorida Tabaku – Nuk është zbatuar kontrata, prandaj ka probleme në zbatimin e kontratës me grafikun e punimeve për shkaqe madhore, por edhe për shkaqe jo madhore. Shkaqet madhore lidhen me shpronësimin, por ka edhe shkaqe jomadhore për të cilat kanë krijuar vonesa në zbatimin e grafikut të punimeve.

Arenc Myrtezani – Për një gjë jam i sigurt dhe ju garantoj se në periudhën që unë kam filluar, bëhet fjalë për një tokë arë, edhe unë e kam gjetur tokë arë me protestat e banorëve dhe aty ka filluar historia. Kam përshtypjen që pyetja ka të bëjë me një periudhë tjetër.

Jorida Tabaku – Në total ju pyeta për të gjithë kohën e zbatimit.

Arenc Myrtezani – Nuk kam informacion.

Jorida Tabaku – Unë kam këtu një raport të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka nisur hetimin për fondet publike për inceneratorin e Fierit dhe nga auditimi ka nxjerrë disa të dhëna shumë interesante, ndër të cilat është edhe çështja e lejeve mjedisore. Arsyeja se pse kompania e zotit Klodian Zoto, Mirel Mërtiri e me radhë e kanë marrë këtë koncesion është se është kualifikuar edhe për ofertën mjedisore që ka bërë, por njëkohësisht edhe për studimin e fizibilitetit që ka bërë, ndërkohë që këto bien poshtë të dyja, edhe studimi i fizibilitetit, edhe oferta mjedisore, sepse prona u ndryshua 3 herë. Ky është dëmi kryesor që është shkaktuar, sepse u është dhënë një kontratë e padrejtë këtyre zotërinjve.

Në dijeninë tuaj, meqenëse kishit njohje me zotërinjtë edhe më parë, a ka pasur një eksperiencë kompania në fushën e incenerimit, të menaxhimit të mbetjeve, pra në fusha të tilla të ngjashme?

Arenc Myrtezani - Emrat që më thatë, janë tri kompani të ndryshme, sepse Zoton e di që është pronari ITS-së dhe aksioneri aty; Mërtiri nuk e di ku hyn te kjo; Stela ka qenë...

Jorida Tabaku – Te Fieri hyn si kontraktor dhe nënkontraktor. Zonja Stela Gugallja hyn si kompani auditimi. Po i lidhim të tre bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëria tha kam njohje. “Ne filluam që para se të merrnim kontratën” – tha.

Zotëria tha: “Ne filluam punë që para se të merrnim kontratën” dhe unë ndaj mora shkas.

Arenc Myrtezani – Më falni, që ju ndërpres!

Unë kam qenë në punë me ITS-në, me Zoton, dhe kam përshtypjen që e thashë.

Jorida Tabaku – Ka pyetje nga kolegët e tjerë?

Zoti Spaho.

Edmond Spaho – Kam dy pyetje. Te studimi i fizibilitetit janë përcaktuar kostot për të gjithë zërat e punës, duke filluar nga puna përgatitore, shpenzimet kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet për mirëmbajtje e të tjera.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të pagesave rezulton se është paguar firma e Klodian Zotos dhe partneres së tij Stela Gugallja, për një sasi prej 64 milionë lekësh. Keni dijeni ku ka ndodhur kjo, gjatë periudhës që keni qenë ju, apo i takon një periudhe tjetër kohore?

Kompania e Klodian Zotos është krijuar në fund të shtatorit të vitit 2017, në mos gaboj.

Arenc Myrtezani – Kompania që po flasim është krijuar në shtator “Zoto Consulting” sh.p.k.

Nuk po e kuptoj, po flasim për kompaninë me të cilën ITS-ja ka një kontratë me kompaninë në Fier, se janë të ndryshme, për zhvillimin e projektit si kompani me eksperiencë më të madhe.

Ndërsa, lidhur me këtë tjetrën, nëse e kuptova drejt, nuk e kujtoj. Në kohën që kam qenë unë, jo.

Edmond Spaho – Emërtimet e kompanive krijojnë pak konfuzion. “Zoto Consulting” sh.p.k. ka marrë nga Integrated Technology Waste Treatment Fier, 64,4 milionë lekë të rinj, për punime që i ka bërë për kompaninë mëmë. Kjo kompani “Zoto Consulting” sh.p.k. është krijuar më 14.09.2017 dhe 90% e aksioneve i takojnë Zotos. “Consulting SE Partner’s” i takon Stela Gugalljas. Njëri ka marrë 27,6 milionë, tjetri 36,8 milionë. Në total 64,4 milionë.

Keni njohuri, a është e periudhës kur keni drejtuar ju, apo është e ndonjë periudhe tjetër?

Arenc Myrtezani – Ndjesë!

Për ta fiksuar edhe një herë, për cilën datë bëhet fjalë?

Edmond Spaho – Bëhet fjalë për pas shtatorit 2017. Pagesat supozohet që janë bërë pas shtatorit të vitit 2017, sepse kjo është krijuar si kompani në gjysmën e shtatorit.

Arenc Myrtezani – Nuk e kujtoj me saktësi, por besoj se për shkak të kontratës së lidhur ndërmjet dy kompanive duhet të jenë pagesa të brendshme të bëra për Zoton për punimet e kryera. Janë detyrime që kanë lindur nga marrëdhënia kontraktuale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë përgjigje dhashë, por për shkak të njohjeve që kemi, e ndjeva detyrim që të sqaroja diçka më tepër.

Edmond Spaho – Dëshiroj të pyes zotin Myrtezani, sepse kur të vijë administratori tjetër, do të bëj të njëjtën pyetje për të dhe nuk dua të më thotë: “Janë të periudhave para meje. Nuk i kam kryer unë, por i ka kryer zoti Myrtezani”.

Dëshiroj të informohem, meqenëse është këtu, pasi unë vetë i thashë se kjo kompani është krijuar më 14 shtator 2017. Për aq periudhë sa ka qenë prezent zoti Myrtezani, a ka dijeni për këto dy pagesa? Ka qenë ai autorizuesi, apo pritësi i parave? Zoti Myrtezani po më thotë se nuk ka dijeni, apo jo.

Së dyti, janë disa kompani (mund t’jua jap edhe me emra), të cilat kanë pasur marrëdhënie pune me Integrated Technology Waste Treatment Fier, si: “Best Service” sh.p.k., “General Service” sh.p.k., “TGroup”, “Leli 17” sh.p.k., “Pupa Service” sh.p.k., të cilat rezultojnë se janë kompani pa mjete, me nga dy punonjës, por që kanë pasur marrëdhënie juridike, marrëdhënie pune, marrëdhënie financiare me Integrated Technology Waste Treatment Fier. Keni dijeni çfarë llojesh marrëdhëniesh kanë pasur, për çfarë janë paguar, çfarë punësh kanë kryer këto kompani që përmenda gjatë periudhës që keni qenë ju?

Arenc Myrtezani – Nuk më kujtohet asnjë nga këto emra! Nuk njoh asnjërin prej tyre dhe nuk di të kem pasur kontakte me këta njerëz!

Arben Pëllumbi - Faleminderit!

Zoti Myrtezani, ju na thatë se keni filluar punë në tetor të vitit 2016 deri në shtator të vitit 2017. Kryesisht, nëse unë e kuptova mirë, ka të bëjë me sistemimet e terrenit. Gjatë kësaj periudhe, a kanë filluar të vijnë në këtë venddepozitim mbetjet e zonës? E keni arritur këtë periudhë kur kanë filluar të vijnë mbetjet e para në zonë?

Arenc Myrtezani – Jo, nuk kanë filluar të vijnë derisa kam qenë unë aty.

Arben Pëllumbi - Po ndërkohë që shkonit dhe punonit në Fier për gati një vit përditë, ua zinte syri tymin që dilte buzë Fierit nga mbetjet që digjeshin aty?

Arenc Myrtezani – Në fakt, nuk do të doja...

Helidon Bushati - Nuk është pyetje në cilësinë e administratorit. Ne do të **fokusohemi** te përcaktimi ligjor që ka administratori. Administratori i një kompanie shkon në vendin e punës pa parë anash. Nuk është i detyruar të shohë anash.

Ermonela Felaj – Tani, komentet e deputetëve...

Helidon Bushati – Po i kërkoni një përgjigje që nuk ka lidhje me funksionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Deri tani bëtë komente...

Helidon Bushati – Bëri një pyetje që nuk ka lidhje me komisionin.

Arben Pëllumbi – Po e moderoj pyetjen, sepse zoti Bushati ka të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Atë pyetje mund t’ia bëni kryetarit të Bashkisë Fier. Do t’ia bëjmë, pa problem.

Arben Pëllumbi – Në mbledhjet e punës të bordit që bënit ndërsa punonit aty në zonë, e keni trajtuar ndonjëherë temën e tymit që digjej në Fier, pranë qytetit, dhe ndotjen e ajrit, apo nuk e keni bërë këtë bisedë ndonjëherë?

Arenc Myrtezani – Në dijeninë time, kjo ka qenë një temë që shumë kohë para se të shkoja unë, por edhe në kohën kur kemi qenë ne, kanë qenë ato probleme që i dinë të gjithë.

Nuk kemi çfarë t’i shtojmë më kësaj historie, se kjo pastaj do të hyjë te politika dhe ju do të filloni të bëni ato...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Bushati...

Arben Pëllumbi – Ja, të mbaroj.

Në këtë gati 1 vit që ju keni qenë në drejtim të kompanisë, sa kohë vonesë ju kanë shkaktuar çështje, të cilat nuk kanë lidhje me ndërhyrjet e shtetit? Pra, çështje të tjera anësore, të cilat ju kanë vonuar apo nuk keni pasur të tilla gjatë periudhës kur keni qenë ju?

Arenc Myrtezani – E vërteta është që nuk besoj se të gjitha vonesat apo shkaktarët e vonesave janë pasqyruar, sepse ishin nga më të ndryshmit, nga më të shumtët. Ishim të detyruar, domethënë, të merreshim edhe me dy njerëz apo me tre njerëz të cilët protestonin, kishte edhe të çmendur, kishte nga të gjitha llojet e njerëzve. Problematikat kanë qenë jo të vogla.

Këta kanë qenë, po themi, të gjithë shkaktarët e vonesave, veç të parit që është historiku për të ikur sa në një vend në një tjetër, për problematikat qoftë të terrenit, qoftë të njerëzve të cilët prekeshin nga këto.

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Helidon Bushati – Zoti Myrtezani, po e fillojmë tek “tymi” i zotit Pëllumbi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...gjatë një viti, pak a shumë një viti që ju keni qenë administratori i kompanisë, a janë bërë pagesa konform kontratës nga ana e shtetit?

Arenc Myrtezani – Në kujtesën time, pagesat duhet të jenë bërë, sepse vetë kontrata ishte e lidhur me një pasqyrë financiare, në mos gaboj. Dhe, siç shteti kërkon, se nuk e di sa...

Helidon Bushati – Për pjesën e kontratës mbani ju përgjegjësi...

Arenc Myrtezani – Jo.

Helidon Bushati – Ju mbani përgjegjësi për pjesën kur keni qenë ju, të zbatimit të kontratës, se keni qenë administrator.

Arenc Myrtezani – Ju lutem, se unë kam eksperiencë edhe në shtet, edhe në privat. Kur je në shtet, është pak komoditet të bësh gjyqin e privatit...

Helidon Bushati – Jo, jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, m'u përgjigj vetëm këtyre. Domethënë...

Arenc Myrtezani – Privati...

Helidon Bushati – ...konform kontratës keni marrë pagesa...

Arenc Myrtezani – ...bie në një mes që...

Helidon Bushati – ...që të mos e zgjasim.

Arenc Myrtezani – Në rregull. Më falni!

Helidon Bushati – Pyes: keni marrë pagesa dhe gjatë vitit kur keni qenë ju, a është shuar tymi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, megjithëse janë marrë pagesat, a është shuar tymi?

Arenc Myrtezani – Pyetja më duket pak humor Shkodre, por e mirëpres, se e pëlqej...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Çfarë humori, more?! Fare humor!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arenc Myrtezani – ...sinqerisht.

Helidon Bushati – Jo, me sinqeritet jemi të gjithë, se jemi para një komisioni...

Arenc Myrtezani – Sinqerisht, madje unë edhe jam betuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pyetje e ka përgjigjen vetë. Çfarë mund të bëj për një vit? Tymin e krijuar për 30 vjet ose 40 vjet, a ku di unë, nuk mund ta shuaj, se nuk jam Zoti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – ...këtë kisha hall, domethënë, sepse po dilte sikur sapo erdhët ju, sapo u nënshkrua kontrata, pushoi tymi në Fier. E kupton? Megjithëse keni marrë disa milionë euro, jo ju, por kompania, tymi ka vazhduar përsëri.

Po kaloj te një pyetje tjetër. Në fillim të deklaratës suaj, thatë: “Kemi pasur pak probleme me banorët”, dhe kështu ishte specifikisht, është e shkruar edhe në protokoll. Sa kanë zgjatur këto? Sa kanë influencuar këto në afate kohore në ndalimin apo në ngadalësimin e punimeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arenc Myrtezani – Për afat nuk di të të them.

Helidon Bushati – Pak a shumë, nuk ka problem.

Arenc Myrtezani – Pak a shumë, ndoshta nuk gabo, le të themi 60 ditë, po.

Helidon Bushati – Në rregull, 60 ditë. Ka pasur vonesa, sepse, sikur të mos kishte pasur vonesa, do të kishte qenë i kryer, apo jo? Atëherë, vonesat, në qoftë se nuk kanë ardhur nga protestat e banorëve, nga se kanë ardhur?

Arenc Myrtezani – Kjo është përgjigje për tërësinë e projektit deri në këtë ditë?

Helidon Bushati – Jo, jo, padyshim, vetëm për kohën kur keni qenë ju. Kur të vijë administratori tjetër, do ta pyesim për pjesën tjetër.

Vetëm gjatë kohës kur keni qenë ju, po pyes.

Arenc Myrtezani – Gjatë kohës kur kemi qenë ne, në çdo kantier fillimi i punimeve ka vonesa dhe janë gjërat më të zakonshme që ndodhin, por këto fitohen në kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se unë e kuptoj drejt pyetjen ose përfundimin e saj, situata është e tillë. Duam apo nuk duam, domethënë pavarësisht se si duam ta interpretojmë, pjesa thelbësore e vonesave në këtë projekt, në dijeninë time, edhe pasi unë nuk kam qenë më administrator...

Helidon Bushati – Më mirë mos e ço ashtu, sepse mund të thuash ndonjë gjë që nuk duhet thënë. Ne po fokusohemi te pjesa juaj. Më mirë fokusoheni aty, se mund të kalosh në një pjesë tjetër dhe unë, siç thatë ju, si shkodran që jam, jam i gatshëm të bëj edhe pyetje që mund t’ju vënë në vështirësi...

Arenc Myrtezani – E mirëpres, por...

Helidon Bushati – Më mirë e lëmë deri këtu.

Arenc Myrtezani – Në rregull, e lëmë deri këtu.

Helidon Bushati – Atëherë, ka ndodhur diçka tek inceneratori i Fierit.

Kompania, e cila ka *know how*-un, pra njohuritë për të bërë një incenerim, u largua ditën e dytë, domethënë u nënshkrua kontrata dhe u largua. A keni pasur ju vështirësi në fillimet tuaja nga mungesa e ekspertizës të të dyja kompanive, që ishin pastaj bashkimi i kompanive? E kupton? Iku ajo që kishte eksperiencë. A ju ka shkaktuar juve si administrator vonesa fakti që të dyja kompanitë, që ishin koncesionare tashmë, nuk kishin ekspertizë në këtë fushë?

Arenc Myrtezani – Nuk besoj që ka qenë kjo për shkak të eksperiencave të fundit... Janë dy gjëra të ndryshme.

Në qoftë se flasim për landfillin, kompania e kontraktuar ishte me goxha eksperiencë. Domethënë, referencat që merreshin nga kjo kompani në Itali, nuk më kujtohet emri tani i saj, por ishte, po themi, lider në Itali për landfillet, sepse janë procese të ndryshme dhe nga kompani të ndryshme.

Edhe inceneratori në vetvete është, le të themi, as më shumë, as më pak si një makinë që ne përdorim përditë, qoftë një Mercedes: pjesët brenda tij janë nga shumë kompani në botë dhe bëhet asamblimi i tyre për të krijuar këtë.

E njëjta gjë, po themi, ndodh edhe me inceneratorin: bëhet asamblimi dhe pastaj është një kompani e tretë ose një kompani e autorizuar nga prodhuesit për të bërë kolaudimin në terren, në përfundim.

Helidon Bushati – Po të bëj një pyetje tjetër: koncesionari, në vizionin e tij, po edhe në planin e biznesit, nga se do t'i nxirrte lekët? Nga do ta nxirrte fitimin?

Arenc Myrtezani – Nga do ta nxirrte fitimin pronari?

Helidon Bushati – Koncesionari, koncesioni, sepse asnjë biznes nuk merr një koncesion për të dalë zero-zero ose për të dalë me humbje, apo jo?

Arenc Myrtezani – Në rregull.

Me aq pak informacion sa kam për bërjen e një plani biznesi, ky i fundit bëhet në tërësi, jo në...

Helidon Bushati – Të lutem..

Arenc Myrtezani – Nuk po mundohem të xhiroj.

Helidon Bushati – Jo, ju keni qenë administrator vetëm një vit dhe ka përkuar me fillimin e punimeve. Padyshim që e keni idenë, po bëni...

Është një aktivitet ekonomik dhe ju e dini se nga vjen fitimi. Nga është fitimi, domethënë, është nga depozitimi, është nga riciklimi, është nga djegia, është duke prodhuar energji, duke shitur energji? Nga se? Apo nga të tria bashkë?

Këtë duhet të ma thoni ju, se unë nuk e di.

Arenc Myrtezani - Këtë po mundohesha të sqaroja. Kur bëhet një plan-biznesi, bëhet në tërësinë e gjërave që ky biznes ka brenda, që nga kryerja e punimeve, ndërtimi, operimi, të cilat në fund fare do të prodhojnë një benefit, sepse nuk punon njeri falas, për të cilin kompania shpërblehet.

Nuk e kuptova drejt?

Helidon Bushati – Jo, nuk e keni kuptuar drejt, sepse ndërtimi ka kosto, nuk ka fitim. Fitimi nxirret nga ajo që ndërtohet dhe që më pas prodhon diçka. Pra, nga se përbëhet fitimi i koncesionit? Është shumë e thjeshtë. Nga ndërtimi nuk vjen, sepse ndërtimi është kosto.

Arenc Myrtezani - Të gjitha këto, ndërtimi, operimi, në fund fare prodhojnë fitimin. Nuk isha i qartë?

Helidon Bushati – Të lutem! Padyshim që kompania nxjerr fitim, por ky fitim vjen nga lekët që vijnë për shkak të depozitimit apo nga shitja e energjisë elektrike?

Arenc Myrtezani - Të gjitha proceset që ndodhin në landfill, në përfundim të tyre ...

Ju folët me të drejtë për ndërtimin, sepse është normale, por unë nuk mendova se duhet ta thosha këtë te ndërtimi. Përderisa kam marrë përsipër ta zhvilloj, nga tokë arë të ndërtohet insineratori, ka shpenzimet e veta, por plan-biznesi bëhet me një përfundim dhe përfundimi i një kompanie private duhet të jetë fitimi.

Helidon Bushati – Atë e thashë edhe unë.

Arenc Myrtezani - Edhe unë këtë po mundohem të sqaroj.

Helidon Bushati – Ka një problem të vogël, prandaj, ju lutem, më ndiqni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj, por mund të jetë shumë interesante edhe për ju, për t'ju zgjeruar vizionin për fitimet dhe humbjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, nuk ju kam ndërhyrë ndonjëherë! Jam po aq ekspert sa ju që keni ministre e Financave!

Të lutem, mos më ndërhy, sepse jam shumë i qartë në pyetjet që bëj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, sepse është pikërisht ajo që ka lidhje. Sikur të ishit ju atje, do ju bëja pyetje të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fitimi vinte nga depozitimet dhe shitja e energjisë elektrike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Nuk mund të rrimë tri orë për kuriozitetet e zotit Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Interesi publik është të bëhen pyetje në lidhje me fokusin e hetimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, në një orë veprimtari duhet të ezaurojmë edhe pyetjet tona. Është respekt ndaj parlamentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Kam edhe një pyetje të fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk mora përgjigje nga çfarë përbëhet fitimi i kompanisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arenc Myrtezani - Në dijeninë time, po jua them për të disatën herë, janë këto elemente që në fund fare do të prodhonin fitim. Nuk di ta them të detajuar apo siç ju e doni. E kuptoj që doni një përgjigje, por nuk di ta them ndryshe.

Helidon Bushati – Nga shitja e energjisë do të prodhoheshin të ardhura?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa ka kushtuar pajisja e insinerimit?

Arenc Myrtezani - Nëse nuk gabo, rreth 15. Mund të sqaroj?

Helidon Bushati – Jep një shifër.

Arenc Myrtezani - Ishin dy pyetje, prandaj. Njëra pyetje ishte për prodhimin e energjisë, kurse tjetra ishte për insinerimin. Janë dy gjëra që shoqërojnë njëra-tjetrën, janë të lidhura, por të

ndryshme. Insinerimi ka një kosto goxha të lartë, kurse prodhimi i energjisë me ndihmën e insinerimit nuk është ndonjë kosto kush e di se çfarë.

Helidon Bushati – Pjesë e fitimit është shitja e energjisë elektrike dhe ju në momentin që do të ndërtohet dhe kolaudohet do ta dorëzoni. Kjo nuk ka sens ekonomik. As vetë zonja Denaj, që ka qenë ministre e Financave, nuk arrin ta perceptojë se si diçka që ndikon te fitimi, të paktën në gjysmën e saj, ju duhet ta dorëzoni në momentin që do të fillojë të prodhojë fitim. Këtu është thelbi i problemit. Zonja Denaj e kupton shumë mirë ku është sensi, por do ia nxjerrim deri në fund sensin. Nuk ka lidhje me ju kjo gjë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mos ndërhyjni më.

Fadil Nasufi – Po detyrohem të bëj një koment për atë që thatë ju. Aty nuk është ndërtuar as hidrocentral, as termocentral, por bëhet përpunimi i mbetjeve, dhe, midis të tjerave, ky riciklim ka mbetjet selektive, prodhon energji, prodhon kompostim, bëhet kapsulimi i zonave të patretshme e kështu me radhë. Të mos bëjmë teknologji kimike dhe të mësojmë si punojmë skemat e stabilimenteve dhe të uzinave.

Zoti Myrtezani, ju filluat një punë të re si administrator, por nuk kishit eksperiencë në këtë fushë. Patë gjekundi në vendet e rajonit ose diku tjetër një model insineratori si funksiononte dhe si menaxhohej?

Arenc Myrtezani - Aq sa na lejuan, kam parë insineratorin e Vjenës që është në qendër të qytetit dhe punonjësit atje na shpjeguan si ishte ndërtuar skema e funksionit të insinerimit.

Fadil Nasufi – Keni dijeni çfarë ndodhi me fushën e vjetër të depozitimit disavjeçar të plehrave në Fier, si u trajtua ajo?

Arenc Myrtezani – Nuk kam dijeni çfarë ka ndodhur me atë. Nëse pyetja është për fushën e mbetjeve që mori flakë, e kam parë në televizion që mori flakë dhe më pas u kapsulua.

Fadil Nasufi – Në gjykimin tuaj, përpos gjithë interesimit që ne bëjmë si komision parlamentar, si e vlerësoni impaktin publik të këtyre investimeve që janë bërë me kontratë koncesionare? Çfarë dëmi publik është bërë?

Arenc Myrtezani – Në bindjen time vetëm dëm publik nuk ka, përjashtoj pjesën financiare, që është diskutim i politikës. Unë nuk jam financier të hyj në këto diskutime. Impakti në publik

është vetëm për mirë, sepse, përderisa jemi të mbytur me plehra dhe mbeturina, ky vend duhet të pastrohet, që të mos na vijë turp kur vijmë miq të huaj për vizitë në vendin tonë.

Fadil Nasufi – Faleminderit!

Edmond Spaho – Për të saktësuar diçka nga dy pyetjet e para që bëra, në raportin e “Integrated Technology Waste Treatment” me “Zoto Consulting sh.p.k.”, për punën që kjo e dyta si nënkontraktore ka bërë për të parën, kush i lidhte marrëdhëniet kontraktore, kush i firmoste kontratat për punën që do të bëhej gjatë vitit 2017 dhe pagesat që do të merrte kjo më vonë, dhe më saktësisht për këto dy pagesa që kanë marrë, rreth 30 milionë lekë dhe 27 milionë lekë, që në total bëjnë 64,4 milionë?

Arenc Myrtezani - Siç e thashë edhe më përpara, unë kujtoj që është lidhur një kontratë me Zoton për zhvillimin e këtij projekti, dhe këto duhet të jenë rrjedhojë, sepse unë nuk mund t’i kujtoj tani, se edhe vitet bëjnë të vetën. Domethënë, një ose dy pagesa. Mbase po të duhet një përgjigje më e saktë, do të shikoj dokumentacionin dhe mund t’ju jap një përgjigje më të saktë. Po në kujtesën time, besoj, jam i bindur që do të jenë lidhur ndërmjet dy kompanive.

Edmod Spaho – Domethënë, thelbi i pyetjes ime është: kush e trajtonte pjesën e lidhjeve të kontratave me nënkrotaktorët në Integrated Technology Waste Treatment? Më pas, kush i autorizonte pagesat? Pagesa e parë është bërë në nëntor të vitit 2017, kur ju nuk keni qenë aty, por unë dua të di më saktë: kush merrej me lidhjen e marrëdhënies juridike për grumbullimin e punimeve që do të kryheshin dhe më pas kush e autorizonte pagesën? Siç ka ndodhur me pagesën e parë që e kanë marrë në nëntor të vitit 2017.

Arenc Myrtezani - Për të dhënë një përgjigje më të saktë duhet të shikoj kontratën në letër ndërmjet dy kompanive dhe detyrimet që kanë për shkak të kontratës, personat që do të nënshkruajnë apo do të autorizojnë pagesat. Kjo ishte pyetja, me çfarë kuptova?

Edmod Spaho – Ekzaktësisht këtë dua të di. Tek Integrated Technology Waste Treatment, cilat kanë qenë trupat e autorizuar, qoftë për të lidhur këtë lloj marrëdhënie pune si nënkontraktor, qoftë për të autorizuar pagesat? Domethënë, kush i mbulonte këto në Integrated Technology Waste Treatment?

Arenc Myrtezani – Me lejen tuaj dua të rishikoj dokumentet, sepse është një gjë për të cilën nuk të jap dot përgjigje tani.

Edmod Spaho – Besoj se kjo vlen edhe për raportet, për ato kompani që unë përmenda, por që ju thatë se nuk i keni dëgjuar. Nuk po i kthehem edhe një herë. Domethënë, ato kompani që

nuk kishin mjete pune, rezulton edhe sot që nuk kanë mjete pune, kanë pasur vetëm një apo dy punëtorë, por kanë faturuar Integrated Technology Waste Treatment për pagesat edhe për rimbursimin e TVSH-së.

Arenc Myrtezani – Edhe një herë, për pagesat dhe faturat për të cilat po flasim kam përshtypjen që i referohen një kohe më mbrapa, në qoftë se nuk gaboj dhe nuk di se çfarë mund të them për këtë gjë.

Jorida Tabaku – Edhe unë kam dy pyetje të fundit dhe do të përfundojmë. Ju deklaruat që keni qenë punonjës i kompanisë ITS që më përpara dhe kishit njohje. Zonjën Sevi Zani e njihni, ka qenë punonjëse e kësaj kompanie?

Arenc Myrtezani – Po.

Jorida Tabaku – Ka qenë eksperte juriste e kësaj kompanie e kompanisë ITS?

Arenc Myrtezani – Nuk më ka lidhur shumë puna me të, por e njoh.

Jorida Tabaku – Po, ka qenë punonjëse.

Arenc Myrtezani – Po.

Jorida Tabaku – A jeni në dijeni që zonja Sevi Zani, ka krijuar ndërkohë që ishte pjesë e kompanisë ITS kompaninë BCGE dhe me këtë kompani ka bërë një ofertë të pa kërkuar për inceneratorin e Fierit dhe ndërkohë që bëri ofertën e pa kërkuar dhe ishte e punësuar nga Klodian Zoto, mori bonusin nga Ministria e Mjedisit dhe më pas aksionet e saj i bleu Klodian Zoto?

Arenc Myrtezani – Jo, nuk kam asnjë dijeni.

Jorida Tabaku – S'keni dijeni?

Arenc Myrtezani – Jo, është hera e parë që e dëgjoj.

Jorida Tabaku – Në rregull.

I shiti për 25 milionë lekë aksionet e saj. Pra, arrijmë në konkluzionin që zonja Sevi Zani, punonjëse e ITS-së ka krijuar një kompani, po e Klodian Zotos, thjesht për të aplikuar për procedurën e tenderit. Ky ishte qëllimi im.

Më thonë që zonja Sevi Zani ndodhet në Zimbabve, siç duket atje Klodian Zoto ka shtrirë aktivitetin.

Ju keni ndonjë marrëdhënie pune me kompaninë tek Integrated Technology Waste Treatment Fier?

Arenc Myrtezani – Unë jam aktualisht në punë.

Jorida Tabaku – Punoni atje aktualisht, në pozicionin drejtor?

Arenc Myrtezani – Për kompaninë, po.

Jorida Tabaku – Besoj se për të gjitha këto informacione që ne ju pyetëm, ju i keni edhe në pozicionin e drejtorit, apo jo? Nga lista e pagave që unë kam marrë, ju jeni paguar me një pagë shumë të lartë deri në muajin janar, pastaj në prill ju ka rënë paga me 3 herë. Çfarë ka ndodhur nga janari në prill?

Ne të gjithë këtu krijuam përshtypjen sikur ju keni punuar një vit dhe tani s'jeni më në punë, se po flisni si dikush i jashtëm.

Arenc Myrtezani – Jo, nuk kam folur ndonjëherë si i jashtëm. Unë u mundova gjithë kohën të sqaroj sa më shumë të mundesha me informacionet që kam unë.

Jorida Tabaku – Tani është në pozicionin e drejtorit Antoneta.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon nga deputetja Antoneta Dhima.)

Njësoj është pra.

Prit, mos e mbro, lëre të flasë.

Arenc Myrtezani – Kjo historia e drejtorit më kujton ata sulmuesit në kohën e xhaxhit Enver, se është thjesht një titull.

Jorida Tabaku – Po pak rëndësi ka.

Çfarë funksioni kryeni sot?

Arenc Myrtezani – Atëherë, funksioni im gjatë kësaj kohe ka të bëjë me doganat, me zhdoganimin për mallrat që vijnë apo me nevojat e kantierit, bëj një suport teknik, se nuk di çfarë emri t'i vë, se “drejtor” nuk më vjen mirë, nuk jam mësuar.

Jorida Tabaku – Nuk dua ta them këtu sesa është paga juaj, por paga juaj me personin poshtë jush është 5 herë më e lartë. Kështu që, ky suport teknik nuk është edhe aq teknik. Jeni personi më i lartë vendimmarrës në këtë kompani.

Arenc Myrtezani – Në vlerësimin tim paga ime është e ulët. Po është vlerësimi im me pronarët.

Jorida Tabaku – Ngelëm të gjithë pa fjalë, por unë e kisha ruajtur për në fund këtë pyetje.

Zotëri, kur ka qenë kontakti juaj i fundit me Klodian Zoton, Mirel Mërtirin dhe Stela Gugalljan? A keni kontaktuar kohët e fundit me ta?

Arenc Myrtezani – Mbi një vit. Siç e thashë edhe në fillim, kam mbi një vit që kam pasur kontakt fizik, pastaj për punë në telefon kemi folur, por jo më pak se një vit që nuk kam..

Jorida Tabaku – Unë gjykoj se edhe në pozicionin e drejtorit ju mund t’u ishit përgjigjur të gjitha pyetjeve që ne kishim sot këtu. Është një informacion që ju e kishit dhe të gjithë deputetët e komisionit ju trajtuan sikur ju kishit qenë vetëm një vit i punësuar, sikur nuk keni asnjë dijeni se çfarë po ndodh. Në kompani nuk shkoni dot, thatë në fillim të dëshmisë suaj, prej largësisë fizike, ndërkohë që ju jeni i punësuar që nga dita e hapjes deri më sot, kështu që nuk jeni kaq i jashtëm.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon nga deputetja Antoneta Dhima.)

Antoneta, nuk kam nevojë për interpretues.

Pak rëndësi ka, ju jeni funksionari më i lartë i kompanisë. Kam listën e pagave dhe zotëria këtu është funksionari më i lartë i kompanisë. Ai që vjen nesër në komision, zoti Roland Dusha, është poshtë zotërisë.

Arenc Myrtezani – Si është poshtë?

Jorida Tabaku – Me pagë dhe me funksion.

(Debat pa mikrofon në sallë.)

Jo, nuk iu përgjigj pyetjeve, se zotëria tha: jam larguar në shtator të vitit 2017.

Arenc Myrtezani – Ju lutem, zonja Tabaku, në media kam parë që paga ime ishte 13 milionë lekë, në qoftë se po flasim për ato dokumente...

Për çfarë page bëhet fjalë? Bëje publike, se nuk kam gjë për të fshehur.

(Kryetarja e komisionit, deputetja Jorida Tabaku flet pa mikrofon.)

Atëherë, më jepni lekët se m’i kanë vjedhur

Jorida Tabaku – Të t’i japë Klodian Zoto, se kjo është lista e Drejtorisë së Tatimeve. Kaq deklaroi Klodian Zoto për ty atje.

Arenc Myrtezani – Ju lutem, të dyja palëve, më gjeni lekët, se m’i kanë vjedhur.

Jorida Tabaku – Shikoni, unë e mirëkuptoj..

Çoi në prokurori, se deklarojnë për ty 9 milionë lekë pagë.

(Debat pa mikrofon në sallë.)

Arenc Myrtezani – Nuk po tallem, kjo është karta ime e bankës, urdhëro, merre, shko te banka dhe konfirmo rrogën time.

Jorida Tabaku – Zotëria na konfirmoi, se përveç se kryhet pastrim parash në kompanitë e tjera, u kryeka pastrim parash edhe me rrogat e punonjësve. Domethënë, kjo është e rëndë fare. Kanë deklaruar tek Tatimet 9 milionë lekë pagë për ju.

Arenc Myrtezani – Ju lutem, mos më ngatërroni mua me interpretime.

Jorida Tabaku – Jo, nuk të ngatërroj fare, u ngatërrove vetë.

Po s’jemi në rregull.

Arenc Myrtezani – Seriozisht është rroga ime 9 milionë lekë aty?

Atëherë, unë e falënderoj zotin Myrtezani për disponibilitetin që erdhi kaq shpejt, që na tha se ka punuar vetëm 1 vit dhe që faktet që treguan ndryshe. Unë arrita të marr nga dëshmia juaj ato që kisha nevojë të merrja për zonjën Sevi Zani që punonte atje, që krijoi kompaninë, që mori bonusin dhe ia shiti Klodian Zotos. Edhe për pagën arritëm në një informacion shumë të rëndësishëm, përveç kompanive fiktive të krijuara që pastrojnë para u pastruakan para edhe me pagat e punonjësve. Shikoni sa deklarojnë! Këto janë fonde të buxhetit të shtetit. Në qoftë se zonja e Tiranës, pak më parë tha “vijne me tarifë për ton mbetje”, këto këtu janë drejtpërdrejt, është *fee* koncesionare, por njëkohësisht edhe një sërë gjërash të tjera, të cilat besoj se do t’i zhvillojmë nesër më në detaje, me zotin Roland Dusha kur të vijë këtu përpara komisionit, i cili është edhe vartësi juaj.

Falënderoj të gjithë kolegët për mbledhjen shumë të gjatë që zhvilluam!

Falënderoj zotin Myrtezani, që erdhi menjëherë kur e mori vesh!

Shihemi nesër në mbledhjen e radhës.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA